



RAPORT PËR VETEUVALUIMIN E ZBATUAR PËR PERIUDHËN KOHORE 2022-2024 SHFK „NAIM FRASHËRI“ – NEGOTINA E POLLOGUT-VRAPÇISHT



Maj 2024

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

SHFK "Naim Frashëri" Komuna e Vrapçishtit, Këshilli i shkollës më datë: 16.02.2024 (me nr.protokoli: 02- 96), e miratoi këtë:

VENDIM

Më: 22.02.2023 nga mbledhja e mbajtur nga ana e këshillit të shkollës u miratua vetevaluimi i shkollës.

Kryetari këshillit të shkollës

Riad Bajrami



PËRMBATJA

1. Të dhënat e përgjithshme të shkollës	4
2. Hyrje në vetevaluimin shkollor	5
2.1. Vetevaluimi	5
2.2. Qëllimi i vetevaluimit	5
2.3. Procesi i vetevaluimit	6
2.4. Formimi i ekipit për vetevaluim	7
2.5. Fushat për vlerësim, indikator, teknikat dhe instrumentet e vetevaluimit	7
2.6. Teknikat dhe instrumentet që janë shfrytëzuar në vetevaluim	8
2.7. Niveli i realizimit	9
3. Fushat programore	10
3.1. Fusha: Planet dhe programet mësimore	10
3.2. Fusha: Të arriturat e nxënësve	39
3.3. Fusha: Mësimi dhe mësimdhënia	54
3.4. Fusha: Mbështetja e nxënësve	71
3.5. Fusha: Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	87
3.6. Fusha: Resurset shkollore	91
3.7. Fusha: Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës	103
4. Raport për vetevaluimin e përfunduar me propozim masa për përmirësimin e cilësisë së punës arsimore	114
4.1 Komision i shkollës për vetevaluim	114
5. Rekomandimi dhe propozimi i masave për përmirësimin e cilësisë së punës edukativo-arsimore	118

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

1. Të dhënat e përgjithshme të shkollës

Periudha e vetevaluimit	2022-2024
Lloji i shkollës	Shkolla fillore komunale "Naim Frashëri"
Themeluesi i shkollës	Komuna VRAPÇISHT
Gjuha mësimore	Gjuhë Shqipe
Numri i nxënësve	563
Struktura sipas gjinisë së nx.	274 f dhe 289 m
Numri i mësimdhënësve	94
Kryetar i këshillit drejtues të shkollës	Rijad Bajrami
Drejtor i shkollës	Bejtulla Kamberi
Adresa e shkollës	Rr. „101“ pn– Negotinë e Pollogut-Vrapçisht
Telefon	042/311-093
Posta elektronike	e-mail ou.naim.Frashëri@gmail.com
Faqja e internetit të shkollës	Shkolla Fillore Komunale "Naim Frashëri "Negotinë



2. Hyrje në vetevaulimin shkollor

2.1. Vetevaluimi

Vetevaluimi i shkollës është proces i përcjelljes së kontinuar sistematike, analizimit dhe vlerësimit të asaj që është realizuar me të vetmin qëllim të përparimit dhe sigurimit të cilësisë së punës së shkollës, ku në procedurën e vetevaulimit shkollor kërkohet përgjigje të tri pyetjeve kryesore:

Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhet patjetër të bazohen në të dhënat objektive në organizimin dhe funksionimin e shkollës.

Sa është e mirë shkolla jonë?

Si e dimë atë?


Çka mund të bëjmë që të jemi më mirë?

2.2. Qëllimi i vetevalvimit

Rëndësia dhe qëllimi i vetevaulimit të shkollës është: strukturimi i brendshëm i sistemit shkollor për përcjellje, notim dhe përparim apo avansimin e punës së përgjithshme shkollore; udhëheqje efikase dhe efektive të drejtorit me shkollën: përfshirjen në procesin zhvillimor të shkollës të gjithë subjektet; siguron pavarësi, përgjegjësi dhe risi në shkollë; ndërmarrje të masave për mësim më efikas dhe më cilësor (kualitativ) me çka arrihen rezultate më të mira; detektimin e anëve të dobëta dhe tejkalimin e tyre; definimin e anëve të dobëta dhe tejkalimin e tyre; definimin e përcjelljes së indikatorëve dhe kriterëve të matura, rritjen e ndikimit të jashtëm të gjithë subjekteve përmes nevojave të qarta të zhvillimit të shkollës, procesi i vetevaulimit është kompleks përbëhet në disa fazave dhe aktivitete me zbatim të metodave dhe të ndryshme.



2.3. Procesi i vetevaulimit



2.4. Formimi i ekipit për vetevaluim (N.R. 02 – 96/ të 16.02.2024 këshilli i shkollës)

1. Bejtulla Kamberi– Drejtor
2. Lindihana Ebibi- Edukatore Speciale
3. Fetanete Adili-Grup klasor
4. Behije Jonuzi –Grup lëndor
5. Riad Bajrami – Kryetar K.K.SH.



2.5. Fushat për vlerësim, indikator, teknikat dhe instrumentet e vetevalimit

Që të përcillet kualiteti në punën e përgjithshme në shkollë është e nevojshme kushtet në të cilën punon, proceset në të cilën zhvillohen në të si dhe rezultatet e arritjeve në shkollë, në bazë të këtyre tri kategorive janë të vërtetuara dhe definuara fushat e vlerësimit dhe indikatorët për kualitet.

FUSHAT INDIKATORËT PËR KUALITET	TABELA
1.Planet dhe programet mësimore	Realizimi i planeve dhe programeve mësimore
	Cilësia e planeve dhe programeve mësimore
	Aktivitetet jashtëmësimore
2.Arritjet e nxënësve	Arritjet e nxënësve
	Mbatja, shpërndarja e nxënësve
	Përsëritja e nxënësve
3.Mësimi dhe mësimdhënia	Planifikimi i mësimit
	Procesi mësimor
	Përvoja e nxënësve në mësim
4.Përkrahja e nxënësve	Kujdesi i përgjithshëm i nxënësve
	Shëndeti
	Ndihma këshilldhënëse për arsimin e
	mëtejshëm të nxënësve.
	Ndjekja e përparimit – progresit.
5.Atmosfera në shkollë	Atmosfera dhe raportet në shkollë
	Promovimi i arritjeve
	Barazia dhe të drejtat

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

	Marrëdhëniet partnere me prindërit ,
	bashkësinë lokale dhe komunitetin
	afarist.
6. Resurset	Kapacitetet hapësinore
	Mjetet dhe materialet mësimore
	Sigurim i kuadrove të nevojshme
	mësimore
	Ndjekja e nevojave për zhvillim të
	kuadrit mësimor
	Punë financiare në shkollë.
7. Udhëheqja , menaxhimi dhe krijimit i politikës	Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës
	Qëllimi dhe krijimi i politikës së shkollës
	Planifikimi zhvillimor.



2.6. Teknikat dhe instrumentet që janë shfrytëzuar në vetevaullim

TEKNIKAT	INSTRUMENTET
Vrojtim / vëzhgim	Përcjellja e gjendjes
Anketim	Anketa, pyetësor
Intervistë	Bisedë (individual – grupore)
Analizë të dokumentacionit	Çek listë

2.7. Niveli i realizimit

Nivelet e realizimit përmbajnë përshkrim të qartë dhe preciz që të arriturat tek indikatorët individual në kuadër të fushës së caktuar për vlerësim. Në bazë të përvojave vlerësimi i së realizuarës kryhet në më tepër nivele – ku aspektet e punës së shkollës varësisht nga niveli i vlerësimit zotërojnë anët e forta dhe anët e dobëta të cilët nuk ndihmojnë. Në kualitetin e përgjithshëm dhe të gjithanshëm të punës në shkollë.



Vetevaluimi i shkollës: Shf.k."Naim Frashëri "

fusha 1: Planet dhe programet mësimore

Në evaluimin e kësaj fushe duhet të përgjigjeni në numër sa më të madh të këtyre pyetjeve.

Mund të shtojmë përgjigje edhe të pyetjeve tjera për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për shkollën tuaj dhe nuk janë të përfshira në kornizat e vetevaluimit.

Ju mund të shtoni dhe të bëni përpjekje sa është e mundur për të shtuar të gjithë faktorët që janë të mundur në shkollën tuaj dhe komunitetin lokal ku është e nevojshme të kujdesemi për lidhjet familjare të cilat mund të ndikojnë në kualitetin e mëimit dhe procesit mësimorë në shkollën tuaj.

Mos mbështeteni vetëm në dokumentet e shkruara. Siguroni që të dhënat e mbledhura në këtë fushë po ashtu të përfshijnë sa më shumë komente të shkruara, vëzhgime dhe dëshmi vizuale.

PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE

Treguesit e cilësisë

Burim informacionesh

Temat

- | | | |
|-----|---|--|
| 1.1 | Realizimi i planeve dhe programeve mësimore | <ul style="list-style-type: none">● Plane dhe programe të aplikuara● Informimi i prindërve dhe i nxënësve për planet dhe programet mësimore● Përpilimi i planeve arsimore individuale (PAI) për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore● Zgjedhja e lëndëve mësimore● Planifikimi i aktiviteteve për realizimin e orëve të lira/aktivitetet projektuese të shkollës● Realizimi i programeve të zgjeruara |
| 1.2 | Kualiteti i planeve dhe programeve mësimore | <ul style="list-style-type: none">● Barazia gjinore dhe etnike, përmbajtje multikulturore në programet mësimore dhe në mjetet shkollore ndihmëse● Integrimi i karakteristikave dhe i nevojave të mjedisit lokal në programet mësimore dhe në mjetet mësimore ndihmëse● Integrimi i objektivave ndërlëndore të arsimit● Ndikimi i arsimtarëve, i prindërve dhe i partnerëve socialë ndaj planeve dhe programeve mësimore |



- 1.3 Aktivitete jashtëshkollore
- Vëllimi dhe larmia e aktiviteteve jashtëshkollore të planifikuara dhe të realizuara
 - Përfshirja e nxënësve në aktivitetet jashtëshkollore
 - Kyçja e nxënësve në zgjedhjen dhe në planifikimin e punës në aktivitetet jashtëshkollore
 - Afirmimi i nxënësve dhe i shkollës përmes aktiviteteve jashtëshkollore

Vetevaluimi i shkollës: Shf.k."Naim Frashëri,

fusha 1: Planet dhe programet mësimore

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur, cilat metoda janë përdorur).

Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha dokumentat të cilat janë shqyrtuar

Treguesi i cilësisë

Burimet e informacionit

Cilat informacione janë mbledhur?

1.1.1 Planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH

Programi i shkollës

Planet ditore

Ditari i shkollës

1.1 Realizimi i planeve dhe programeve mësimore

Shfk"Naim Frashëri"-Negotinë dhe Shfp-Senakos,Shfp-Gjurgjevisht,Shfp-Kalisht,Shfp-Llomnic gjatë punës së sajë përgjithësisht i realizon planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH. Zbatimi i planeve dhe programeve është në pajtueshmëri me të gjitha proceset e përpilimit dhe propozimit nga BZHA dhe miratim nga MASH.

Këtë vit shkollor punohet me Konceptin e Ri për arsimin fillor, i cili filloi me klasat I, II, IV, V, i cili koncept do të vazhdon në kontinuitet në vitet e ardhshme(III-VI)



1.1.2 Informimit të prindërve dhe të nxënësve me planet dhe programet mësimore

Procesverbalime mbledhje prindore

Procesverbalet e mbledhjeve

Mësimin e lëndës AFSH në klasat I, II, III , IV, V e realizojnë mësimdhënësit lëndorë.

Sipas planit mësimor, mësimdhënësit realizojnë mësim nga lëndët e detyrueshme zgjedhore. Mësimi në shkollën tonë realizohet në dy ndërrime. Të gjithë mësimdhënësit planifikojnë mësim shtues dhe plotësues në orar të organizimit të tyre në shkollë dhe i njëjti dërgohet në kohë në I SH A. Të gjithë mësimdhënësit(shumica prej tyre) planifikim të integruar të EKO, TIK, detyra shtëpie dhe mënyra të ndryshme të notimit, me çka me fillimin e vitit shkollor të gjitha aktivitetet e planifikuara janë pjesë e programit për punën e shkollës dhe informohen nxënësit dhe prindërit me përmbajtjet, temat, qëllimet, vlerat dhe standardet për çdo lëndë mësimore.

Nga kjo merren parasysh aftësitë individuale psikofizike të nxënësve dhe mundësia për kyçjen e prindërve në realizimin e të njejtave, mvarësisht nga lloji dhe shkalla e arsimit të tyre në bazë të kërkesave për ndihmë, mendime, sugjerimet dhe përfëshirjen e aktiviteteve të ndryshme të përshtatshme për profesionin e tyre. Shkolla shfrytëzon të gjitha mundësitë që i ofron rrethi për realizimin e suksesshëm të detyrave programore e cila kontribon në ngritjen e nivelit kulturor dhe arsimor të popullatës.

Në fillim të vitit shkollor mësimdhënësit i njoftojnë nxënësit me përmbajtjet e planeve dhe programeve mësimore për vitin shkollor në vijim, kurse gjatë vitit shkollor në kornizat e programit të mësimi interaktiv përgadisnin plane të integruara tematike. Me të njejtat njoftohen edhe prindërit e nxënësve.

Janë marrë parasysh edhe propozim masat nga inspektorati shtetëror i arsimit për sa i takon planeve dhe programeve mësimore, në drejtim të ndryshimit të tyre për planifikim më të mirë në të gjitha lëndët mësimore.



1.1.3 Përpilimi i planeve arsimore individuale (PAI) për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore	Shkolla ka plan në Programin e Shkollës, njëvjeçare për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore – arsim inkluziv, për dy vitet e fundit, nuk ka nxënës të tillë (të dëshmuar me dokumentacion mjekësor), mirëpo në cilësi të shkollës, bazuar kërkesave ligjore është në funksion komisioni shkollor për arsim inkluziv me afat tre vjeçar sipas procedurave ligjore.
Plani për ekipin inkluziv shkollor	Në klasën e gjashtë nxënësit kanë mundësi të zgjedhin gjuhë të dytë të huaj kurse prej klasës së katërt deri në të nëntën zgjedhin një lëndë nga të ofruarat si lëndë zgjedhore. Çdo vit shkollor me mbarimin e vitit mësimor, shkolla përmes kujdestarëve të klasave, pedagogut, ofron lëndët e mundshme zgjedhore për vitin e ardhshëm – përmes anketave për nxënës në bashkëpunim me prindërit bazuar në kushtet e shkollës, interesave dhe arritjes së qëllimeve të nxënësve në kl. IV, V dhe VI, si dhe në klasat VII, VIII dhe IX, ku të njëjtat të përcaktuara (përzgjedhura) përgaditen në kohë, duhet të marrin mendimin nga BZHA-ja që tu jepet leja për miratim, ku si pjesë e organizimit të mësimi kanë qenë në klasën e IV.- Shkathtësitë jetësore dhe Origami(Në periudhë dyvjeçare. Në klasët e V-ta, Futbolli dhe Matematika logjike, në klasën VII – Projekt nga Arti figurativ, në klasën IX – Projekt nga Informatika. Ndërsa, në klasat I, II dhe III në bazë të seksioneve sipas nxënësve me aktivitete interesimin dhe afinitetin e nxënësve.
1.1.4 Zgjedhja e lëndëve mësimore	
Analiza e rezultateve	
1.1.5 Planifikimi i aktiviteteve për realizimin e orëve të lira/aktiviteteve projektuese të shkollës	Në shkollë realizohen ALN dhe çdo mësimdhënës realizon nga një orë në javë, e në planifikimet e tyre çdo shumica e mësimdhënësve integrojnë EKO – përmbajtje sipas programit integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimor të RMV-së, si dhe ekipi për integrimin e EKO ka përpiluar aktivitete konkrete.
1.1.6 Realizimi i programeve të zgjeruara	Shkolla planifikon por nuk realizon tërësisht programin e zgjeruar përshkak të kushteve hapësinore ,objekti i shkollës ndahet edhe me shkollën e mesme “Negotina” në ndërrimin e pasdites
Programi për punën e shkollës	



1.2.1 Barazia gjinore dhe etnike, përmbajtje multikulturore në programet mësimore dhe mjetet shkollore ndihmëse

Intervista me udhëheqsinë, kuadrin arsimor, prind dhe nxënës

1.2.Cilësia e planeve dhe programeve mësimore

Gjatë realizimit të planeve dhe programeve mësimore egziston mundësi e barabartë për pjesëmarrjen e nxënësve të ndryshëm dhe përkatësisë gjinore në udhëheqje, bashkëpunim, marrëveshjen, vetbesimin dhe zgjedhjen e konflikteve.

Mësimi i integruar jep mundësi për angazhim komplet të nxënësve për zgjedhjen e problemeve dhe detyrave, duke marrë ide të reja dhe duke punuar me shembuj konkret, situata dhe ngjarje.

Arsimtarët kanë autonominë e tyre, mundësi për modifikim të planeve dhe programeve mësimore nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe përmes pranimit të metodave aktive dhe teknikën e të mësuarit të cilat nxisin mendim kritik të nxënësit në klasën e VIII dhe të IX-ën përmes lëndës Kulturë qytetare nxënësit kanë mundësi të përcjellin procedura demokratike gjatë marrjes së vendimeve dhe zgjidhjes së konflikteve .

Bashkësia si formë më e lartë e aktivitetit të organizuar u mundëson nxënësve për të filluar dhe për të promovuar aktivitetet në frymën e punës demokratike.

Në kuadër të shkollës janë realizuar edhe aktivitete të përbashkëta ndëretnike me shkollën partner “Strasho Pinxhur “–Kavadar ku ndër të tjera mund të përmendim këta aktivitete të realizuara:

Më datë 27 .10.2023 u realizua aktiviteti ndëretnik “Ndërtojmë ura “ me shkollën e Kavadarit “Strasho Pinxhur” ,në këtë ditë shkolla jonë ishte mysafire në Kavadar ku në kuadër të projektit u zhvilluan aktivitete të ndryshme ,ku nxënësit tanë u paraqitën me katër pika në lëmi të ndryshme.

Më datë 31 .10.2023 u realizua aktiviteti ndëretnik “Ndërtojmë ura “ me shkollën e Kavadarit “Strasho Pinxhur” në këtë ditë shkolla e Kavadar ishte mysafir në shkollën tonë ku në kuadër të projektit u

1.2.2 Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të mjedisit lokal në



programet mësimore dhe në mjetet mësimore ndihmëse

Procesverbalet e mbledhjeve të këshillit dhe organeve shkollore

1.2.3 Integrimi i objektivave ndërlëndorë të arsimit

1.2.4 Ndikimi i arsimtarëve, prindërve dhe partnerëve socialë ndaj planeve dhe programeve mësimore

Raportet e punës

1.3.1 Vëllimi dhe llojllojshmëria e aktiviteteve jashtëshkollore të planifikuara dhe të realizuara
Bisedë me drejtorin, arsimtar, prind dhe nxënës

zhvilluan aktivitete të ndryshme nga mësimdhënësit e ars.muzikor ,ars. figurativ dhe arsimit fizik

Rallë diskutohet , arsimtarëve u jepet mendime më të detajuar për planet dhe programet mësimore në nivel të ekipeve profesionale, me çka disa mësimdhënës japin mendime, propozime, sugjerime për realizim të sukseshëm të programeve, në trajnime, konferenca dhe punëtori.

Shkolla në raste informon prindërit , takimet me prindër me planim mësimor dhe ndryshimet të cilat realizohen në vizitet shkollore

Shkolla është e hapur për ndryshime dhe realizim të programeve të cilët ndikojnë dhe e bëjnë më efikase suksesin e punës e cila duket dukshëm me inovacionin etik të disa lëndëve, përmirësimin e mësimi, standardet e notimit teknikat e mësimi, udhëheqjen elektronike të dokumentacionit shkollor, përcjellja e seminareve trajnimeve. Nuk ka ndryshime të theksuara në realizimin r planeve përveç rasteve të rralla përshkak kushteve të përgjithëshme

1.3 Aktivitetet jashtëmësimore

Shkolla planifikon dhe realizon aktivitete jashtëmësimore të llojllojshme, e cila shfaq nevojat dhe interesat e nxënësve të cilët shërbejnë në zhvillimin e tyre dhe përkrahjen personale.Në bazë të Konceptit të ri të aktiviteteve jashtëmësimore në arsimin fillor, si në të gjitha shkollat ashtu edhe në shkollën tonë realizohen sipas kohëzgjatjes, aktiviteteve jashtëmësimore afatshkurtëra si:

Shëtitje, ekskurzione;

Punëtori afatshkurte, etj.



1.3.2. Përfshirja e nxënësve në
aktivitetet jashtë mësimore

Evidencat e dokumentacionit pedagogjik
Programi për punën e shkollës
Raporti për gjysëmvetorin dhe fundin e
vitit shkollor

Aktivitetet jashtëmësimore si:

Seksione apo klube të ndryshme.

Realizimi i mësimin plotësues dhe shtues, gara shkollore, vizita, punë të dobishme shkollore, veprimtari publike kulturore, mbrojtje shëndetësore në shkollë funksionon bashkësisht e nxënësve – Parlamenti i nxënësve.

Ekskurzionet e nxënësve planifikohen dhe organizohen sipas rregullores, me programe paraprake, me miratim nga BZHA dhe nga themeluesi.

Në kuadër të kujdesit për shëndetin e nxënësve në bashkëpunim me poliklinikën e Gostivarit realizohen kontrole sistematike, kontrole stomatologjike, vaksinime të rregullta si dhe ligjerata edukative, apo punëtori në kuadër të shkollës.

Në shkollën tonë në pajtim me dëshirat dhe kushtet për punën realizohen këto aktivitete të lira të nxënësve:

Seksioni për recitim dhe letërsi,

Seksioni i matematicentëve

Seksioni i historianëve

Seksioni ekologjik,

Seksioni i biologjisë

Seksioni i gjeografisë

Seksioni i gjuhëtarëve

Aktivitetet e lira kulturo-artistike

Seksioni i muzikës kori i shkollës, grupi i vallëtarëve, seksioni i artit figurativ, sportistët e rinj etj.

Pjesa më e madhe e nxënësve janë të përfshirë në aktivitete jashtëmësimore, ku secili prej tyre është i përfshirë në më së paku në një aktivitet. Tregohet interes në konkurse, në gara shkollore dhe jashtë saj. Në gara kemi rezultate të mira dhe solide.

Nxënësit tregojnë interesim të madh për inkuadrim dhe pjesëmarrje në aktivitete jashtëmësimore. Me planifikimet dhe realizimin e aktiviteteve që organizohen dhe promovohen në shkollë, nxënësit kanë mundësi që



1.3.3. Inkuadrimi i nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet jashtëmësimore

Programi i mësimi shtues- plotësues

Evidenca e punës me nxënës

1.3.4. Afirmimi i nxënësve dhe i shkollës përmes aktiviteteteve jashtëshkollore

Shpërblimet e fituara

Aktivitetet

Portali I shkollës

Bisedë me bashkëpunëtorë profesional

Procesverbalet me bashkësinë e

nxënësve – parlamentin e nxënësve

Lëvdatat

me përgjegjësi të pranojnë ndryshimet, inovacionet në aspektin e aftësive, vlerave, të arriturave dhe të nxisin qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit e lëndëve mësimore dhe procesit edukativo-arsimor në tërësi, me çka dy vitet e fundit interesimi për pjesëmarrje në aktivitete jashtëmësimore është në rritje.

Përfshirja e nxënësve është zgjedhje personale dhe ka rol të rëndësishëm gjatë planifikimit të punës shkollore dhe arsimtarët kanë rol koordinativ dhe këshillëdhënës.

Pjesëmarrja e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore mundëson inkurajimin dhe nxitjen në kureshtjen e tyre, aftësinë njohëse, kreativitetin, sjelljen dhe respektin e tyre për pikëpamjet dhe mendimet e të tjerëve. Nxënësit e shkollës sonë brenda këtyre 2 viteve kan marrë pjesë në gara të organizura: Nga kolegji Yahya Kemal-Gostivar dhe Tetovë, në lëndët matematikë-fizikë gj. angleze, matematikë ku janë shpërblyer me diploma dhe mirënjohje në bazë të suksesit të treguar. Nxënësit tonë kanë treguar sukses për të cilin dëshmi janë diplomat, lëvdatat dhe mirënjohjet të cilat janë të paraqitura në mënyrë kronologjike më poshtë.

Nxënësit nga ana e mësimdhënësve dhe shkollës motivohen që të marrin pjesë në garat komunale, regjionale dhe shtetërore si dhe në manifestimet e ndryshme ku arrihen dhe rezultate të larta në fusha të ndryshme, në veçanti në fushën e sportit dhe lëndën e matematikës, fizikës Gj. angleze, gjeografisë etj. Këto janë pjesëmarrjet nëpër gara dhe rezultatet e arritura:

Në vitin shkollor 2022/23 Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e klasave nga klasa e V-IX ku përfshihen nxënësit e SHFQ- Negotinë dhe nxënësit e SHFP- Senakos, Kalisht

Në fillim të vitit shkollor u zgjodh ekipi udhëheqës i parlamentit të nxënësve, ku të drejtën e votës kishin nxënësit nga klasa e VII-IX –ta



Kryetar i parlamentit të nxënësve -Isa Hebibi kl.IX/1
Nënkryetar i parlamentit të nxënësve –Emine Musliu IX/4
Në vitin shkollor 2023/24 Parlamentin e nxënësve e përbëjnë
Avokat i nxënësve : Andi Zendeli VIII/1
Zëvendës avokat :Ruzhdi Fidani:IX/6
Kryetar i parlamentit të nxënësve –Bleona Pajaziti klasa IX/1
Nënkryetar i parlamentit të nxënësve –Emine Musliu klasa IX/4
Avokat i nxënësve –Mejreme Kurtishi Klasa IX/5
Zëvendës avokat :Arjan Imeri klasa IX/6
Në mbledhjet me parlamentin e nxënësve është diskutuar për :
-Aktivitete jashtëmësimore dhe manifestimet e ndryshme
-Projektet që do të realizohen në vazhdim
-Suksesin , vijueshmërinë e nxënësve
- Sugjerimet dhe ankesat
-Mbarëvajtja e procesit edukativo-arsimor etj.
Në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor janë realizuar shtatë mbledhje me parlamentin e nxënësve ku është diskutuar për:
-Suksesin , vijueshmërinë e nxënësve
-Aktivitetet jashtëmësimore dhe manifestimet e ndryshme
-Raport për veshjet kombëtare me mjetet e panairit të ushqimit të vitit shkollor 2019
-Informim për gjysmëvjetorin e parë
-Shqiptimi i masave pedagogjike
-Puna me evaluimin integral
-Anketa në gjysmëvjetorin e dytë
-Garat sportive brenda shkollore
-Manifestimi për 7,8,Marsin
-Projekte të ndryshme
-Kuizi në lëndës e matematikës
-Ditët e Naimit-Realizimi i shëtitjeve në natyrë ,ekskurzioneve dhe fotografimi i nxënësve etj



Në vitin shkollor 2022/23 janë realizuar këto aktivitete

Më datë 01.09.2022-dita e enjte me fillimin e vitit shkollor shkolla jonë për hir të kësaj dite ,ditës së parë të shkollës për të gjithë nxënësit fillestar dhe prindërit e tyre për fëmijët të cilët filluan një rrugëtim drejtë dijes, të ngelen në kujtesën e tyre ,shkolla jonë organizoi një shfaqje me aktorët e teatrit Pinokio Shfaqja “Kësulëkuqja në udhëkryq”

Më datë 26.09.2022 u realizua edicioni i dytë Kolonia e artit” Art dhe paqe” ku ishin të ftuar të gjitha shkollat e komunës së Vrapçishtit dhe atë: SHFK”Vrapçisht”-Vrapçisht SHFK ”Sali Lisi “-Dobridoll , SHFK”Memet Deralla “-Gradec dhe shkolla jonë si nikoqire.

Gjithsejt në këtë aktivitet morën pjesë 18 nxënës dhe 6 mësimitdhënës , punimet e nxënësve do të ngelen te shkolla jonë ,3 nxënës ishin fitues të tjerëve iu shpërndamë mirënjohje.

Më datë 10.10.2022-si çdo vit tjetër edhe këtë vit u organizua “Krosi vjeshtor” në SHFQ-Negotinë ku morën pjesë nxënësit e shkollës SHFQ-Negotinë dhe nxënësit e SHFP- Senakos nga klasat e VI-IX-ta nën udhëheqjen e mësimitdhënësve të AFSH, Venhar Velija ,Rizvan Asani dhe Blerim Selmani .

Më datë 12.10.2022- orë e realizuar nga sektori i policisë me temë “Rregullat e komunikacionit” për nxënësit e klasave të IX-ta ku pjesëmarrës ishin nxënësit e SHFQ Negotinë dhe SHFP-Senakos

Më datë 17.10.2022- me rastin e ditës botërore të ushqimit shkolla jonë realizoi aktivitetin tradicional “Panairi i ushqimit” ky projekt u realizua në bashkëpunim me IOM dhe ambasadën e Britanisë së Madhe,prindërve ,nxënësve dhe mësimitdhënësve .

Pjesëmarrësit apo të ftuarit tonë ishin përgjegjësi i arsimit të komunës tonë ,drejtorët e shkollave dhe banorët e fshatit poashtu e ftuar ishte edhe kordinatorja e IOM-it z. Erda Qazimi dhe z.Valon.

Në këtë aktivitet morën pjesë ,konkuruan me ushqimet e tyre nxënësit nga klasat e VI-IX –ta Negotinë – Senakos bashkë me kujdestarët e klasave, aktiviteti kishte karakter garues ku në bazë të komisionit për vlerësim prej katër anëtarësh të cilët kishin për detyrë të japin pikët apo të vlerësojnë dekorin e shtandeve dhe cilësinë e ushqimit. Fitues nga çdo gjeneratë dolën:Klasat e gjashta (VI/2)

Klasat e shtata (VII/3)



Klasat e teta (VIII/2)

Klasat e nëntë (IX/3)

Më datë 21.10.2022- Në nivel komunal në kuadër të Lidhjes së Sportit në SHFQ-Negotinë u zhvilluan garat sportive në futboll ku morën pjesë tre shkolla nga komuna jonë SHFK-“Memet Deralla “-Gradec,SHFK”Sali Lisi”- Dobridoll dhe SHFK –Naim Frashëri” –Negotinë.

Fitues ishin nxënësit e SHFK “Memet Deralla”-Gradec

Më datë 25.10.2022- në shkollën tonë për hir të ditës së kursimit kishim mysafir drejtorin e Stopanska Bankës me ekipin e tij ku u zhvillua një ligjeratë e shkurtër për nxënësit e klasës së IV-të dhe u shpërndanë dhurata këtyre nxënësve

Më datë 27.10.2022- Në nivel komunal në kuadër të Lidhjes së Sportit në SHFQ-Negotinë u zhvilluan garat sportive në volejboll ku shkolla jonë garoi me klubin e shkollës së f.Gradec dhe vajzat e shkollës sonë morën vendin e parë me fitore prej 3;0, pas kësaj me rezultatin fitore siguruam plasman të mëtjehtëm, siguruam pjesëmarrje ne gara ndërkomunale në mes komunës së Vrapcishtit dhe komunës së Gostivarit.

Më datë 31.10.2022 në nivel ndërkomunal në kuadër të Lidhjes së Sportit u zhvilluan garat sportive në volejboll shkolla jonë mori vendin e parë prej 4 ekipeve te shkollave te ndryshme te komunës se Gostivarit, SHF "Kemal Ataturk", "GoceDellcev" dhe shkola fillore" Ismail Qemali". Arsimtari mentor Rizvan Aasani

Më datë 01.11.2022-u realizua orë e hapur në lëndën e fizikës nga mësimehdhënësja Yllzana Hamza me nxënësit e klasës IX/3 tema :”Matja e dendësisë”

Më datë -04.11.2022-u realizua Ora e hapur në lëndën e matematikës nga mësimehdhënësja Fetanete Adili me nxënësit e klasës IV/3 njësia mësimore “Llogaritja e numrit të panjohur gjatë mbledhjes dhe zbritjes “. Pjesëmarrës ishin:udhëheqësia e shkollës ,mësimehdhënës dhe prind.

Më datë 07.11.2022-U realizua anketimi me nxënësit dhe prindërit në SHFQ-Negotinë dhe SHFP-Senakos për mbarëvajtjen e procesit mësimor.



Më datë 10.11.2022-Ora e hapur në lëndën e shkencave natyrore nga mësimmhënësja Dashmire Hebibi ,me nxënësit e klasës II/1 tema :”Stina e vjeshtës dhe bukuritë natyrore “ pjesëmarrës ishin prindër,mësimmhënës dhe pedagogu i shkollës.

Më datë 16.11.2022 –Ora e hapur në lëndën e historisë dhe shoqërisë nga mësimmhënësja Floreta Bilalli me nxënësit e klasës IV/5 tema.”Orientimi në hartën gjeografike,” pjesëmarrës ishin prindër,mësimmhënës dhe udhëheqësia e shkollës.

Më datë 17.11.2022- Orë e hapur në lëndën e matematikës nga mësimmhënësja Ajshe Pajaziti me nxënësit e klasës IV/4 tema.,,Llojet e këndeve,,pjesëmarrës ishin prindër, mësimmhënës dhe udhëheqësia e shkollës.

Më datë 17.11.2022- Festat e Nëntorit –Konkurs me punimet e nx.në Ars.Figurativ.Për hir të festave të Nëntorit shkolla shpalli konkurs për nxënësit nga klasat e VI/IX-ta tema ,,Festat e Nëntorit,,ku morën pjesë 200 nxënës ku 3 nxënës nga klasa VIII/1 prej tyre morën vende të para.

Vendi i parë: Suela Mediu klasa VIII-1

Amra Jashari

Bleona Pajaziti

Vendin e dytë. Nora Emruli klasa IX/4

Vendin e tretë. Ajana Bajrami klasa VIII/2

Komision nga mësimmhënësit: Verim Zendeli

Mirsad Osmani

Më datë 21.11.2022-Ekspozitë te pallati i kulturës “Shota” me punimet e “Kolonisë së artit” ,për shkak të ditës së alfabetit SH.F.K Negotinë organizoi ekspozitë me nxënësit me punimet e kolonisë së artit në nivel komunal “Art dhe Paqe”

Më datë 21.11.2022-Akt teatral “Bullizmi” Në pallatin e kulturës „Shota,, Negotinë u realizua një pjesë teatrale „ Bullizmi,, ku morën pjesë nxënësit klasëve të IX/ta Negotinë -Senakos nën udhëheqjen e mësimmhënësve : Besjana Zendeli dhe Blerta Amiti



Më datë 22.11.2022- ESE – me temë : “FESTAT E NËNTORIT”-Gjuhë shqipe ku morën pjesë nxënësit nga klasa e VI -IX/ta ,ku komision ishin mësimehdhënësit e gjuhës shqipe:

1.Shasine Ragibi

2.Behije Jonuzi

3.Sahide Ebibi

Emrat e nxënësve fitues: Vendin e parë –Nejla Ebibi

Vendi i dytë-Nora Emruli

Vendi i tretë-Andi Zendeli dhe Amra Jashari

Më datë 23.11.2022 u realizua orë e hapur nga mësimehdhënësja Besa Mustafa me nxënësit e klasës IV/4 ,tema “Active Verbs”-folje ku pjesëmarrës ishin udhëheqësia e shkollës ,mësimehdhënës dhe prind .

Më datë 24.11.2022-Orë e hapur në gjuhë shqipe nga mësimehdhënëset Arjeta Ismaili dhe Selime Tahiri me nxënësit e klasës së III/4 dhe III/5 Tema:”Historiku i 28 –Nëntorit “ pjesëmarrës mësimehdhënës, prindër dhe shërbimi pedagogjik .

Më datë 28.11.2022-Manifestim në SHFP-Senakos për festën e “28 Nëntorit”pjesëmarrës nxënësit nga klasa e I-IX-ta nën udhëheqjen e mësimehdhënësve Mirsad Osmani ,Rizvan Asani ,Adem Saliu, Sherif Mustafa, Samir Zeqiri,Eljesa Xheladini.

Nxënësit tanë gjithashtu performuan me dy pika në manifestimin e bërë në nivel komunal nën udhëheqjen e mësimehdhënësës së ars. muzikor Ganimete Ilazi i cili u organizua te pallati i kulturës “Shota “-Negotinë,gjithashtu për festat e 28-Nëntorit u organizuan manifestime edhe në SHFP-Kalisht dhe në SHFP-Gjurgjevisht.

Më datë 30.11.2022-U realizua ora e hapur nga mësimehdhënësja Mirzana Jahja me nxënësit e klasës V/2 në lëndën e historisë dhe shoqërisë me temën “Faktorët e socializimit” pjesëmarrës ishin :shërbimi pedagogjik dhe mësimehdhënës.

Më datë 05.12.2023-u zhvillua faza e parë e turneut Ping pong në sallën e sportit –Negotinë ku morën pjesë 20 nxënës të Shfq-Negotinë dhe Shfp-Senakos në fazën finale vazhdojnë nxënësit : Adni Ebibi-Negotinë , Juled Nebiu – Negotinë ,Valon Haliti –Senakos ,Meriton Haliti –Senakos Ardi Amity –Senakos ,Almir Jahja –Negotinë ,Faton Dalipi –Negotinë ,Fitim Haliti-Senakos,Jasin Amity –Senakos,Venis Memedi Senakos . Mësimehdhënësit mentorë : Rizvan Asani ,Venhar Veija dhe Blerim Misimi



Më datë 22.12.2023 –u zhvillua faza finale në Ping pong në sallën e sportit –Negotinë ku morën pjesë 8 nxënës nga Shfq-Negotinë dhe Shfp-Senakos dhe nxënësit fitues në vendin e parë Ardi Amiti-Senakos ,vendi i dytë Almir Jahja –Negotinë

Më 7 Mars nën patronazhin e Komunës së Vrapçishtit u organizua një manifestim në nivel komunal ku morën pjesë të gjithë shkollat e komunes tonë me nga dy- tre pika, manifestimi u organizua në Shfq –Negotinë ku morën pjesë një numër i konsiderueshëm i mysafirëve mësimdhënës,pjesëtar të komunës dhe nxënës ,manifestimi u realizua në palestrën sportive në ora 12:30

Më datë 06 .03.2023 u realizua një ligjratë nga ana e përgjegjësit të Ministrisë së punëve të brendshme për preventivë z.Evzal Osmani me temë “Fëmijët ,të drejtat dhe obligimet “ te nxënësit e klasave të IX-ta .

Më datë 04.04.2023 u realizua një shfaqje në shkollën tonë nga teatri Pinoku ku sollën në skenë komedinë edukative argëtuese “I ligu që shtiret “ku morën pjesë nxënësit nga klasat e I-IX-ta.

Më datë -05.05.2023-u realizua një ligjratë nga ana e përgjegjësit të punëve të brendshme për preventivë. Evzal Osmani me nxënësit e klasave të VIII-ta –Negotinë .

Temat: 1. Identifikimi dhe pasojat nga përdorimi i drogës

2.Parandalimi i trafikimit të njerëzve dhe fëmijëve

Më datë 05.05.2023 –u realizua lojë në Volejboll ku shkolla jonë ishte mysafire e vajzave të Shfk”Memet Deralla “ –Gradec , ku u zhvillua një ndeshje miqësore në një atmosferë festive .

Më datë 12.05.2023-Në kuadër të projektit Fundjava Gjenerale e mbështetur nga Pako Mak ,Sparkasse Bank,Kryqi i kuq dhe komuna e Vrapçishtit bashkë me parlamentin e nxënësve të shkollës sonë bënë mbledhjen e mbeturinave në rrethin tonë.

Më datë 13.03.2023 psikologja e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e VIII-ta dhe IX ta Negotinë Tema:”Njohja me dhunën dhe llojet e saj “-duke kuptuar që dhuna nuk është vetëm fizike por edhe verbale, psikologjike etj.

Më datë 14.03.2023 psikologja e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e VII-ta dhe VI -ta Negotinë Tema:” Bashkëmoshatarët e mi”-aktivitet që i mundëson nxënësit të zhvillojë ndjenjën e empatisë ndaj bashkëmoshatarëve dhe të forcojnë ndërgjegjësimin dhe aftësitë e tyre sociale.

Më datë 16.03.2023 psikologja e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e IV-ta dhe V-ta Negotinë



Aktivitetet rekreative që zhvillojnë aftësi dhe njohuri të nxënësve që të marrin pjesë pozitivisht në jetën e tyre të përditshme dhe në jetën e tyre shoqërore.

Më datë 17.03.2023 psikologjia e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e VII –ta Negotinë

Tema: Komunikimi pozitiv -inkurajimi i respektit për njëri- tjetrin përmes komunikimit aktiv dhe pozitiv.

Më datë 20.03.2023 psikologjia e shkollës realizoi një orë mësimore aktivitetet me klasat e VI -IX në Shfp-

Senakos me tema të njëjta si në Shfq-Negotinë

Më datë 21.03.2023 psikologjia e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e treta në Negotinë dhe Senakos

Tema:Njohja e emocioneve, identifikimi i tyre dhe shprehja e tyre përmes lojës.

Më datë 05.04.2023 psikologjia e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e dyta Negotinë dhe 12.04.2023

Senakos

Tema:Fytyra dhe ndjenja- diskutim i situatave se si ato do të ndjehen në situata të caktuara duke u njohur me emocionet bazë.

Më datë 14.04.2023 psikologjia e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e IV-ta dhe V-ta në Shfp-

Senakos

Tema: Koncentrim , dëgjim dhe shprehja e imagjinatës së tyre përmes aktiviteteve.

Më datë 19.05.2023 psikologjia e shkollës realizoi punëtori me mësimdhënës me temën e caktuar nga ministria

e arsimit dhe shkencës e mbajtur për shkak të situatës së krijuar në Serbi.

Më datë 29.05.2023 psikologjia e shkollës realizoi një orë mësimore me klasat e V–ta Negotinë , eksplorimi i

ideve si mund të zgjidhim konflikte në mënyrë jo të dhunshme me një ushtrim të shkurtër të ndjekur nga një reflektim dhe diskutim i gjatë mbi konfliktet aktuale në shoqëri.

Në kuadër të “Ditëve të Naimit”me rastin e Patronatit të shkollës u zhvilluan një sërë aktiviteteve :

Aktivitetet e ciklit të ulët Negotinë –Senakos:

Më datë 22.05.2023-Aktivitet klasat e katërta: IV/1,IV/2, -Negotinë

Mësimdhënëse:Seade Bilalli,Nexhmije Hamza , Albulena Xheladini



Tema :Dramë ,poezi ,valle ,komedi

Koha dhe vendi :ora 10:00 te pallati i kulturës “Shota “-Negotinë

Më datë 22.05.2023-Aktivitet klasat e pesta :V/1,V/3-Negotinë

Mësimdhënëse:Arjeta Dalipi,Shefika Rexhepi

Tema:Dramë ,valle ,recitim

Koha dhe vendi :ora 11:00 te pallati i kulturës “Shota “-Negotinë

Më datë 22.05.2023-Aktivitet klasat e treta :III/1,III/2,III/3-Negotinë

Mësimdhënëse :Alemine Bilalli,Mirlinda Muharemi,Hanife Bajrami,Arlinda Demiri

Tema :Reciklimi

Koha dhe vendi: ora 13:00 te pallati i kulturës “Shota “-Negotinë

Më datë 01.06.2023-Aktivitet klasat e para: I/4,I/5 –Senakos

Mësimdhënëse:Mirjeta Selmani dhe Nexhibe Hamidi

Tema :”Dita ndërkombëtare e fëmijëve” dhe “Festa e Abetares “

Koha dhe vendi :ora 14:00 në Shfp-Senakos

Aktivitete e ciklit të lartë Negotinë -Senakos

Më datë 17.05.2023-Kuizi në Matematikë

Mësimdhënëses :Miasere Selmani,Vjollca Dervishi,Leontina Durmishi,Adem Saliu,Samir Zeqiri

Klasat :VI,VII,VIII,IX-ta Negotinë –Senakos

Koha dhe vendi:ora 10:40 te salla e sportit -Negotinë



Garat sportive

16.05.2023- Garat sportive në Futboll ora 11:30

18.05.2023- Garat sportive Volejboll ora 11:30

22.05.2023- Garat sportive në Basketboll 11:30

23.05.2023- Garat sportive në Pink Pong dhe Shah ora 11:30

23.05.2022- Finalja Futboll / Volejboll ora 11:30

EKSPOZITË

Më datë 18.05.2023 , me fillim në ora 10:45 në oborrin e shkollë u mbajt ekspozitë me punimet e nxënësve - mësimdhënës mentor: Verim Zendeli dhe Mirsad Osmani

Më datë 01.06.2023 –gjithashtu në kuadër të aktiviteteve të 1 qershorit ,ditës së fëmijëve në bashkëpunim me komunën e e Vrapçishtit u bë organizimi i turneut sportiv në futboll dhe volejboll ku u arritën këto rezultate:

Vendi i parë futboll Shfk "Sami Frashëri"-Bogovinë

Vendi i dytë futboll Shfk "Naim Frashëri"-Negotinë

Vendi i tretë futboll Shfk"Memet Deralla "-Gradec

Vendi i parë volejboll Shfk "Naim Frashëri " –Negotinë

Vendi i dytë volejboll Shfk" Memet Derala "-Gradec

Në gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor2023/24 janë realizuar këto aktivitete :

Më datë 01.09.2023-dita e premte me fillimin e vitit shkollor ,shkolla jonë për hir të kësaj dite ,ditës së parë të shkollës për të gjithë nxënësit fillestar dhe prindërit e tyre , për fëmijët të cilët sot fillojnë një rrugëtim drejtë dijes të ngelen në kujtesën e tyre ,shkolla jonë organizoi një shfaqje me aktorët e teatrit "Pinokio" , shfaqjen: "I ligu që shtyret".



Më datë 09.10.2023 –u realizua një aktivitet nga ana e psikologes së shkollës Zulihare Osmani me temë “Bullizmi “ aktiviteti u realizua te pallati i kulturës “Shota “-Negotinë ku morën pjesë nxënësit dhe mësime dhënësit nga klasat e VI-IX-ta

Më datë 24.10.2023 u realizua projekti “Nxënësi dhuron për nxënësin “edicioni i katërt ,ku në këtë aktivitet morën pjesë nxënësit nga klasat e I deri klasat e IX-ta nxënësit, të cilët dhuruan veshmbathje dhe mjete ushqimore të cilat pastaj u shpërndanë nëpër familjet në nevojë dhe pjesa e ngelur iu dhurua Kryqit të kuq.

Më datë 27 .10.2023 u realizua aktiviteti ndëretnik “Ndërtojmë ura “ me shkollën e Kavadarit “Strasho Pinxhur” ,në këtë ditë shkolla jonë ishte mysafire në Kavadar ku në kuadër të projektit u zhvilluan aktivitete të ndryshme ,ku nxënësit tanë u paraqitën me katër pika në lëmi të ndryshme.

Më datë 31 .10.2023 u realizua aktiviteti ndëretnik “Ndërtojmë ura “ me shkollën e Kavadarit “Strasho Pinxhur” në këtë ditë shkolla e Kavadarit ishte mysafir në shkollën tonë ku në kuadër të projektit u zhvilluan aktivitete të ndryshme nga mësime dhënësit e ars.muzikor ,ars. figurativ dhe arsimit fizik

Më datë 07.11.2023-u realizua në shkollën e Gjurgjevishtit aktiviteti “Vjeshta e artë në shkollën tonë” me mësime dhënësit e ciklit të ulët

Më datë 20.11.2023-u realizua”Lamba e vjeshtës “ me nxënësit e klasës së III-1 , mësime dhënësjë Dashmire Hebibi.

Më datë 02.11.2023-u realizua aktiviteti në gj.angleze, klasat I-4 dhe I-5 me mësime dhënëset Ajshe Pajaziti dhe Asibe Amiti, ku si temë ishte “Punimi i kurorave për ditëlindje”

Më datë 13.11.2023-u realizua një aktivitet “Vjeshta në klasën tonë me mësime dhënëset e ciklit të ulët klasat I-1 ; I-2 ; I-3

Më datë 20.11.2023 u realizua aktiviteti me psikologjen e shkollës - Zulihare Osmani me klasat e IX-ta – Negotinë :

Temat -IX-1 “Ne e duam të ardhmen tonë me një barazi gjinore dhe pa diskriminim “

-IX-2 “Stilet e prindërimit dhe si ndikojnë ato në zhvillimin e një fëmije”

-IX-3 “Adoleshenca”



Më datë 20.11.2023 u realizua aktiviteti “ Të drejtat e fëmijëve “ me nxënësit e klasës III/1 , me mësimdhënësen Dashmire Hebibi

Më datë 22.11.2023 u realizua aktiviteti për ditën e alfabetit të gjuhës shqipe me nxënësit dhe mësimdhënësit e Shfp-Gjurgjevisht

Më datë 27.11.2023 u realizua manifestimi qëndror nën patronatin e komunës së Vrapçishtit dhe e organizuar nga Shfk-Sali Lisi –Dobridoll ku shkolla jonë ishte mysafire dhe mori pjesë me tri pika nën udhëheqjen e mësimdhënësve :Sahide Ebibi, Behije Jonuzi,Mirsad Osmani me nxënësit e klasës IX-1 dhe nxënësit e Shfp-Senakos .

Më datë 28.11.2023 –u realizua manifestimi kushtuar festës së 28Nëntorit te pallati i kulturës „Shota „ku nxënësit e ciklit të lartë Negotinë –Senakos morën pjesë me valle ,dramë dhe recitime ,mësimdhënësit mentorë: Behije Jonuzi ,Sahide Ebibi,Shasine Ragibi,Mirsad Osmani ,Verim Zendeli. Gjithashtu në këtë ditë u realizuan edhe shumë aktivitete nga nxënësit dhe mësimdhënësit e ciklit të ulët ku cdo mësimdhënësi realizoi aktivitet me klasën e tyre. Vlen të theksohet se të gjithë klasat ishin rregulluar për festën si në shkollën qëndrore ashtu edhe në shkollat periferike :Shfp-Senakos,Shfp-Kalisht,Shfp-Gjurgjevisht.

Më datë 04.12.2023- me rastin e 3 Dhjetorit- ditës ndërkombëtare të fëmijëve me aftësi të kufizuara ,u realizua projekt me nxënësit e klasave të VIII&IX-ta dhe edukatoren speciale.

Më datë 04.12.2023 -me rastin e 3 Dhjetorit u realizua aktivitet edhe me nxënësit e ciklit të ulët në Shfp-Kalisht me mësimdhënësen Liridona Bexheti .

Më datë 07.12.2023-u realizua një orë mësimore me nxënësit e klasave të VII,VIII-ta nga Stacioni i gallatës – Sektori për Preventivë me z.Evzal Osmani me temë „Mos u bë viktimë e rrjeteve sociale „

Më datë 10.12.2023 –me rastin e ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut , nxënësit e Shfp-Senakos, nxënësit e klasës V-4 realizuan aktivitet me mësimdhënësen Drita Saliji.

Më datë 10.12.2023-me rastin e ditës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut u realizua një orë mësimore me nxënësit e klasës V/3 me mësimdhënësen Fetanete Adili

Më datë 14.12.2023-u realizua një orë e hapur mësimore me klasën e II/2 me mësimdhënësen Jasmina Bilalli : Zhvillimi i shkronjës “Gj ,gj”



Më datë 22.12.2023 –program i përgaditur i mësueses Mirzana Jahja bashkë me nxënësit e klasës I-2 me rastin e festës së vitit të ri

Më datë 26.12.2023- program i përgaditur i mësueses Arjeta Dalipi bashkë me nxënësit e klasës I-1 me rastin e festës së vitit të ri

Më datë 27.12.2023- program i përgaditur i mësueses Shfika Rexhepi bashkë me nxënësit e klasës I-3 me rastin e festës së vitit të ri

Më datë 27.12.2023- program i përgaditur nga mësueset e shfp-Gjurgjevisht bashkë me nxënësit e ciklit të ulët me rastin e festës së vitit të ri

Më datë 27.12.2023-Nxënësit e shkollës sonë ishin mysafir të Shfk "Ismail Qemali"-Çair e cila për herë të parë organizoi ekspozitë kolektive me tematikën "25 vje ndriçojnë dhjetorin "mësueset mentor, Verim Zendeli.

Më datë 28.12.2023- program i përgaditur i mësueses Nexhibe Hamidi bashkë me nxënësit e klasës II-4 me rastin e festës së vitit të ri

Më datë 29.12.2023- program i përgaditur i mësueses Ajshe Pajaziti bashkë me nxënësit e klasës I-4 me rastin e festës së vitit të ri .

Më datë 29.12.2023- program i përgaditur i mësueses Dashmire Hebibi bashkë me nxënësit e klasës III-1 me rastin e festës së vitit të ri.

Më 30.01.2024 -aktivitet "Packen day në Gjuhë angleze me nxënësit e klasës III/4,III/5 me mësuesen Besa Mustafa

Më datë 05.02.2024 –u realizua orë e hapur në shkollën periferike Senakos nga mësueset e klasave të V-ta Zulhare Osmani dhe Floreta Bilalli me temat "Përshkruajmë kafshët " në Gjuhë Shqipe dhe "Operacionet me numra "në Matematikë .

Më datë 06.02.2024 u realizua një aktivitet me klasat e VIII-Senakos me mësuesen Arminda Muharemi me temën : Shenjat e ndryshimeve kimike ,aktiviteti ndryshe njihet edhe si Elephant toothpaste eksperiment .

Më datë 6.02.2024 u realizua orë e hapur me klasën e V-3 në lëndën e Gjuhës shqipe me mësuesen Fetanete Adili tema "Përemrat vetor "

Më datë 16.02.2024 u realizua orë e hapur në lëndën e biologjisë me klasën e VIII/1 me mësuesen Mirlinda Vejseli me temën : "Sistemi i qarkullimit të gjakut te njeriu"

Më datë 07.03.2024 – me rastin e ditës së mësuesit u realizua aktivitet në Shkollën periferike –Kalisht me mësueset dhe nxënësit e kësaj shkolle .



Më datë 07.03.2024 –u realizua aktiviteti në nivel komunal ku komuna e Vrapçishtit organizoi aktivitetin i cili u realizua në shkollën “Memet Deralla “f.Gradec ku pjesëmarrëse ishte edhe shkolla jonë me dy pika :monolog kushtuar ditës së mësuesit dhe pjesës dramatike kushtuar festës së 7 dhe 8 Marsit me nxënësit e klasave të IX-ta me mësimdhënëset Behije Jonuzi ,Shasine Ragibi dhe Sahide Ebibi –Elezi .

Më datë 08.03.2024 –u realizua aktivitet me rastin e ditës së gruas në klasat e ciklit të ulët me mësimdhënëset Mirlinda Muharemi,Hanfe Bajrami,Alemine Bilalli,Dashmire Ebibi, Shefika Rexhepi,Mirzana Jaja

Më datë 08.03.2024 –u realizua aktivitet për ditën e gruas edhe në shkollën fillore periferike –Gjugjevisht me mësimdhënëset Jehona Mustafa ,Menduhije Xheladini dhe Ardiana Asani

Më datë 11.03.2024 –u realizua në të gjitha shkollat aktivitet për muajin e shenjtë të Ramazanit me mësimdhënëset e ciklit të ulët .

Më datë 20 .03.2024 –me rastin e ditës botërore të “Shëndeti Oral” nxënësit bashkë me mësimdhënëset e ciklit të ulët të shkollës së Gjurgjevishtit realizuan një aktivitet ku u këshilluan nxënësit për mirëmbajtjen e gojës me moton “Gojë e shëndetshme ,trupi i shëndetshëm “

Më datë 21.03 .2024 –me rastin e ditës botërore të sindromës Down mësimdhënësjja Zulihare Osmani në shfp-Senakos me nxënësit e klasës së V/4 kanë trajtuar këtë temë- “Sindroma Down “

Më datë 21.03.2024 –me rastin e ditës së verës mësimdhënëset Hanife Bajrami ,Mirlinda Muhare realizuan aktivitet me klasën e IV/1 ,3 Mirzana Jaja klasa e I/2 ,Nexhibe hamidi II/4 Arta Asani me nxënësit e ciklit të ulët Gjurgjevisht

Më datë 21.03.2024-me rastin e ditës botërore të poezisë mësimdhënësjja Behije Jonuzi realizoi aktivitet me nxënësit e klasës IX/1

Më datë 24.03.2024-u realizua aktivitet në Shfp-Senakos me nxënësit e klasës I/4 më mësimdhënësen Ajshe Pajaziti .



PJESËMARRJA NË GARA PËR VITIN SHKOLLOR 2022/23

Më datë 20.10.2022- Në kuadër të lidhjes së Sportit Shkollor u zhvilluan gara në nivel komunal në futboll ,ku nxënësit e shkollës sonë nuk e vazhduan garën .Mësimdhënësit mentor :Venhar Velija ,Blerim Selmani,Rizvan Asani

Më datë 27.10.2022- Në kuadër të lidhjes së Sportit Shkollor u zhvilluan gara në nivel komunal në voleyboll në mes të shkollës sonë dhe SHFK" Memet Deralla " -Gradec ku vajzat e shkollës sonë fituan garën 3:0 mësimdhënësit mentor Rizvan Asani.

Më datë 31.10.2022- Në kuadër të lidhjes së Sportit Shkollor u zhvilluan gara në nivel ndërkomunal në voleyboll në mes të shkollës sonë dhe SHFK"GOCE DELLÇEV"-Gostivar, ku vajzat e shkollës sonë fituan garën me sete 2:0

Më datë 20.12.2022-- Në kuadër të lidhjes së Sportit Shkollor u zhvilluan gara zonale në voleyboll ku morën pjesë tre shkolla: Shfk "Naim Frashëri " –Negotinë , Shfk "Abdyl Frashëri" –Bogovinë dhe Shfk "Liria" –Tetovë . Shkolla jonë fitoi një lojë ndaj shkollës së Bogovinës dhe humbi ndaj shkollës "Liria " –Tetovë, dhe fituan vendin e dytë. Mësimdhënësi mentor Rizvan Asani.

Më datë 17.12.2022 SHMP "Yahya Kemal" tradicionalisht, çdo vit organizon gara nga gjuhën angleze për ndarjen e bursave për nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave fillore , shkolla jonë mori pjesë në këto gara me 5 nxënës mirëpo nuk patën vende të marra. Mësimdhënësit mentor Arlinda Demiri dhe Liridona Ademi.

Më datë 19.02.2023 SHMP "Yahya Kemal"u oranizuan gara në Matematik/Fizik shkolla jonë mori pjesë në këto gara me 8 nxënës mirpo nuk patën vende të marra .Mësimdhënësit mentor Yllzana Hamza dhe Vjollca Dervishi.

Më datë 02.02.2023-u realizuan garat shkollore nga aktivi i Gj.Angleze ku morën pjesë nxënësit nga kl.V-IX ku vazhduan në gara komunale 10 nxënës me mentorët e tyre .

Më datë 04.02.2023-u realizuan garat komunale në Matematik ku morën pjesë 58 nxënës ku prej tyre vetëm 8 nxënës vazhduan në gara rajonale me mentor Vjollca Dervishi ,Miasere Selmani ,Fetanete Adili dhe Mirzana Jaja .

Më datë 04.03.2023 –u realizuan garat komunale në lëndën e gjeografisë ku morën pjesë 3 nx.klasa e VI-ta dhe 3 nx.klasa e VIII-t me mentor Isen Demiri dhe Blerta Amiti.



Më datë 18.03.2023 –u realizuan gara komunale në Gj. angleze të cilët u organizuan nga ELTAM ku morën pjesë 10 nxënës , prej tyre 6 nxënës vazhduan garën me mentor Florije Bilalli ,Zana Dalipi Albulena Xheladini,Arlinda Demiri ,Besa Mustafa ,Liridona Ademi

Më datë 08.04.2023-u realizuan garat regjionale në gjeografi ku shkolla jonë mori pjesë me 6 nxënës ku 1 prej tyre vazhdoi garën me mentor Isen demiri

Më datë 08.04.2023-u realizuan garat regjionale në Gj.Angleze ku shkolla jonë mori pjesë me 6 nxënës ku prej tyre 4 nxënës vazhduan garën
Mësimdhënës mentorë: Florije Bilalli , Albulena Xheladini,Arlinda Demiri ,Besa Mustafa

Më datë 06.05.2023-u realizuan garat republikane në Gj.Angleze ku shkolla jonë mori pjesë me 4 nxënës
Mësimdhënës mentorë: Florije Bilalli,Arlinda Demiri,Liridona Ademi.

Më datë 13.05.2023 –u realizuan garat republikane në Gjeografi ku shkolla jonë mori pjesë me 1 nx. me mentor Isen Demiri.

7.PJESËMARRJE NË GARA NË GJYSMËVJETORIN E PARË TË VITIT SHKOLLOR 2023/24

Më datë 01.11.2023 u realizua "Krosi vjeshtor" në shkollat periferike Senakos me mësimdhënësin e afsh-Rizvan Asani dhe në shkollën e Gjurgjevishtit me mësimdhënësin Sherif Mustafa .

Më datë 15.11.2023, në kuadër të Lidhjes së Sportit Shkollor në palestrën e sportit të Shfk-Mustafa Kemal Atatürk"-Gostivar u mbajtën garat ndërkomunale për femrat në Volejboll,ku fitues u shpall shkolla jonë me mësimdhënësit e Ars.Fizik-Venhar Velija dhe Blerim Selmanin.

Më datë 07.11.2023-u realizua "Krosi vjeshtor" në shkollën qendrore Negotinë me mësimdhënësit e Ars.Fizik-Venhar Velija dhe Blerim Selmanin. Nxënësit fitues:Muhamet Mustafa kl.VI-3

Eda Kamberi kl.VI-2

Faton Dalipi kl.VII-2

Bleran Mamuti kl VIII-2

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

Më datë 12.12.2023-në kuadër të lidhjes së Sportit Shkollor u mbajtën garat zonale në volejboll –femra ku shkolla jonë ishte pjesë e këtij aktiviteti sportiv

Më datë 22.03.2024-u realizuan garat në matematikë me nxënësit e shkollës sonë ku morën pjesë gjithsej 32 nxënës në “Kengur 2024” rrethi I parë preliminar me mësime ndihëset mentor :Vjollca Dervishi ,Mijasere Selmani ,Fetanete Adili.





Vetevaluimi i shkollës: Shf.k. " Naim Frashëri"

fusha 1: Planet dhe programet mësimore

Mledhja e të dhënave cilat metoda janë përdorur për mbledhjen e të dhënave? (psh. pyetësor, anketime, vëzhgime etj.)		
Paraqiti metodat tjera që janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja: Kush ishte i kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat të dhëna janë mbledhur?
Pyetësor për arsimtarët	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Special	Nga 94 arsimtarë ose 99 % të arsimtarëve prej të cilëve 34 meshkuj dhe 60 femra, janë të gjithë shqiptarë Nga të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi në orë mësimore 95% të arsimtarëve deklaruan se me sukses janë realizuar planet dhe programet mësimore. Me bashkëpunim të ndërmjetshëm në kohë janë pregatitur planet e tyre tematike e globale, përgaditjeet ditore cek listat etj. Sipas 95 % të tyre bashkëpunimi i tyre me shërbimin profesional të shkollës si dhe institucionet e jashtme në punën me nxënësit është në nivel të duhur. Gjatë përgaditjes dhe realizimit të planeve mësimore 70 % të arsimtarëve përballen me vështirësi të materialeve teknike dhe natyrës financiare. Gjithsej të anketuar ishin 240 nxënës, nga të cilët të gjithë janë shqiptarë nga klasa e VI-IX-ta .



Anketim me nxënësit	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Special	90 % nga nxënësit janë të kënaqur nga shkolla si dhe realizimi i mësimi. Janë të motivuar për dhënien e ideve të reja dhe bashkëpunim me të tjerët 87 % nga nxënësit janë të informuar në kohë për përmbajtjet e planeve dhe programeve mësimore dhe tematike dhe kanë dijeni për të njejtat. Sipas 92 % e tyre mësimi në shkollë zhvillohet në nivel solid dhe shfrytëzimin e metodave dhe teknikave të ndryshme mësimore. Nxënësit kanë mundësi për pjesëmarrje në aktivitetet jashtëmësimore prej të cilëve 80 % duan të marrin detyra shtëpie, lehtë i realizojnë pa ndonjë vështirësi dhe me përgjegjësi i zbatojnë detyrat dhe obligimet e tyre. 90 % nga nxënësit janë shprehur se shkolla i mbron nga dhuna, përdorimit të drogës dhe zgjon tek ato ndjenjën e vetë kontrollit, përgjegjësisë dhe më shumë pavarësinë për punë.
---------------------	---	---



- Pyetësor për prindërit;

- Pedagogu i shkollës;
- Psikologu
- Edukator Special

Të anketuarit nga ana e prindërve gjithsej ishin 180 prindër nga të cilët të gjithë janë shqiptarë.

83 % nga prindërit janë të kënaqur nga kualiteti dhe mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor duke marrë parasysh profesionalitetin e arsimtarëve dhe angazhimin e tyre.

Sipas 75 % të prindërve përmabajtjet arsimore janë të përshtatshme për moshën dhe aftësinë e nxënësve në shkollë.

Prindërit të cilët i kanë nxënësit në cikëlin lëndor janë mirë të informuar për lëndët zgjedhore në klasën e VI, VII, VIII dhe IX. Në bazë të anketimit që zhvillohet në muajin Maj .



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri "

fusha 1: Planet dhe programet mësimore

Anët e forta

- Planet dhe programet mësimore në të gjithë lëndët mësimore me përmbajtje që janë të punuar me kualitet
- Procesin arsimor e realizon kuadër pëkatës arsimor
- Në shkollë egzistojnë dhe punojnë më shumë aktivitete të lira arsimore
- Egziston bashkëpunim i ndërsjelltë me nivel të aktiveve profesionale;
- Realizimi i projekteve të cilat promovojnë vlerat demokratike të sjelljes së nxënësve
- Realizimi i projekteve nga nxënësit të cilët promovojnë vetëdije shëndetësore dhe kulturore.
- Hapësira e mjaftueshme në shkollë për realizimin e aktiviteteve jashtëshkollore;

Anët e dobëta

- Paisja e dobët e nxënësve me materiale ndihmëse;
- Edukimi i mësuesve për përgaditjen e planeve dhe programeve të shkurtra në situatë të vitit shkollor të shkurtuar
- Plan programet mësimore të reja në vite të caktuara të arsimit;
- Përfshirja e pamjaftueshme e prindërve dhe nxënësve në procesin e planifikimit të përmbajtjeve dhe aktiviteteve në klasat e rregullta;
- Nevoja për edukim plotësues të kuadrit mësimor për përgaditjen e planeve dhe përcaktimin e qëllimeve;
- Paisja e pamjaftueshme e shkollës me literaturë profesionale për mësimdhënësit;

Aktivitete në të ardhmen:

Prioritetet e nënfushave në suazat e kësaj fushe të cilat mund të jenë të kyçura në planet për zhvillim të shkollës.

- Sigurimi i mjeteve mësimore bashkëkohore
- Kompletimi edhe më i mirë i kabinetit për fizikë dhe kimi dhe sigurimi i mësimi kabinetik në të gjitha lëndët mësimore;
- Zhvillimi profesional i kuadrit arsimor për rolet e tyre të reja në udhëheqjen në klasë si dhe zbatimin e metodave bashkëkohore për planifikim dhe vlerësim(notim).

Çertifikimi i mësimdhënësive në komponentet e parapara: Shkrim ,leximi gjuhësor.



Analiza e rezultateve:

Këtu jepet evaluim të detajuar të kësaj fushe

Në shkollën tonë planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH realizohen me sukses. Të njëjtat janë përshtatur për aftësitë psikofizike individuale të nxënësve dhe mundësia për pjesëmarrjen e prindërve në realizimin e tyre.

Te llojet e mësimi: të detyrueshëm, zgjedhor, aktiviteteve të lira të nxënësve dhe mësimi plotësues dhe shtues janë planifikuar dhe realizuar në një nivel të duhur.

Arsimtarët kanë mundësi për modifikimin e planeve dhe programeve mësimore nëpërmjet aktiveve profesionale arsimore dhe përmes zbatimit të metodave dhe teknikave aktive të mësimi.

Mësimi i integruar jep mundësi për angazhim të plotë të nxënësve në zgjedhjen e problemeve dhe detyrave, ardhjen deri te idet e reja dhe punën konkrete. Kjo e arrin nevojën për përkryerjen e arsimtarëve për rolin e tyre të ri në udhëheqjen në klasë.

Gjatë realizimit të planeve dhe programeve mësimore egziston e njëjta mundësi për pjesëmarrje të nxënësve në udhëheqje , bashkëpunim, marrëveshje, vetbesim dhe zgjidhjen e konflikteteve.

Bashkëpunimi i shkollës me rrethin realizohet përmes kycjes aktive të shkollës në rrethin dhe informimin e rezultateve të arritura të saj. Në shkollë me suksesë realizohen shumë projekte që u mundëson nxënësve të përcjellin pasqyra demokratike gjatë marrjes së vendimeve dhe zgjidhjes së konflikteteve.

Te një pjesë e arsimtarëve ndjehet nevoja për zhvillim profesional sidomos njohje informatike, deri më tani për sa i takon kësaj lëmie janë realizuar disa seminare dhe projekte



Vetevaluimi i shkollës: Shf.k."Naim Frashëri"

fusha 2: Arritja e nxënësve

Në evaluimin e kësaj fushe duhet të përgjigjeni në numër sa më të madh të këtyre pyetjeve.

Mund të shtojmë përgjigje edhe të pyetjeve tjera për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për shkollën tuaj dhe nuk janë të përfshira në kornizat e vetevaluimit.

Ju mund të shtoni dhe të bëni përpjekje sa është e mundur për të shtuar të gjithë faktorët që është e mundur në shkollën tuaj dhe komunitetin lokal ku është e nevojshme të kujdesemi për lidhjet familjare të cilat mund të ndikojnë në kualitetin e mësimi dhe procesit mësimorë në shkollën tuaj.

Mos mbështeteni vetëm në dokumentet e shkruara. Siguroni që të dhënat e mbledhura në këtë fushë po ashtu të përfshijnë sa më shumë komente të shkruara, vëzhgime dhe dëshmi vizuale.

Treguesit e cilësisë

Temat

2.1

Arritjet e nxënësve

- Përcjellja e arritjeve të nxënësve nga gjini të ndryshme dhe nga gjuhë të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave kualifikuese
- Mirësimi i arritjeve të nxënësve
- Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në mësim, të nxënësve të talentuar dhe të nxënësve me pengim (me pengesa në zhvillim)
- Mirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimi të rregullt dhe plotësues
- Ndjekja e lëvizjes horizontale dhe vertikale

2.2

Ruajtja

Shpërndarja e nxënësve

- Përfshirja e nxënësve
- Rregullshmëria në mësim

2.3

Përsëritja e nxënësve

- Shkapërderdhja e nxënësve
- Kalimi i nxënësve nga një shkollë në tjetër
- Nxënës që nuk e kryejnë vitin/arsimin



Vetevaluimi i shkollës: Shf"Naим Frashëri "

fusha 2: Arritja e nxënësve

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë përdorur).

Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha dokumentat të cilat janë shqyrtuar

Treguesit e cilësisë

Burimet e informacionit

Cilat informacione janë mbledhur?

2.1.1.Përcjellja e arritjeve të nxënësve nga gjini të ndryshme dhe nga gjuhë të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave kualifikuese

Ditari elektronik

Listat eviodentuese

Pasqyrat e suksesit Procesverbalet e këshillit të arsimtarëve

Procesverbalet e aktiveve

2.1 Arritjet e nxënësve

- Shkolla në vazhdimësi ndjek planifikimin dhe realizimin dhe notimin dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve, e që ky i fundit, pra vlerësimi të jetë më i saktë dhe të korrespondojë me realitetin, mësimdhënësit ndjekin vazhdimisht të arriturat e nxënësve dhe vlerësojnë ato në mënyra të ndryshme si vlerësimin formativ, mikrosumativ dhe sumativ.

- Nga evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik, raportet, statistikën, fletat

evidentues për suksesin e nxënësve në periudhën kualifikuese gjatë viteve shkollore, bisedave me mësimdhënësit, pedagog, drejtor si duket janë mirë të përpunuara të cilat shërbejnë gjatë evaulimeve të ndryshme, shkolla luan rol të rëndësishëm në përmirësimin e të arriturave të nxënësve. Shkolla merr dhe përpunon të dhëna nga kujdestarët e klasave për vlerësimet në tremujorin e parë, gjysmëvjetor , tremujorin e tretë dhe në fund të vitit shkollor. Përveç se për suksesin, përpunohen të dhëna edhe për sjelljen dhe rregullshmërinë e nxënësve për secilin tremujor shkollor. Si dukuri në vitet e fundit edhe këto dy vite shkollore, karakteristike është se numri i nxënësve është në ulje nga viti në vit.

- Shkolla ka shënime të mjaftueshme për arritjet e nxënësve, në bazë të gjinive, lëndëve mësimore, sipas periudhave kualifikuese dy vitet e fundit. Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Fillor , në shkollën tonë realizohen këto lloje notimesh:



2.1.2 Përmirësimi i arritjeve të nxënësve

Programet vjetore

Raporti i punës
shkollor

Bisedë me kuadrin
arsimor dhe kuadrin profesional

2.1.3 Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në mësim, të nxënësve të talentuar dhe të nxënësve me pengim (me pengesa në zhvillim)

Raporte të punës

Intervista me
pedagog

Notimi përshkrues realizohet në klasat: I, II, III; notimi i kombinuar (përshkrues dhe numerike) IV;V;VI si dhe përshkrim numerik VII;VIII;IX. Sa i përket suksesit të nxënësve në periudhat kualifikuese të dy viteve të fundit, shkolla ka të dhëna të mjaftueshme për suksesin e nxënësve më të detajuara në cdo periudhë kohore, edhe atë:

Dy vitet e fundit në bazë të dinamikave të periudhave kualifikuese në vitet shkollore kemi këtë sukses të nxënësve e cila është e paraqitur në mënyrë tabelare më poshtë

Përmirësimi i të arriturave të nxënësve është arritur me anë të angazhimit (mundësive) me kuadër përkatës profesional, përmirësim dukshëm të kushteve, aplikimin e mjeteve mësimore dhe ndihmëse, literaturë profesionale, zbatimin e TIK-ut në mësim, mënyrat dhe format e ndryshme të mësimit bashkëkohor, realizim të ekskurzioneve shkollore dhe aktiviteteve tjera jashtëmësimore..

Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe – të gjithë nxënësit janë shqiptarë, në bazë të statistikave dhe analizës krahasuese të gjinive, karakteristike, nxënësit e gjinisë femërore tregojnë rezultate më të mira të suksesit se sa meshkujt.

Shkolla ka mundësi të identifikon nxënësit me nevojë të veçanta që kanë vështirësi në mësim, talent të veçantë, diskutime, mbahen shënime nga kujdestarët e klasave dhe grupi inkluziv i shkollës, mirëpo përparimi i tyre përcillet në mënyrë josisematike, dhe nuk ka plane dhe programe të veçanta diferenciale - duhet të përgaditen procedura për këta nxënës. Numri më i madh i arsimtarëve në mësim të rregullt sigurojnë përkrahje për nxënësit në mësim të rregullt që kanë vështirësi gjatë të mësuarit dhe mbajnë mësim plotësues (më e theksuar është në mësim klasor). Për nxënësit e talentuar mbajnë mësim shtesë ku u jepet mundësia për shfrytëzim të materialit mësimor plotësues dhe material me burime të ndryshme informacionesh të cilat i prezantojnë përmes garave shkollore,



	komunale, regionale në lëndë të ndryshme. Për nxënësit me nevoja të veçanta (arsimore) nuk ka paralele të veçantë po funksionon ekipi i inkluzionit, sipas rregullores dhe obligimeve ligjore.
2.1.4 Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimit të rregullt dhe plotësues Intervistë me kuadrin Arsimor	Të gjithë nxënësit e mbarojnë ciklin mësimorë, disa me sukses të dobët, disa me sukses të mirë, pa dallim gjinie. Nxënësit të cilët kanë treguar sukses të dobët në një ose dy lëndë mësimore në fundë të vitit shkollor organizohet mësim plotësues.
2.1.5 Ndjekja dhe aritja e nxënësve të rregullt dhe të çrregullt nga një cikël në tjetrin dhe nga një nivel arsimor në tjetrin Statistikat shkollore	Shkolla ka të grumbulluara shënime, statistika, për arritjet e nxënësve, shërbimi pedagogjik, arsimtarët, kujdestarët e klasave mirëpo deri tani nuk është bërë ndonjë analizë apo raport i duhur dhe i mjaftueshëm për përcjelljen e të arriturave të nxënësve prej një cikli arsimor në tjetrin d.m.th. I –III, IV –VI, dhe VII –IX, dhe të bëhet analizë krahasuese.
2.1.6 Ndjekja e lëvizjes horizontale dhe vertikale - Ligji për arsim fillor - Statuti i shkollës	Sipas rregullores dhe politikave arsimore në shkollën tonë mundësia e lëvizjes në aspektin horizontal, kalimi i nxënësve prej një paraleleje në tjetrën në moshë të njëjtë të nxënësve bëhet me propozim të kujdestarit të klasës dhe mendim të bashkëpunëtorit profesional si dhe udhëheqësisë së shkollës. Mirëpo, shkolla nuk ka politikën e vet bazuar në rregulloret e punës. Në realizimin vertikal në nivel më të lartë nuk kemi raste të tilla dy vitet e fundit. (bazuar në dhënie të mendimit apo kërkesë e prindit).
2.2.1 Përfshirja e nxënësve	<u>2.2.Mbajtja/Shpërndarja e nxënësve</u> Në bazë të evidencës të gjithë nxënësit e lokalitetit të f. Negotinë dhe fshatrave të shkollave periferike krejtësisht janë të përfshirë me shkollimin fillor obligativ.vetëm raste ne periudhën e regjistrimit muajin



Raporti i pedagogut	maj - për kl. I-parë numri i nxënësve që nuk regjistorhen dorëzojnë dëshmi me shkresë për vijim të mësimi në shkollë tjetër apo shtet tjetër me çka shkolla bashkëpunon me komunën, I.SH.A, shkollat tjera dhe familjet.
Shënimet ekujdestarëve të klasës	Numri i të regjistruarëve është i ulët në bazë të listave për regjistrim, ku për vitin e ardhshëm shkollor janë rregjistruar 53 nxënës fillestarë.
Shërbimet e shërbimit administrativ shkollor	Shkolla ka hartuar një procedurë për regjistrimin e nxënësve të sapoardhur dhe çregjistruar nga shkolla, e cila respektohet plotësisht. Me rastin e regjistrimit të nxënësve të sapoardhur, shkolla jep pëlqimin me shkrim dhe ia dërgon shkollës nga vjen nxënësi. . Kur nxënësi lirohet nga shkolla, prindi paraqet kërkesë për largimin e nxënësit nga shkolla dhe dorëzon pëlqimin me shkrim nga shkolla fillore në të cilën nxënësi do të vazhdojë shkollimin dhe më pas i lëshohet përkthimi dhe dokumenti i nxënësit. kartelë. Shkolla jonë dërgon menjëherë letra kthyesë informacione në shkollat fillore nga vijnë nxënësit tanë të rinj dhe shkolla merr letra kthyesë
Libri kryesor	Shkolla jonë mban evidencë për rregullshmërinë e nxënësve në ditarin elektronik dhe sipas rregullores nxënësit i cili kalon mbi 10 mungesa të paarsyeshme, i dërgohet prindit ftesë për bisedë këshillim. Për këshillimin e realizuar mbahet rregullisht procesverbal. Në kohën e duhur dhe sipas rregullores së shkollës shqiptohen masa pedagogjike për mungesat e pajustificuara dhe si pasojë e këtyre aktiviteteve numri i mungesave të paarsyeshme është në rënie të vazhdueshme. Shkolla jonë gjithmonë zbaton procedurat e shqiptimit të masave pedagogjike me dokumentacion bazuar në ligjin për arsim fillor dhe është përpiluar rregullore interne për mënyrën e shqiptimit të masave pedagogjike ,në mënyrë tabelare do ta paraqesim më poshtë
2.2.2 Rregullshmëria në mësim	Shkolla ka evidencë për nxënësit e shpërngulur, mirëpo nuk i dimë më gjërësisht shkaqet, arsyet e shpërndarjes por supozojmë se janë të natyrës së shpërnguljeve familjare në shtetet e jashtme dhe të bëhet përpjekje të mundshme për zvogëlim të numrit të cilën në mënyrë tabelare do ta paraqesim më poshtë Kjo procedurë në shkollë respektohet tërësisht.
Intervistë me shërbimin pedagogjik	Procedurën e kalimit të nxënësit prej një shkolle në tjetrën
Statistika e klasave	
2.2.3 Shpërndarja e nxënësve	
Evidenca shkollore,	
Intervista me pedagogun e shkollës,	
Raporti i shkollës	
2.2.4 Kalimi i nxënësve nga një shkollë në tjetër	
Evidenca shkollore,	



2.3.1 Nxënës që nuk e kryejnë apo e humbin vitin

Evidencat e dokumentacionit pedagogjik

Raportet e punës ,Procesverbalet e mbledhjeve me strukturat shkollore

2.3 Përsëritja e nxënësve

Numër shumë i vogël i nxënësve përsërisin vitin, vetëm në raste të rralla të mospërcjelljes së mësimi, ata nxënës ngelen të panotuar.

Në vitin shkollor 2022-2023 ,ngelën të panotuar 35 nxënës për shkak të mosndjekjes së mësimi të rregullt.

Vitin shkollor 2023-2024 janë 4 nxënës të panotuar ose humbin vitin,të gjitha këto janë të paraqitura në mënyrë tabelare më poshtë .



Pasqyra e suksesit të përgjithshme të nxënësve sipas gjuhës mësimore në fund të vitit shkollor 2022/2023 mësimi në gjuhë shqipe.

KLASA	Gjithsejt- Вкупно		1		2		3		4		Вкупно Gjithëse		1		2		3		4		Сред наоцен/Na a mesata	
	Nxënës Ученици		Одличен Shkqy		Мн.Доб Sh.mirë		Добри mirë		Довол Mjaft.				Me 1 të dobët		M e 2 të do bë ta		Со 3 сл. Me 3 e më shumë të dobëta		Неоцените/ Të panotuarit			
	Ce/ gj	ж/f	Бр /nr	%	Бр /nr	%	Б р / n r	%	Бр /nr	%	Бр		Бр.	%	Бр	%	Бр.	%	Бр.	%		
I	45	25										43							2			
II	58	24										54							4			
III	46	17										45							1			
IV	79	44	23	42	12	20	4	8	2	5		75							4		4.22	
V	61	30	25	34	2	12	0	7	2	4		57							4		4.07	
I- V	289	140	48	76	14	32	4	15	4	9		274							15		4.14	
VI	86	43	19	35	13	21	5	16	3	5		77							9		3.73	
VI I	77	40	20	33	6	14	4	14	4	10		71							6		3,7	
VI II	61	27	14	24	5	8	5	19	3	9		60							1		3,67	
IX	72	34	21	23	2	10	7	18	2	10		69							3		3,6	
VI - IX	296	144	74	115	26	53	21	67	12	34		277							19		3,67	
I- IX	585	284										551							34		3,90	



Pasqyra e suksesit të përgjithshme të nxënësve sipas gjuhës mësimore në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024 mësimi në gjuhë shqipe.

KLASA	Gjithsejt		1		2		3		4		Вкупн о Gjithës е		1		2		3		4		Сред наоцен/ ота mesata	
	Nxënës Ученици		Одличе н Shkqy		Мн.Доб Sh.mirë		Добр и mirë		Довол Мјаft.				Со 1 сл Me 1 тë dobë t		Со 2 сл Me 2 тë do bë ta		Со 3 сл. Me 3 e më shum ë të dobët a		Неоценит е/ Тë panotuarit			
	Се/ gj	ж/f	Б р/ nr	%	Б р/ nr	%	Б р / n r	%	Б р/ nr	%	Бр	%	Бр	%	Б р.	%	Бр.	%	Бр.	%		
I	58	26									57								5			
II	45	27									45								4			
III	61	27									60								5			
IV	48	20									47								5			
V	76	41									74								4			
I- V	288	141									283								23			
VI	62	31									61								9			
VI I	86	43	9	18	14	21	6	9	2	4	86		4	8	0	0	7	1	3	3	3.32	
VI II	72	34	16	22	7	14	4	8	0	3	72		0	6	0	0	5	1	5	4	3.36	
IX	62	29	7	8	8	14	4	11	1	3	61		4	1	0	0	2	9	5	3.11		
VI - IX	282	137	32	48	29	49	14	38	3	10	280		85	2	0	0	14	3	21	3.26		
I- IX	570	278	32	48	29	49	14	38	3	10	563		85	2	0	0	14	3	44	3.26		



Pasqyra e nxënësve të çregjistruar në gjysmëvjetorin e parë për vitin shkollor:2022/2023

Наставенјазик	I		II		III		IV		V		VI		VII		VIII		IX		
Gjuha mësimore	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	Вк.гј	Ж.ф	
Макед.Маqed.																			
Албан.Shqip	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1	0	2	2	2	0	0	0	7

Pasqyra e nxënësve të çregjistruar në fund të vitit shkollor:2022/2023

Наставенјаз ик	I		II		III		IV		V		VI		VII		VIII		IX			
	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.	Вк.г	Ж.
	г	ф	г	ф	г	ф	г	ф	г	ф	г	ф	г	ф	г	ф	г	ф	г	ф
Gjuha mësimore																				
Макед.Маqed.																				
Албан.Shqip	3	1	3	1	1	0	3	1	1	1	3	2	0	0	6	5	0	0	20	11

Pasqyra e nxënësve të çregjistruar në gjysmëvjetorin e parë për vitin shkollor:2023/2024

Наставен јазик	I		II		III		IV		V		VI		VII		VIII		IX			
	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф	Вк.г ј	Ж.. ф		
Gjuha mësimore																				
Маке.Маке.																				
Албански.Shqip P	1	0	0	0	1	0	1	0	2	2	1	1	0	0	0	0	1	1	7	4



9.3 Pasqyra e mungesave të nxënësve në gjysmëvjetorit e parë të vitit shkollor 2022/2023

Наставен јазик	Ллој i mungesave Изостаноц и	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII.	IX	Gjithsejt: Вкупно
Gjuha mësimore											
Gjuhë shqipe Албанск и јазик	Тë arsyeshme оправдани	0	205	28	61	29	593	542	668	1278	3404
	Тë paarsyeshme неоправдани	0	0	44	57	34	161	158	279	244	977
	Gjithsejt: Вкупно	0	205	72	118	63	754	700	947	1522	4381

Pasqyra e mungesave të nxënësve në fund të vitit shkollor 2022/2023

Наставен јазик	Ллој i mungesave Изостаноц и	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII.	IX	Gjithsejt: Вкупно
Gjuha mësimore											
Gjuhë shqipe Албанск и јазик	Тë arsyeshme оправдани	0	0	0	214	47	1935	1415	1924	2522	8057
	Тë paarsyeshme неоправдани	0	0	0	39	175	361	342	708	459	2084
	Gjithsejt: Вкупно	0	0	0	253	222	2216	1811	2632	2981	10141

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

Pasqyra e mungesave të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/20224

Наставен јазик	Lloj i mungesave Изостаноц и	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII.	IX	Gjithsejt:Вкупно
Gjuha mësimore											
Gjuhë shqipe Албанск и јазик	Тë arsyeshme оправдани	0	0	0	0	46	474	1063	877	1607	4607
	Тë paarsyeshme неоправдани	0	0	0	0	23	205	278	399	1131	2063
	Gjithsejt: Вкупно	0	0	0	0	69	632	1341	1276	2968	6286



Vetevaluimi i shkollës: Shf.k. " Naim Frashëri"

fusha 2 : Arritja e nxënësve

Mledhja e të dhënave tjera, cilat metoda janë përdorur për mbledhjen e të dhënave? (psh. Pyetësor, anketime, vëzhgime etj.)		
Paraqiti metodat tjera që janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja: Kush ishte i kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat të dhëna janë mbledhur?
Pyetsor për arsimtarët Bisedime resiproke	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Special	Prej 90 arsimtarëve të anketuar , 90 % të arsimtarëve rregullisht i ndjekin rezultatet dhe përparimet e nxënësve. Sipas 85 % të tyre gjatë notimit i marrin parasysh edhe mendimet e nxënësve për arritjen e tyre personale. 80 % janë deklaruar se arsimtarët bisedojnë me nxënësit për mënyrën e notimit kurse 95 % rregullisht informojnë për përparimin e tyre. Shkolla ka një sistem të mirë të zhvilluar për notimin e drejtë dhe për arritjet e nxënësve sipas 81 % të tyre. Dhe plotëson nevojat për diturit e nxënësve pa dallim të mundësive të tyre sipas 87.2 % të nxënësve të anketuar.
Pyetsor për prindërit Bisedime	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Special	Nga 150 prindër të anketuar 89 % mendojnë se arsimtarët janë të kujdesshëm për nxënësit e tyre dhe arrijnë sukses maksimal. 80.5 % e prindërve rregullisht informohen për përparimin dhe të arriturat e fëmijëve të tyre. 70 % janë në kontakt të vazhdueshëm me arsimtarët dhe 90% lirisht mund të drejtohen te ato për çfardo lloj problemi. Bahkëpunatori profesional ka mardhënie të mira me prindërit dhe nxënësve ua jep përkrahjen e duhur janë deklaruar 90 %.



		88 % janë deklaruar se arsimtarët çdoherë pozitivisht i vlerësojnë rezultatet dhe suksesin e nxënësve.
Pyetsor për nxënësit	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Special	82.4 % e nxënësve të anketuar janë deklaruar se notimi i të arriturave të tyre është në kontinuitet. Një pjesë e arsimtarëve gjegjësisht 24.5 % gjatë notimit të diturive në lëndën e tyre i marrin parasysh edhe notat nga lëndët tjera. 73% e nxënësve mundohen sa është e mundur të mësojnë, 75 % duan të marrin detyra dhe shumë lehtë i realizojnë pa ndonjë vështirësi të veçantë. 97 % duan të shkojnë në shkollë dhe shumë rrallë e lëshojnë mësimin
Bisedime		
Vëzhgim		
Analizë		



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 2 : Arritja e nxënësve

Rezultatet: Këtu duhet shkurt të arsyetoni anët kyçe të forta të juajat dhe anët kyçe të dobëta juajat

Anët e forta:

- Shkolla i përshtat planet sipas kërkesave dhe nevojave të nxënësve
- Prindërit dhe nxënësit rregullisht informohen për arritjet e tyre
- Për të gjithë nxënësit rregullisht mbahet evidence për përparimin e tyre
- Egziston bashkëpunimi i mirë ndërmjet nxënësve, kuadrit arsimor, bashkëpunëtorëve profesional
- Shumica e prindërve të nxënësve janë të kënaqur me suksesin e tyre
- Shkolla ka të dhëna të mjaftueshme për suksesin e nxënësve, gjininë, klasat (gjysëmvetor, fund i vitit shkollorë)
- Shkolla ka evidence për nxënësit e ardhur dhe të ç'rregjistruar në evidencë dhe dokumentacionin pedagogjik

Anët e dobëta:

- Duhet më tepër përpjekje profesionale nga ana e mësimeve për planifikim dhe realizim të mësimi
- Realizim të mësimi për punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore si dhe me nxënës të talentuar dhe dhunti
- Është e nevojshme si dhe sfidë e kohës të tejkalohet krejtësisht mësimi tradicional
- Duhet të bëhet përpjekje për inicim të trajnimeve në fushën e vlerësimit të nxënësve në aspektin e notimit real dhe objektiv bazuar në standardet e notimit
- I gjithë kuadri arsimorë duhet të respektojë procedurën dhe rregulloren për shqiptimin e masave pedagogjike në kohë .



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 2 : Arritja e nxënësve

Aktivitete në të ardhmen: Prioritetet e nënfushave në suazat e kësaj fushe të cilat mund të jenë të kyçura në planet për zhvillim të shkollës.

- Përfshirja e prindërve në procesin e përmirësimit të arritjeve të nxënësve në të gjithë procesin arsimor.
- Përmirësimi i rregullsisë dhe disiplinës së nxënësve (punë me grupe të vogla) puna e një ekipi profesional të Pedagogut, Psikologut dhe stafit mësimor.
- Prokurimi i mjeteve dhe ndihmave, si dhe gjetja e fondeve për materiale harxhuese, për të realizuar më lehtë përmbajtjet mësimore dhe për të lehtësuar mësuesin në punë.
- Të modernizohet, domethënë me mjete të reja teknike dhe teknologjike, të afrohen planprogramet mësimore për nxënësit dhe të fokusohet interesimi i tyre dhe pasurimi i njohurive të tyre.

Analiza e rezultateve:

Këtu jepni evaluim të detajuar të kësaj fushe

Mësimi bashkëkohor dhe kualitativ është një ndër faktorët kryesorë i cili ndikon në përmirësimin e suksesit të nxënësve. Në shkollën tonë kjo arrihet me ndjekjen e metodave dhe teknikave të reja bashkëkohore të të mësuarit, prezenca aktive e nxënësve në mësim, me përgatitjet e ndryshme të projekteve, portofolie etj. Të kyçur edhe persona të jashtëm të cilët në korniza të fushës së tyre ndikojnë në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë në diturinë dhe arritjet e nxënësve në procesin e ndjekjes së diturisë së nxënësve njëjtë trajtohen pa ndonjë ndryshim të dy gjinitë e nxënësve. Arritjet e nxënësve rregullisht ndiqen dhe raportohen nga ana e këshillit arsimor. Një lloj punohet edhe për përmirësimin e suksesit edhe të atyre nxënësve që kanë vështirësi në mësim dhe me nxënësit e talentuar. Me strategjinë e mirë të organizuar dhe planit për punë të gjithë nxënësve ju mundësohet me sukses ta kryejnë arsimin fillor.

Për punën me nxënësit me nevoja të veçanta nuk ka të përgatitura plane dhe programe të veçanta, por arritjet e tyre ndiqen nëpërmjet dhënies së detyrave aq sa tu përshtatet aftësive të tyre, përpunim i ushtrimeve që e rrisin kreativitetin e tyre dhe ndjenjën e vetëregimit.

Prindërit konstatojnë se arsimtarët janë të kujdesshëm për nxënësit e tyre dhe arritjen e suksesit maksimal.

Rregullisht janë të informuar për arritjet e fëmijëve të tyre, janë vazhdimisht në kontakt me arsimtarët dhe për çfarëdo lloj problemi mund të drejtohen te ato.

Arsimtarët rregullisht ndjekin dhe vëzhgojnë arritjet dhe sukseset e nxënësve. Gjatë notimit merret parasysh edhe mendimi i tyre në arritjet e tyre.

Arsimtarët bisedojnë me nxënësit për çështjen e notimit për arritjet e tyre dhe rregullisht i informojnë për garat e tyre. Shkolla ka sistem zhvillimor të mirë për notimin e drejtë për arritjet e nxënësve dhe ju jep mundësi për nevojat e tyre në dituri pa dallim në afësin e tyre.



Vetëvaluimi i shkollës: Shf.k." Naim Frashëri"

fusha 3: Mësimi dhe mësimdhënia

Në evaluimin e kësaj fushe duhet të përgjigjeni në numër sa më të madh të këtyre pyetjeve.

Mund të shtoni përgjigje edhe të pyetjeve tjera për të cilat mendoni se janë të rëndësishme për shkollën tuaj dhe nuk janë të përfshira në kornizat e vetëvaluimit.

Ju mund të shtoni dhe të bëni përpjekje sa është e mundur për të shtuar të gjithë faktorët që është e mundur në shkollën tuaj dhe komunitetin lokal ku është e nevojshme të kujdeseni për lidhjet familjare të cilat mund të ndikojnë në kualitetin e mësimi dhe procesit mësimorë në shkollën tuaj.

Mos mbështeteni vetëm në dokumentet e shkruara. Siguroni që të dhënat e mbledhura në këtë fushë po ashtu të përfshijnë sa më shumë komente të shkruara, vëzhgime dhe dëshmi vizuale.

Treguesit e cilësisë		Temat
3.1	Planifikimet e	- Mbështetja dhe ndjekja e planifikimeve të Arsimitarëve - Planifikimet individuale të arsimtarëve
	Mësimdhënësve	- Shkëmbimi i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit - Renditja e orëve
3.2	Procesi mësimdhënës	- Format dhe metodat mësimore - Përdorimi i ICT/TIK në mësimdhënie - Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve - Qasja e arsimtarit ndaj nxënësve - Interaksioni midis arsimtarëve dhe nxënësve - Përcjellja e procesit mësimor - Kryerja e stërvitjes praktike të nxënësve të punëdhënësit



3.3	Përvojat e nxënësve nga mësimi	• Mjedisi për mësim • Atmosfera për mësim • Nxitja e nxënësve për të marrë përgjegjësinë • Interaksioni i nxënësve midis vete • Mësim në kushte reale të punës te punëdhënësi •
3.4	Përmbyshja e nevojave të Nxënësve	• Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve • Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësimdhënie
3.5	Notimi si pjesë e Mësimdhënies	• Politika shkollore për notim • Metodrat dhe format e notimit • Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësimdhënie
3.6	Njoftim për përparimin e Nxënësve	• Njoftim i prindërve për përparimin e nxënësve



Vetevaluimi i shkollës: Shf.k. " Naim Frashëri"

fusha 3 : Mësimi dhe mësimdhënia

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë përdorur).

Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha dokumentat
të cilat janë shqyrtuar
Treguesi i cilësisë
Burimet e informacionit

Cilat informacione janë mbledhur?

3.1.1 Mbështetja dhe ndjekja e
planifikimit të

Mësimdhënësve

Planet dhe programet e
mësimdhënies

Bisedë me drejtor, pedagog,
Procesverbalet dhe vizitat në
orë

Proçeset e aktiveve
profesionale

3.1. Planifikimi i mësimdhënësve

Për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, arsimtarët kryejnë planifikim të punës edukativo arsimore ku qëllimet, përmbajtja, format teknikat e të mësuarit, aktivitetet e arsimtarëve dhe aktivitetet e nxënësve janë të vendosur në marrëdhënie funksionale me njëri tjetrin.

Numri më i madh i mësimdhënësve në kohë i dorëzojnë planet globale, tematike dhe procesuale të shërbimi pedagogjik i shkollës. Shkolla posedon komision për kontrollimin e planeve dhe programeve mësimore nën udhëheqjen e drejtorit dhe shërbimit pedagogjik të shkollës. Planet dhe programet mësimore dorëzohen të shërbimi pedagogjik para fillimit të vitit shkollor (javën e fundit të muajit gusht). Për realizimin efikas të planeve dhe programeve mësimore mësimdhënësit përgatisin planifikim ditorë.

3.1.1 Planifikimet individuale
të mësimdhënësve

Planifikimet vjetore globale

Planifikimi individuale të
mësimdhënësve

Procesverbalet dhe vizitat në
orë

Raportet e punës në orë

Përgjigjet e dhëna në anketat e
ndryshme të realizuara në
shkollë

Numri më i madh i mësimdhënësve para fillimit të vitit shkollor përgatisin planifikime globale, tematike në mësimin obligativ A.L.N.mësim shtues – plotësues si në formë elektronike dhe të shtypura në letër të cilat dorëzohen nga kryetarët e aktiveve të pedagogu i shkollës ku ka qasje të plotë.

Në bazë të vizitave në orë shumica e arsimtarëve kanë të përgaditur planin ditor (skenari i orës) të numri më i madh i mësimdhënësve plani ditor i përmban qëllimet, format, metodat , teknikat dhe të disa nga arsimtarët kishte të përfshirë edhe TIK për realizim të suksesshëm të procesit edukativo arsimor .



3.1.3 Shkëmbimi i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit

Shkëmbimi i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit

Përgjigjet e dhëna në anketat e ndryshme të realizuara në shkollë gjatë periudhës së vetevaluimit

3.1.4 Orari mësimi

Bisedë me drejtor, pedagog,

Procesverbalet dhe vizitat në orë

Mësimdhënësit bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë përvoja mes veti gjatë përgaditjes së planeve dhe programeve mësimore. Mësimdhënësit në mbledhjet e realizuara me aktivet profesionale dhe lëndët e përafërta bashkëpunojnë në përgaditjet globale dhe tematike, poashtu në kuadër të aktiveve organizohen orë të hapura, disa nga arsimtarët kanë bashkëpunim të mirë edhe me mësimdhënësit e shkollave tjera.

Në shkollë në vitin shkollor 2022-23 ka pasur 2 arsimtarë praktikantë ndërsa në vitin shkollor 2023/24 ka 3 arsimtar praktikantë të cilët janë udhëhequr dhe këshilluar nga mentorët e tyre dhe pedagogu i shkollës.

Orari i mësimi përgaditet me fillimin e vitit shkollorë nga ane e ndihmës drejtorit dhe mësimdhënësve përgjegjës për përgaditjen e orarit mësimor. Mësimi në shkollë realizohet me dy ndryshime. Cikli i lartë (mësimi lëndor) prej ora 7:30 dhe cikli i ulët (mësimi klasor) 13:30. Orari i mësimi është i vendosur në tabelë në zyrën e arsimtarëve në tabelën e shpalljes në hyrje të shkollës, te drejtori i shkollës dhe në shërbimin profesional, poashtu shkolla ka të përpiluar orar për realizimin e mësimi shtues –plotësues, dhe kujdestarinë e mësimdhënësve

3.2 Procesi mësimorë

3.2.1 Format dhe metodat mësimore

Instrument për përcjelljen dhe realizimin e mësimi

Përgjigjet e dhëna në anketat e ndryshme të realizuara në shkollë me prindër, arsimtarë

Gjatë ndjekjes direkte të mësimi, shkolla ka një pasqyrë të përhershme në gjendjen lidhur me planifikimet, me çfarë kualiteti kryhet planifikimi dhe çfarë lloj ndihme ju duhet për të këshilluar arsimtarët në lidhje me planifikimin. Procesi mësimorë përcillet vazhdimisht nga shërbimi pedagogjik dhe drejtori. Gjatë realizimit të mësimi një numër i madh i mësimdhënësve shfrytëzojnë forma dhe metoda mësimore që mundësojnë aktivitet dhe interaksion më të madh në mes nxënësve dhe mësimdhënësit.

Me qëllim që orët të jenë të sukseshme të planifikuara shkolla jep përkrahje profesionale përmes trajnimeve të mbrendshme të organizuara në kuadër të



dhe nxënës gjatë periudhës së vetevaluimit Vizitat në orë -planifikimet e arsimtarëve	aktiveve profesionale dhe të këshillit arsimorë të shkollës, gjatë organizimit të orëve mësimore dhe punës grupore. Një numër i mësimdhënësve kanë realizuar projekte të ndryshme me nxënësit nga klasa e I-IX. Për realizim të sukseshëm të programit mësimorë shfrytëzohen resurse të ndryshme si: laptop, kompjuter,projektor, smart-tabela dhe mjete mësimore të pregatitura nga nxënësit dhe mësimdhënësit. Në kornizat e aktiveve profesionale arsimtarët prezantojnë modele të ndryshme planifikimi, dizajnojnë qëllime tematike të integruara, ndajnë përvoja, shkëmbejnë ide dhe bashkëpunojnë në grupe.
3.2.2 Përdorimi i Tik-ut në mësim Intervistë me mësimdhënësit, certifikatat, pyetësor Përgjigjet e dhënanë anketat e ndryshme Vizitat në orë mësimore	Shkolla është e paisur me internet në shkollën qendrore edhe në ato periferike , projektor në të gjitha klasat, kabinet të informatikës me çka mundëson zhvillim më efikas të procesit mësimor dhe përdorimit të Tik-ut në mësim. Gjatë vizitave në orë shumica e arsimtarët kishin të planifikuar dhe realizuan orën mësimorë duke përdorur të Tik-ut Në shkollë nuk ka mungesa të kompjuterëve dhe laptopëve për realizimin e plotë të orëve me Tik. Gjatë vëzhgimit në orë mësimore nga ana e shërbimit pedagogjikë plotësohet një formular të cilin do ta paraqesim më poshtë .
3.2.3Zgjedhja e detyrave ,aktiviteteve dhe resurseve Përgjigjet e dhëna në anketat e ndryshme të realizuara në shkollë me prindër,arsimtarë dhe nxënës gjatëperiudhës së vetevaluimit Vizitat në orë	Gjatë vizitave në orë nga komisioni për vetevaluim, pedagogu dhe drejtori i shkollës arrihet në përfundim se mësimdhënësit punojnë në bazë të planifikimeve tematiko-procesuale dhe aksionale, ku një numër imësimdhënësve zbatojnë teknika, aplikim të vlerësimit të nxënësve gjatë zgjedhjes së detyrave. Arsimtarët planifikojnë detyra dhe aktivitete të cilat duhet të realizohen në shkollë si dhe detyra shtëpie të cilat ju përshtaten nevojave të nxënësëve me qëllim që të arrihen qëllimet dhe standartet parapara mësimore.



3.2.4 Marrëdhëniet

interaktive midis
mësimdhënësve dhe nxënësve

Vizitat në orë, analizat e të
dhënave nga pedagogu dhe
pyetësorët e ndryshëm

Te numri më i madh i arsimtarëve në pregaditjen e planeve ditore janë të planifikuara interaksionet në mes nxënësve dhe arsimtarëve dhe në mes nxënësve, të cilat vërejtëm edhe gjatë procesit mësimorë në vizitat e realizuara në orët mësimore, por ajo që mungonte te disa arsimtarë ishte motivimi i nxënësve si formë e stimulimit

3.2.5 Qasja e mësimdhënësve ndaj nxënësve

Përgjigjet e dhëna në anketat e
ndryshme të realizuara në
shkollë me prindër, arsimtarë
dhe nxënës gjatë periudhës së
vetevaluimit

Numri më i madh i arsimtarëve kanë qasje profesionale ndaj nxënësve, ndihmojnë gjatë realizimit të aktiviteteve të ndryshme në shkollë, i përkrahin në idetë e tyre gjatë pregaditjes së projekteve të ndryshme. Arsimtarët aplikojnë qasje pozitive për nxitje dhe motivim të nxënësve që të marrin pjesë aktive në procesin mësimor (lëvdata, biseda etj). Sjellja është e ndërsjellë në mes nxënësve dhe arsimtarëve.

3.2.6 Ndjekja e procesit mësimor

Biseda me pedagogun dhe
drejtorin e shkollës,

Vizitat në orë

Shkolla posedon komision për përcjelljen e procesit mësimor të përbërë nga drejtoresha e shkollës dhe pedagogu i shkollës. Në bazë të planifikimit shkolla ka procedura dhe mënyra për ndjekjen e procesit mësimor – gjatë gjithë vitit shkollor, analizë e përmbatjeve, rekomandime për përmisime dhe menjanimin e lëshimeve – eventuale – përcillet nga strukturat udhëheqëse të shkollës, bashkëpunëtor profesional ku shkolla nuk ka plan konkret për evaluim të aktiviteteve me plan të veçantë. Shkolla disponon me hapsira të nevojshme për realizimin e rregullt, mirëpo ka vështirësi për realizim të sukseshëm të mësimi shtues dhe plotësues apo praktik për shkak të hapësirave për shfrytëzim gjatë ditëve të rregullta. Shërbimi pedagogjik organizon vizitë a nëpër orët mësimore me qëllim të përmirësimit të mësimdhënjes.



3.3.1 Mjedisi imësimi

Kodeksi i sjelljes,

Përgjigjet e dhënanë anketat e ndryshme të realizuara në shkollë me prindër,arsimtarë dhe nxënës gjatë periudhës së vetevaluimit

3.3.2Atmosfera në mësim

Përgjigjet e dhëna në anketat e ndryshme të realizuara në shkollë me prindër,arsimtarë dhe nxënës gjatë periudhës së vetevaluimit

3.3.3Nxitja e nxënësve për marrjen e përgjegjësisë

Përgjigjet e dhëna në anketat e ndryshme të realizuara në shkollë me prindër,arsimtarë dhe nxënës gjatë periudhës së vetevaluimit

3.3 Përvoja e nxënësve nga mësimi

Shkolla posedon hapsira të rregulluara për klasët e para dhe ka kabinete të informatikës ,Fizik ,Kimi,Biologji të cilët janë të furnizuara mirë . Mjedisi i mësimi i përmbush pjesërisht kërkesat dhe nevojat e nxënësve(mësimi kabinetik, mjete mësimore, rekuizita sportive, mjetet ndihmëse mësimore). Shumica e arsimtarëve përgaditin kënde me punime të nxënësve dhe kënde të projekteve nga nxënësit . Objekti shkollor në përgjithësi e përmbush nevojën e realizimit të mësimi

Klasat janë të paisura me projektor smart tabela dhe mjete tjera mësimore.

Në përgjithësi ekziston atmosferë pune gjatë orëve mësimore, mësimdhënësit realizojnë përmbajtjet e planifikuara duke shfrytëzuara metoda dhe teknika të ndryshme për arritjen e qëllimeve mësimore. Klima për pune është e mirë po duhet të bëhet përpjekje për sigurim të disa kushteve që janë pjesë e procesit dhe të motivohen nxënësit dhe të punësuarit për arritjet e qëllimeve të pëbashkëta individuale apo të përgjithshme me interes të shkollës dhe bashkësisë vendore, shumica e arsimtarëve i inkurajojnë nxënësit për të menduar kritik dhe të shprehin mendimet e tyre.

Gjatë procesit mësimor i kushtohet kujdes i veçantë të mësuarit, detyrave , projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë vitit shkollor, manifestimeve dhe realizimit të garave.

Nxënësit në përgjithësi u pëlqen mjedisi për mësim, e cila vërtetohet edhe nga numër i madhë i prindërve me cka konstatohet se klasat janë në gjendje të mirë dhe kanë motiv për mësim.Shkolla mundohet të nxisë dhe motivon nxënësit për përgjegjësitë ndaj procesit mësimor.



3.3.4 Marrëdhëniet

interaktive të nxënësve mes veti dhe me të rriturit

Përgjigjet e dhëna në anketat e ndryshme të realizuara në shkollë me prindër, arsimtarë dhe nxënës gjatë periudhës së vetevaluimit
Vizitat në orë

3.4.1 Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve

Pyetësor për nxënës, prind arsimtar

3.4.2 Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve

Programi vjetor,
drejtori dhe pedagogu

Raportet e punës shkollore

Në shkollë ekziston një komunikim, sjellje dhe respekt në mes të mësimeve dhe nxënësve. Në shkollë nuk ka raste të rrënda në keqësimin e marrëdhënieve në mes të nxënësve dhe të rriturve. Gjatë procesit mësimor ekziston interaksion mësimeve - nxënës dhe nxënës - nxënës, me çka nga ana e nxënësve parashtrihen pyetje të paqarta të cilat në veçanti sqarohen, duke shfrytëzuar metodat interaktive (bisedë , diskutim, eksperimente, hulumtim, punë praktike, demonstrim, etj.).

3.4 Përmbytja e nevojave të nxënësve

Mësimeve dhe shërbimi pedagogjik i shkollës mundohen të njohin dhe identifikojnë mirë nevojat arsimore të nxënësve dhe pengesat në procesin mësimor, me çka të gjithë nxënësit i përfshijnë në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore, me çka identifikohen nevojat e çdo nxënësi sipas arritjes së rezultateve në fusha të ndryshme, me çka nxënësit motivohen në marrjen e përgjegjësi në mësim.

Drejtori, shërbimi pedagogjik dhe mësimeve zbatojnë procedura për nevojat e nxënësve në mësim. Në përgjithësi përmbythen kërkesat arsimore. Arsimtarët përgaditin detyra dhe aktivitete sipas nevojave të nxënësve me çka motivohen, duhet më tepër angazhim për përmbytjen e kërkesave dhe qëllimeve të këtilla, bazuar në stilet e mësimi nga përvoja, shumica e mësimeve shfrytëzojnë teknika të ndryshme interaktive për mësim dhe notim.



3.5 Notimi si pjesë e mësimdhënies

3.5.1 Politika e shkollës për notim

Standardet e notimit

Ligji për arsim fillor

Materiale të seminarit notimi përshkrues

Dosja e nxënësve

Lista evidentuese

3.5.2 Metodatat dhe format e notimit

Instrumentet e shfrytëzuara për notim

Intervista me drejtorin dhe pedagogun e shkollës

Pyetësor për nxënës dhe arsimtar

Lista për përcjelljen e vlerësimit

3.5.3 Shfrytëzimi i informatave dhe notimi në mësim

Intervista me drejtorin dhe pedagogun e shkollës

Pyetësor për nxënës

Në pajtim me ligjin për arsim fillor në klasat e ulta I - III të arriturat e nxënësve notohen me shkrim. Për këtë qëllim arsimtarët shfrytëzojnë lista evidentuese, pyetësorë, teste, raporte dhe mbahet edhe dosje e nxënësve. Dosja apo portofolio është e mbledhur nga mundi i nxënësve, hartime me shkrim, detyra kontrolluese dhe shënime për gjendjen shëndetësore dhe gjendjen sociale. Notimi formativ i nxënësve realizohet në mënyra të ndryshme, nëpërmjet instrumentit me shkrim, teste kontrolluse, kontrollim gojor, çek listave etj.

Mënyra e notimit bëhet në bazë të ligjit për arsim fillor klasat I – III notohen me notim përshkrues, klasat IV-VI me notim të kombinuar me shkrim dhe numerik kl.VII-IX numerik duke u mbështetur në përcjelljen e të arriturve të nxënësve me metoda portofolio, teste, instrumente, me gojë, me shkrim, çek lista, lista evidentues, fleta analitike. Një numër i arsimtarëve mbajnë evidencë për çdo nxënës gjatë vitit shkollor –për përcjelljen e të arriturve si dhe formën e përfshirjes së nxënësve në vetvlerësimin në bazë të metodave dhe formave për notim. Në shkollë pjesa më e madhe zbatojnë (standardet dhe kriteret e notimit të dhëna nga B.ZH.A dhe M.A.SH), me çka zbatohen aktet ligjore të cilat rregullojnë procedurën e notimit.

Notimi është real, transparent dhe përcillet me diskutime të cilat u ndihmojnë nxënësve në punën e tyre si dhe biseda, konstatime që vlerësimi i nxënësve është bazuar në suksesin mesatar të shkollës është më i lartë bazuar në gjendjen faktike gjatë mësim.

Në kontinuitet nxënësit marrin informata për përparimin e tyre nëpërmjet rezultateve të instrumenteve me shkrim (Fletat evidentuese-teste) dhe kontroll me gojë me qëllim të nxitet dëshira për përparim.



3.6.1 Informimi i prindërve
për përparimin e nxënësve
Plan program për punën me
prindërit

Programa vjetore për punën e
shkollës

Materiale nga puna e këshillit
të prindërve

Ditarët e klasave

3.6. Informim për përparimin e nxënësve

Prindërit trajtohen si konsulltant kryesorë për ndihmën për mirëkuptim të çdo nxënësi si individ. Informatat i marrin nëpërmjet takimeve prindërore që organizohen 4 herë brenda vitit (fillimi i vitit shkollor, tremujori i parë, gjysmëvjetori i parë dhe tremujori i tretë), fletat evidentuese për arritjet e nxënësve, informim përmes emailit dhe mesazheve të e-ditarit. individuale, nëpërmjet këshillit të prindërve, nëpërmjet paraqitjeve të portofolieve të nxënësve, nëpërmjet fletave evidentuese, dhe dëftësve të nxënësve.



I N S T R U M E N T

PËR VËZHIM TË PUNËS SË ARSIMTARIT -SH.F.K "NAIM FRASHËRI,,Negotinë e Pollogut

Arsimtari _____

Ligjeron mësim nga lënda _____

1.1 Qellimi i vëzhgimit profesional

- a. Planifikimi dhe pregaditja për mesim
- b. Qasja dhe strategjia për të ariturat e nxenesve
- c. Menyra e vlerësimit të ariturave të nxenesve
- d. Komunikim në relacion mesimdhënes -nxenes
- e. Versimi perfundimtar

I. PLANIFIKIMI DHE PËRGADITJA PËR MËSIM					
S KA PREGADITJE	Ø				
• JO KUALITATIVE	**				
• PJESËERISHT KUALITATIVE	***				
• KUALITATIVE	****				

	Ø	*	**	***	****
I.I. PËRGADITJA E MJETEVE DHE MATERIALEVE DIDAKTIKE-METODIKE,					
• MJETET TEKNIKE					
• ILUSTRATIVO-DEMONSTRATIVE					
• IKT TEKNOLOGJIA					
• USHTRIME					

	Ø	*	**	***	****
1.2 EVIDENCA PEDAGOGJIKE DHE DOKUMENTACIONI					
• FORMULIMI I PËRMBAJTJEVE MËSIMORE					
• PAJTUESHMËRI ME PLANPROGRAMIN MËSIMOR					
• KONTINUITET NË NOTIM					
• ÇEK LISTA					



II. VEZHGIMI I REALIZIMIT TE ORES MESIMORE

Par./klasa ____ nr.i nxënësve prezent ____ prej gjithsej ____ nr.rendor i orës në orarë ____					
TEMA:					
NJËSIA MËSIMORE: AKTIVITETET	Ø	*	**	***	****
▪ Arsimtari qart e fillon orën mesimore					
▪ Nxënësit kanë kujdes gjatë orës					
▪ Arsimtari i aktivizon njohuritë e mëparshme dhe i motivon nxënësit					
▪ Udhëzimet për aktivitetet gjatë orës për nxënësit janë të qarta					
▪ Mesimdhësi qart i informon nxënësit për aktivitetet gjatë orës mesimor					
AKTIVITETE TË VEÇANTA TË ARSIMTARIT	Ø	*	**	***	****
▪ Nxitje në zhvillimin e operacioneve mendore tek nxënësit					
○ demonstron (sqaron)					
○ udhëzon gjatë rrjedhjes së aktiviteteve					
▪ Shprehet:					
○ Me fjali të shkurta dhe të qarta					
○ Formulon sakt dhe qart					
▪ I korigjon nxënësit:					
○ Në terminologji					
○ Në gjuhë					
▪ U kushton vëmendje nxënësve të cilët janë:					
○ Aktiv					
○ nuk janë aktiv					
▪ mesimdhësi përdor metoda					
○ individuale					
○ grupe					
AKTIVITETE TË VEÇANTA TË NXËNËSVE	Ø	*	**	***	****
▪ Nxënësit interesohen për:					
○ Përmbytjen e orës					
○ Ligjerimin e arsimtarit					
▪ Parashetrojnë pyetje:					
○ Arsimtarit					
○ Njëri tjetrit apo vet klasës					
▪ Nxënësit:					
○ Bashkëpunojnë me nxënësit tjerë dhe me arsimtarin					
○ Planifikojnë					
VLERËSIMI	Ø	*	**	***	****
▪ Arritja e qëllimit/detyrat e orës					
▪ Arsimtari e ndjek punën e nxënësve					

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

▪ Planifikimi i orës është adekuat me realizimin e orës					
▪ Organizimi i orës					
PËRGADITJA PËR ORËN E ARDHSHE	Ø	*	**	***	****
▪ Udhëzime					
▪ Detyra shtëpie					

Vlerësimi Perfundimtar

Me më shumë simbole me * planifikimi nuk është i sukseshmëm
Me më shumë simbole me ** planifikimi është mesatar
Me më shumë simbole me *** planifikimi është i sukseshëm
Me më shumë simbole me **** planifikimi është shumë i sukseshëm

VËREJTJE:

Vezhgimin e kreu:

N.drejtör: _____

Pedagogu: _____

Psikologu: _____

Ed.speciale: _____

Mesimdhenes: _____

Data _____

Ora _____

DREJTOR:



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 3: Mësimi dhe mësimdhënja

Mledhja e të dhënave cilat tjera metoda janë përdorur për mbledhjen e të dhënave? (psh. Pyetësor, anketime, vëzhgime etj.)

Paraqiti metodat tjera që janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja: Kush ishte i kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat të dhëna janë mbledhur?
Pyetësor për arsimtarët Bisedime resiproke	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Special	Sipas 80 % të anketimit të arsimtarëve prindërit bashkëpunojnë me ato me qëllim që të ndjekin zhvillimin e fëmijëve të tyre, për të gjithë të anketuarit, mbledhjet prindërore në shkollë janë mirë të organizuara, ndërsa nxënësit në shkollë janë mirë të informuar. 98 % të arsimtarëve vazhdimisht ndjekin dhe evidentojnë përparimin e nxënësve dhe rregullisht i informojnë për të arrituarat e tyre. Gjatë notimit të nxënësve 70 % e marrin parasysh edhe mendimin e tyre për të arriturat e tyre. 87 % prej arsimtarëve i nxisin nxënësit të marrin përgjegjësi për punën e tyre ndërsa lëvdatat i shfrytëtojnë si mënyrë për motivim të nxënësve.
Pyetësor për prindërit Bisedime	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Speciale	93 % të prindërve janë mirë të informuar për rezultatet e fëmijëve të vet. Mbledhjet prindërore janë të rregullta dhe mirë të organizuara për 88 % të të anketuarëve prindër, dhe gjithashtu informatat ju jepen edhe gjatë takimeve individuale. 73 % të tyre konstatojnë se shkolla nxit tek nxënësit ndjenjën e vetëkontrollit, përgjegjësis dhe më shumë pamvarsësi në punë. Sipas 93 % prej tyre në problemet e nxënësve reagojnë në kohë në mënyrën e duhur.



Pyetsor për nxënësit; Bisedë; Vëzhgim	- Pedagogu i shkollës; - Psikologu - Edukator Special	77 % të nxënësve të anketuar mendojnë se njëlloj trajtohen të gjithë nxënësit (meshkuj, femra) gjatë pyetjeve dhe shfrytzimit të resurseve dhe sipas mundit të dhënë. Sipas 75 % të tyre gjatë mësimit shfrytzojnë metoda dhe teknika të ndryshme të të mësuarit të cilët i nxisin të mendojnë dhe të japin ide të reja. 95 % janë të kënaqur nga shkolla dhe mësimi që realizohet në të dhe nga mënyra e sjelljeve të arsimtarëve daj tyre. 87 % mendojnë se arsimtarët i nxisin në punë në mënyrë të drejtë dhe reale të notimit, gjatë respektimit të mendimit të tyre dhe Pjesëmarrja e tyre në shumë aktivitete në shkollë
---	---	---



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k." Naim Frashëri"

fusha 3 : Mësimi dhe mësimdhënja

Rezultatet: Këtu duhet shkurt të arsyetoni anët kyçe të forta të juajat dhe anët kyçe të dobëta tuajat

Anët e forta të shkollës

- Mësuesit bëjnë shkëmbimin e përvojave dhe informacionit në planifikimin e procesit mësimor si ekip dhe në nivel aktiv
- Mësuesit rregullisht përgatisin Planifikimin Vjetor Global, Tematik dhe Ditor.
- Mësuesit përdorin metoda të ndryshme mësimore, forma të punës dhe teknika për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në përputhje me qëllimet dhe objektivat e kurrikulës.
- Objektivat e mësimdhënies, rezultatet e pritura të të nxënësve dhe mënyra e vlerësimit janë të përcaktuara qartë në planifikim dhe personeli mësimdhënës përdor informacionin nga vlerësimi për të zbuluar nevojat e nxënësve dhe për të planifikuar hapat e ardhshëm në mësim.
- Çdo nxënës ka mbështetje të plotë nga shërbimi pedagogjik-psikologjik në zgjidhjen e problemeve arsimore

Anët e dobëta të shkollës

- Mospajsa e materialeve dhe mjeteve vizuale në shkollë
- Mungesë e trajnimit të kuadrit arsimor për identifikimin e nxënësve të talentuar dhe metodat dhe format për punë me të njëjtit
- Trajnim i pamjaftueshëm të arsimtarëve të grupit klasorë për zbatimin e teknikave gjatë të të mësuarit
- Mungesë e doracakëve dhe literaturë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Aktivitete në të ardhmen: Prioritete e nënfushave në suazat e kësaj fushe të cilat mundë të jenë të kyçura në planet për zhvillim të shkollës.

- Të siguruarit e mjeteve materiale dhe vizuale;
- Ndërrim përvojash nga arsimtarët të cilët kanë qenë në trajnim tek arsimtarët e tjerë të cilat krijojnë dhe implemetojnë novacione të reja sipas kushteve specifike në shkollë.
- Trajnimi i arsimtarëve për punë me nxënës të talentuar, identifikimi i tyre, forma dhe metoda në punë
- Trajnim i arsimtarëve të grupit klasorë për zbatimin e teknikave të mësuarit
- Furnizim me doracak dhe literaturë për punë me fëmijë me nevoja të ndryshme arsimore.



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k." Naim Frashëri"

fusha 3: Mësimi dhe mësimdhënja

Analiza e rezultateve:

Këtu jepni evaluim të detajuar të kësaj fushe

Për pasurimin e arsimit me punë me nxënësit shfrytëzohen metoda dhe teknika të ndryshme gjatë të të mësuarit të cilat i mundësojnë arsimtarit të jetë i drejtë në pasqyrimin e përparimit të nxënësve gjatë zhvillimit dhe mësimit, të cilët nxisin mendimin kritik tek nxënësit në të gjitha moshat dhe në kuadër të të gjithë lëndëve, rritet motivimi për punë dhe mundësohet zhvillimi optimal i njohurive dhe aftësive për mësim.

Për realizim të sukseshëm të përmbajtjeve mësimore shfrytëzohen resurse me të cilat disponon shkolla siç janë: biblioteka, kabineti i informatikës, laborator i për fizikë dhe kimi, matematik dhe materiale të ndryshme.

Gjatë gjithë vitit shkollor në mbrendësinë e shkollës në mënyrë të vazhdueshme publikohen punimet dhe projektet e nxënësve nga lëndët e ndryshme. Në mësojtoret janë të rregulluara në punimet e nxënësve, të punuara në kuadër të projekteve të ndryshme e cila i jep një pamje origjinale punës së mbrendhshme të shkollës. Publikimi i punimeve njëlloj i përfaqësojnë nxënësit nga të dy gjinitë.

Arsimtarët i inkurajojnë nxënësit nëpërmjet zbatimit dhe nxitjes të cilat realizohen nëpërmjet lëvdatave, çmimeve, mirnjohjeve, garave, të realizuara me punë të pamvarur. Shkolla është e hapur për prindërit dhe për të gjithë të interesuarit për punën e sajë. Mjedisi i shkollës i stimulon dhe motivon njëlloj nxënësit nga të dyja gjinitë nëpërmjet aktiviteteve jashtashkollore promovim dhe publikim të punimeve të nxënësve, rezultateve e garave etj. Nxënësit në kontinuitet marrin informata për përparimin e tyre nëpërmjet rezultateve dhe nga instrumentet e kontrollimit me shkrim dhe kontrollim gojor me qëllim që të nxitet dëshira për përparim

Shkolla ka sistem të mirë dhe të drejtë për notim të drejtë për të arriturat e nxënësve dhe mundëson plotësimin e nevojave për dituri tek nxënësit me dispozita dhe aftësi të ndryshme. Shkolla nxit tek nxënësit ndjenjë për kontroll sa më të madhe, përgjegjësi dhe pamvarësi më të madhe në punë. Të kënaqur nga shkolla dhe mësimi që realizohet në të dhe mënyra e sjelljeve të arsimtarëve ndaj tyre.



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 4 : Përkrahja e nxënësve

Në evaluimin e kësaj fushe duhet të përgjigjeni në numër sa më të madh të këtyre pyetjeve.

Mund të shtojmë përgjigje edhe të pyetjeve tjera për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për shkollën tuaj dhe nuk janë të përfshira në kornizat e vetevaluimit.

Ju mund të shtoni dhe të bëni përpjekej sa është e mundur për të shtuar të gjithë faktorët që është e mundur në shkollën tuaj dhe komunitetin lokal ku është e nevojshme të kujdesemi për lidhjet familjare të cilat mund të ndikojnë në kualitetin e mësimi dhe procesit mësimorë në shkollën tuaj.

Mos mbështeteni vetëm në dokumentet e shkruara. Siguroni që të dhënat e mbledhura në këtë fushë po ashtu të përfshijnë sa më shumë komente të shkruara, vëzhgime dhe dëshmi vizuale.

Treguesit e cilësisë		Temat
4.1	Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit	- Mbrojtje nga lëndimet fizike dhe fatkeqësitë elementare - Parandalim nga dhuna - Mbrojtje nga duhanpirja, alkooli dhe droga - Kualiteti i ushqimit që merret - Përkrahja e nxënësve me pengim zhvillimor/ pengim fizik - Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale
4.2	Shëndeti	- Higjienë dhe mbrojtje nga sëmundjet - Kujdes për nxënësit me probleme shëndetësore
4.3	Ndihmë këshillëdhënëse për arsimim të mëtejshëm të nxënësve	- Dhënie e ndihmës gjatë zgjedhjes së profesionit/ institucionit për arsimim të mëtejshëm, kualifikim të mëtejshëm ose për punësim - Kujdes për nxënësit me vështirësi emocionale
4.4	Ndjekja e përparimit	- Mbajtje e evidencës për përparimin individual të nxënësve - Analizë e përparimit të nxënësve sipas paraleleve



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha4: Përkrahja e nxënësve

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë përdorur).

Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha dokumentat të cilat janë shqyrtuar

Treguesi i cilësisë

Burimet e informacionit

Cilat informacione janë mbledhur?

4.1.1 Mbrotja nga lëndimet fizike dhe fatketësi elementare

Programa e punës së drejtorit

Programa e punës së pedagogut

Evidencat për informim të shkollës

4.1 Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit

Shkolla posedon hapsirë të sigurtë për zhvillimin e procesit mësimor. Shkolla organizon aktivitete të ndryshme për mbrojtje të nxënësve nga lëndimet fizike. Shkolla ka të ndërtuar edhe oborin shkollor të përshtatur për nxënës nga mosha 6 deri 15 vjeç në oborin e shkollës ka të vendosur edhe këndë lojrash për nxënësit e ciklit të ulët.

Shkolla ka krijuar politikë të bashkëpunimit duke marur parasysh iden dhe vendimet nga këshilli prindor dhe shkollor ku një numër i konsiderueshëm i nxënësve dhe arsimtarëve sigurohen për çdo vit shkollor nga sigurimi "Trigllaf". Në shkollë tonë një grup i arsimtarët janë të trajnuar në formën interne – trajnim për "dhënien e ndihmës së parë elementare nga fatkeqësit - evakuim".

Kryqi i kuq –Gostivar në shkollën tonë zhvillojë një ligjerat për nxënësi e kl. VII-VIII është realizuar tema : "Ndihma e shpejtë"

Shkolla ka plan për evakuim nga fatkeqësitë elementare. Në shkollë të gjithë arsimtarët janë të trajnuar për mbrojtje gjatëpunës nga zjarret dhe përdorimin e aparateve për shuarjen e zjarrit me datë: 22.03.2022 me temë: "Siguria dhe shëndeti në punë" nga inxhinjeri i mbrojtjes Dragi Arsovski si dhe trajnime nga mbrojtja nga zjari nga instruktori i Zjarfikës i diplomuar Armend Kasa ku morën pjesë të gjithë mësimdhënësit e shkollës qendrore dhe atyre periferike.



4.1.2 Preventiva ndaj dhunës

Përgjigjet e dhëna në anketat e ndryshme të realizuara në shkollë me prindër arsimtarë dhe nxënës gjatë periudhës së vetevaluimit

Për kujdesjen e nxënësve gjendja dhe mbrojtja e nxënësve meshkuj dhe femra si dhe ato nxënës me nevoja të veçanta shfrytëzojnë forma dhe aktivitete të ndryshme, bisedë këshilla, kontrollera sistematike lidhur me shëndetin, ligjerata lidhur me të drejtat e fëmijëve, kyçur në organizata të ndryshme të nxënësve. Mësimdhënësit organizojnë aktivitete të mjaftueshme për mbrojtjen e nxënësve ndaj dhunës. Në nxënësit në orët e bashkësisë së klasës organizohen orë me tema për mbrojtjen e nxënësve nga lëndimet dhe fatkeqsitë elementare. Në shkollë deri më tani nuk ka të evidentuar raste të dhunës. Në shkollë nuk ka raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe psigjike ndaj nxënësve në mes veti dhe ndaj arsimtarëve.

4.1.3 Mbrojtja nga konsumimi i duhanit, drogës dhe alkoholit

Programa vjetore shkollore,

Ligjeratat e ndryshme

Programi i OBK

Në shkollë plotësisht respektohet procedura për ndalimin e pirjes së duhanit, janë të caktuara vendet e posaçme për arsimtarët duhanpirësit, ka shenja për ndalim e cila respektohet dhe është pjesë e rendit shtëpiak. Por realizohen tema edukative „me datë

Më datë 23 .03.2023 nga arsimtarët përgjegjës , nga projekti i MASH-it, ligjerat edhe nga përfaqësues të M P B stacioni policor gallat për klasat e IX-ta realizuan një ligjerat me nxënësit e klasave të IX-ta me temë: "Keqpërdorimi i drogave, alkoholit dhe duhanit "

Në raste të paraqitjes së dukurive të këtilla shkolla ka ka dispozita të shkruara dhe është e gatshme për ndërmarjen e masave .(edhe pse deri tani nuk ka patur apo vërejtur raste të tilla)

4.1.4 Cilësia e ushqimit që përdoret

Shkollor jonë nuk ka kuzhinë shkollore, nxënësit dhe të punësuarit ushqimin e sigurojnë prej shitoreve afër shkollës lokaleve dhe një pjesë e vogël prej shtëpie. Shkolla nuk ka procedura për qasje në kualitetin e ushqimit që u ofrohet nxënësve dhe nuk janë ndërmarë aktivitete deri në instuticionet kompetente për kontrollime të ndryshme inspektimi (ka pasur kërkesa viteve më të hershme nga shkolla – mirëpo deri tani nuk ka përgjigje me shkrim).

Programa vjetore shkollore



4.1.5 Përkrahja e nxënësve me pengim zhvillimor/ pengim fizik

Programi i ekipit inkluziv,
Ligji për Arsim Fillor,

Për notimin e gjendjes emocionale fizike dhe sociaie të meshkujve dhe femrave shkolla shfrytëzon bisedë me nxënësit dhe prindërit, bashkëpunim me zyrtarët social dhe asocione të ndryshme si dhe kyçja e nxënësve në aktivitetet të lira. Shkolla respekton dhe gjithmon mbështet rastet e nxënësve me të meta fizike –(edhe pse nuk ka raste të tilla nxënësish). Shkollës nuk ka stazë (hyrje) të veçantë për nxënësit dhe personat tjerë dhenë të ardhmen duhet të përmbushen kriteret dhe standarte e objektit për personat e kësaj kategorie që lirshëm të lëvizin dhe punojnë të cilat janë të përshtatshme për nevojat e tyre. Si dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me organet kompetente dheshoqatatat joqeveritare për ballafaqim dhe bashkëpunim të sukseshëm me këto kategori dhe grup pune.

4.1.6 Kujdesi për nxënësit që rrjedhin nga familjet në gjendje të vështirë sociale

Programi i ekipit inkluziv,
Ligji për Arsim Fillor,

Evidenca shkollore

Shkolla për nxënësit me status të rezikuar sociale ka trajtim të njëjtë si me nxënësit tjerë,të cilët shfrytëzojnë ndihmë sociale, ka raste brenda vitit përfshihen në aksionin ndihmat humanitare të kryqit të kuq -Gostivar Më datë 17.10.2023 mësimdhënësit bashkë me nxënësit organizuan një aksion humanitar për ditën e uris me temën” Nxënësi dhuron për nxënësin “ me çka mjetet e ngrumbulluara ua dedikuan familjeve të nxënësve në nevojë në komunën tonë veshëmbathje dhe produkte ushqimore ,Pjesa e ngelur ju dhurua Kryqit të kuq –Gostivar Shkolla ka bashkëpunim me bashkësin vendore për sigurim të mjeteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave të fëmijëve dhe familjeve me nevojë.



4.2 Shëndeti

4.2.1 Higjiena dhe mbrojtja nga

Sëmundjet

Ligji për arsim fillor

Programa për kujdesin e shëndetit

Anketat me prind dhe nxënës

Procesverbalet e organeve kompetente për higjienë

Rendi shtëpiak

Rregullorja për sistematizim dhe për organizim të detyrave

4.2.2 Kujdesi për nxënësit me

Probleme shëndetësore

Raportet e kontrolleve mjeksore

Në shkollën tonë gjendja është e mirë. Nxënësit kujdesen për higjienën, por edhe të punësuarit, si dhe ekipi menaxhues që ka dhënë kushte të mira në tualete dhe vendosja e shportave në korridore dhe në oborrin shkollor.

Këto vite është punuar mjaftueshëm për mirëmbajtjen e higjienës jo vetëm në pjesën e mbrendëshme të shkollës por edhe në vet oborrin e shkollës. Gëllqerosja e të gjitha hapësirave, pastrimi dhe meremetimi i tualeteve, rregullimi i zyrës së arsimtarëve, ngjyrosja e rrethojës së shkollës, mbledhja e përditëshme e mbeturinave nga të punësuarit si dhe organizimi për mirëmbajtjen e midisit të pastër nga ana e udhëheqësve të klasave janë aktivitete tona që do i ndërmarrim këto vite shkollore që të kemi mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Kontribut të dalluar për këtë qëllim do të ket edhe rendi shtëpiak që do implementohet gjatë vitit shkollor.

Shkolla kujdeset për nxënësit me probleme shëndetësore edhe pse është numëri i vogël intervenohet në moment, ndihmohet dhe këto rast realizohen me konsultime, bashkëpunim me prindërit. Për udhëzime të mëtutjeshëm shkolla merrte dhëna për numër të nxënësve për shëndetin e fëmijëve (me probleme) mirëpo në disa raste nuk ka informata apo të dhëna për nxënësit me probleme shëndetësore me dëshmi apo të dhëna nga familjarët për gjendjen shëndetësore të fëmijëve që të hartoj plan dhe programe të veçantë të ballafaqimit me situata të tilla.



4.3.1 Ofrimi i ndihmës për zgjedhjen e profesionit /institucionit për arsim të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim.

Materialet për punën e kshillit të prindërve

Program profesional për informim dhe orientim të nxënësve

Programi për punën e orëve të kujdestarisë

4.3.2 Kujdesi për nxënësit me vështërsi emocionale

Programi i ekipit inkluziv,

Ligji për Arsimit Fillor,

4.4.1 Mbatja e evidencës për Përparimin individual të nxënësve

- Ditarët e klasave
- Librat amë
- Fletat evidentuese

4.3. Ndihma këshillëdhënëse për arsimimin e mëtejshëm të nxënësve

Në përputhshmëri me programën për orientim dhe informim profesional të nxënësve dhe programën për punë në orën e kujdestarisë realizohen këto aktivitete : ligjerata për nxënësit,prezentim i profesioneve dhe drejtimet e shkollave të mesme dhe prindërit nga ana e kujdestarit të klasës dhe pedagogut të shkollës informohen në mënyrë individuale prindërit dhe nxënësit.

Për problemet e nxënësve me vështërsi emocionale shkolla , drejtori, arsimtarët, hërbimi, profesional intervenojnë në kohë, ndihmohet dhe informon prindërit e nxënësve për situata të paraqitjeve të tilla – të cilat në të shumtën e rasteve janë paraqitje të natyrës së moshës, psikologjike e sociale të cilat deri tani nuk ka të evidentuar.Duhet të hartohen programe të veçanta – dhe duhet të ndërmeren aktivitete për trajnim të një numri të arsimtarëve – të cilët do të aftësohen për realizim të këtyre procedurave apo rasteve edhe pse më tepër realizohet nga shërbimi profesiona i shkollës.

4.4 Ndjekja dhe përparimi

Rregullshmëria, sjellja dhe zhvillimi i nxënësve evidentohet në ditarët e klasave. Librat amë. pasqyrat e pjesëmarrjes së nxënësve në aktiivitete të lira dhe regjistrimi i prezencës dhe arritjes së rezultateve të nxënësve në garat e nxënësve, ekspozita, konkurse dhe manifestime tjera. Evidentimi i rregullshmërisë dhe sjelljes së nxënësve, zhvillimin e tyre e kryejnë arsimtarët dhe u përcillen nxënësve dhe prindërve të tyre gjatë mbledhjeve prindërore, fletave evidentuese dhe dëftesave.



- Procesverbal me takim me prindërit
- Ligji për arsim fillor
- Fletëshpërngulje
- Dëftesa
- Dosje e nxënësve

Në bazë të rezultateve të evidentimit shifen dobësitë dhe vështirësitë të cilat hasin nxënësit dhe mirren strategjitë e duhura për të kaluar këto vështirësi. Në pajtim me Ligjin për arsim fillor për nxënësit që kalojnë në shkolla të tjera shkolla dorëzon fletëshpërngulje në shkollën që kalon nxënësi. Shkolla nuk e çregjistron nxënësin derisa shkolla që ka kaluar nuk i sjell informacion këthyes për pranimin e tij. Pas informimit të pranimit dorëzohen edhe gjithë të dhënat për suksesin e nxënësit si që është vërtetimi për sukses si dhe dosjen e nxënësit. Gjithashtu këta të dhëna shkolla i merr edhe prej nga ajo shkollë prej ku na vjen nxënësi. Në mungesë të këtyre të dhënave shkolla i merr informatat nëpërmjet kontaktit të bërë me shkollën ku nxënësi ka ndjek mësimin dhe me shfrytëzimin e të dhënave nga dëftesa e tij.

4.4.2 Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve

Pjesa më e madhe mësimdhënësëve përgadisin raporte dhe analiza në të gjitha periudhat kualifikuese, statistika, fleta evidentuese (kujdestarët e klasave), duke u mbështetur në evidencat personale me evidencë dhe dokumentacion pedagogjik: E –ditar, të cilat të dhëna shërbejnë si raporte, analiza krahasuese, raporte pranë organeve dhe trupave shkollor, B.ZH.A., M.A.SH. të cilat rezultate shfrytëzohen për diksutim apo rekomandime për përmisim të rezultateve. Analizat për realizimin e nxënësve, paraleleve, lëndë më detalisht janë të prezantuara në fushën 2 – arritjet e nxënësve, mirëpo shkolla duhet të kontriboj ose të bëjë përpjekje sidomos në ngritjen e suksesit të përgjithshëm të shkollës dhe individual të nxënësve, e cila për tri vitet e fundit është përpunuar mirë dhe diskutuar me rekomandime konkrete.



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 4 : Përkrahja e nxënësve

Mledhja e të dhënave cilat metoda tjera janë përdorur për mbledhjen e të dhënave? (psh. Pyetësor, anketime, vëzhgime etj.)		
Paraqiti metodat tjera që janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja: Kush ishte i kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat të dhëna janë mbledhur?
Pyetësor për arsimtarët Bisedime resiproke	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special	90,5 % të arsimtarëve rregullisht e ndjekin dhe vëzhgojnë përparimin e nxënësve. Se shkolla mundëson plotësimin e nevojave për dije të nxënësit me aftësi të veçanta janë deklaruar 81 % të të anketuarëve të arsimtarëve. Gjatë notimit për 86 % e tyre mban raport për përparimin e nxënësve mvarësisht prej aftësive të tyre individuale. 78 % e arsimtarëve kanë krijuar bashkëpunim të sukseshëm me shërbimin profesional në shkollë Shkolla mundëson bashkëpunim me arsimtarët dhe me institucionet e jashtme për punën me nxënësit
Pyetësor për prindërit Bisedime	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special Kujdestarët e klasave Arsimtarët nga grupi klasorë Nxënësit	Për 85 % të të anketuarëve të prindërve bashkëpunimi profesional është në mardhënie të mira me to dhe nxënësve ua ka ofruar përkrahjen e duhur. 90 % vazhdimisht marrin informata këthyese të mira prej arsimtarëve në lidhje me suksesin e fëmijëve të tyre. Sipas 80 % prej tyre arsimtarët mirë i njohin nxënësit e tyre kujdesen për ato dhe gjithmonë pozitivisht i vlerësojnë rezultatet dhe të arriturat e tyre. Për 74 % për problemet e nxënësve reagojnë në kohën dhe mënyrën e duhur.



Pyetsor për nxënësit;	Pedagogu i shkollës;	Një numër i madh i nxënësve gati 91 % janë deklaruar se arsimtarët janë të vlefshëm dhe të rregullt, u ndihmojnë në mësim për sukses më të mirë, i lëvdojnë për rezultatet e arritura dhe i kyçnin në të gjitha aktivitetet e nxënësve. 77 % e nxënësve të anketuar mendojnë se arsimtarët marrin masa për përmirësim të diciplinës në paralele. Mardhëniet midis nxënësve për 81 % të tyre, si dhe midis nxënësve dhe arsimtarëve për 93 % të të anketuarve janë të mira dhe bazohen në kuptimin dhe respektin e ndërsjelltë Te 53 % e nxënësve nuk egziston frikë gjatë pyetjeve, dhënieve të detyrave të shtëpisë dhe nuk dëshprohen nga notat e dobëta.
Bisedë;	Psikologu Edukator Special	
Vëzhgim	Kujdestari i klasës Arsimtarët i grupit klasorë	



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha4 : Përkrahja e nxënësve

Rezultatet: Këtu duhet shkurt të arsyetoni anët kyçe te forta të juajat dhe anët kyçe te dobëta tuajat

Anët e forta të shkollës

- Monitorimi i përditshëm i përparimit të nxënësve, rregullsisë, sjelljes dhe zhvillimit të përgjithshëm në procesin arsimor nga ana e mësuesve dhe veprim në atë drejtim.
- Disponueshmëria e të dhënave për nxënësit e prindërve, mësuesve dhe vetë nxënësve
- Nxënësit mund t'i drejtohen shkollës për ndihmë ose këshilla në çdo kohë
- Nxënësit që janë të arsimuar në shkollë dhe kanë aftësi të kufizuara në zhvillimin mendor ose fizik pranohen nga mësuesit dhe nxënësit e tjerë.
- Shkolla kujdeset për ekzaminime të rregullta sistematike të nxënësve dhe vaksinime të rregullta
- Për shëndetin fizik të nxënësve, duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta fizike, kujdesen edhe mësuesit e edukimit fizik dhe shëndetit.
- Mësuesit janë në kontakt me prindërit për përparimin e fëmijëve të tyre

Anët e dobëta të shkollës

- Mungesë e modifikimit të planit dhe programit mësimorë për punën me nxënësit me aftësi të veçanta.
- Mungesë e literaturës profesionale për nxënës me aftësi të veçanta.
- Bashkëpunim i dobët me organizatat joqeveritare të cilat i trajtojnë problemet e shëndetësisë dhe edukimit.

Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 4 : Përkrahja e nxënësve

Aktivitete në të ardhmen: Prioritete e nënfushave në suazat e kësaj fushe të cilat mundë të jenë të kyçura në planet për zhvillim të shkollës

- Trajnim për arsimtarët për punën me nxënës me nevoja të veçanta;
- Zmadhimi i fondit të bibliotekës së shkollës;
- Bashkëkohëzimi i mjeteve ndihmëse mësimore



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 4 : Përkrahja e nxënësve

Analiza e rezultateve:

Këtu jepni evaluim të detajuar të kësaj fushe

Shkolla zbaton forma dhe aktivitete të ndryshme për të siguruar kujdes, mirësi dhe mbrojtje në mes nxënësive meshkuj dhe ato femra, si dhe për ato fëmijë me nevoja të veçanta mësimore nëpërmes bisedimeve të ndryshme me to dhe prindërit e tyre, gjatë bashkëpunimit me shërbimin profesional për kujdesje sociale dhe asociacione tjera si dhe kyçjen e nxënësve në aktivitetet e lira.

Gjatë punës së përditshme në kohën e mësimi, kontaktet e drejtpërdrejta me nxënësit, shiqimet sistematike dhe bisadat me prindërit shkolla i zbulon nxënësit me probleme fizike, mendore dhe shëndetsore problemet për bashkëpunimin me mjekun e shkollës ofron masa të marrur për zgjidhjen e menjëhershme të problemeve.

Ka informacion të mirë për orientimin profesional të nxënësve.

Evidenca për rregullshmëri, sjellje dhe zhvillim të nxënësve, rregullisht evidentohet në ditaret, librat amzë, librezat e nxënësve fletat evidentuese dhe e njejta ju raportohet prindërve.

Zbulimi i nxënësve me probleme fizike dhe psirike dhe te ato me nevoja të veçanta kryhet përmes punës së përditshme gjatë kohës së mësimi. Kontaktet e drejtpërdrejta me arsimtarët, shiqimet sistematike, bisada me prindërit dhe ngajshëm. Arsimitarët vazhdimisht ndjekin dhe vëzhgojnë përparimin e nxënësve shkolla mundëson plotsimin e nevojave të dijenisë tek nxënësit me aftësi të ndryshme.

Gjatë notimit mbahet raport për përparimin e nxënësve mvarësisht prej aftësive të tyre individuale.

Prindërit rregullisht marrin informata këthyese prej arsimtarëve në lidhje me suksesin e tyre.

Arsimitarët mirë i njohin nxënësit e tyre, kujdesen për ato dhe gjithmonë pozitivisht i vlersojnë rezultatet dhe sukseset e arritura.

Në problemet e nxënësve reagojnë në mënyrën dhe kohën e duhur.

Arsimitarët marrin masa për përmirësim të diciplinës në paralele. Mardhëniet midis nxënësve, si dhe midis nxënësve dhe arsimtarëve janë të mira dhe bazohen në kuptimin dhe respektimin e ndërsjelltë.



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 5 : Klima Shkollore

Në evaluimin e kësaj fushe duhet të përgjigjeni në numër sa më të madh të këtyre pyetjeve.

Mund të shtojmë përgjigje edhe të pyetjeve tjera për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për shkollën tuaj dhe nuk janë të përfshira në kornizat e vetevaluimit.

Ju mund të shtoni dhe të bëni përpjekej sa është e mundur për të shtuar të gjithë faktorët që është e mundur në shkollën tuaj dhe komunitetin lokal ku është e nevojshme të kujdesemi për lidhjet familjare të cilat mund të ndikojnë në kualitetin e mësimin dhe procesit mësimorë në shkollën tuaj.

Mos mbështeteni vetëm në dokumentet e shkruara. Siguroni që të dhënat e mbledhura në këtë fushë po ashtu të përfshijnë sa më shumë komente të shkruara, vëzhgime dhe dëshmi vizuale.

Treguesit e cilsisë		Temat
5.1	Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	- Autoriteti/imazhi i shkollës - Kodi i sjelljes - Klima shkollore - Sjellja dhe disiplina në shkollë - Pjesëmarrja e nxënësve në marrjen e vendimeve dhe zgjidhja e problemeve
5.2	Promovimi i arritjeve	- Promovimi i arritjeve personale të nxënësve - Promovimi i arritjeve në emër të shkollës
5.3	Paanësi dhe drejtësi	- Njohja e të drejtave të fëmijëve - Trajtim i njëjtë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit - Pranim dhe promovim i multikulturalizmit
5.4	Marrëdhënie partneriteti me prindërit dhe me bashkësinë Locale dhe afariste	- Bashkëpunim i shkollës me prindërit - Bashkëpunim me bashkësinë lokale/komunitetin lokal - Bashkëpunim me bashkësinë afariste dhe me sektorin qytetar



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 5 : Klima Shkollore

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë përdorur).

Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha dokumentat të cilat janë shqyrtuar

Cilat informacione janë mbledhur?

5.1.1 Prestigji / imazhi i shkollës

Programa vjetore e shkollës

5.1 Atmosfera shkollore dhe marrdhëniet në shkollë

Imazhi i shkollës tërësisht kënaqën standartet e funksionimit të Institucionit edukativo arsimor, me cka pjesa më e madhe e të punësuarve kontribuojnë në afirmimin e shkollës, raporte në mes të arsimtarve dhe nxënësve janë të mira të cilat bazohen në respekt të ndërsjellt. Kuadri arsimor gëzonë respekt, shumica dhe numri i madhë nxënësve dhe prindërve e cila sjellë në identifikim të shkollës e cila respektohet me ndjenjë të kënaqësis dhe sigurisë së punës efikase. bazuar në realizimin e vizionit dhe misionit shkolllor

5.1.2 Kodi i sjelljes

Rendi shtëpiak

Kodi i sjelljes

Në shkollë ka procedur për kodin e sjelljes për nxënësit dhe të punësuarit, Kodi përmban dhe përgëzon respektin në mënyrë të barabartë. Moshë, gjininë, nxënësit me dukuri paraqitjeve emocionale dhe përfshirjen statutit social, kodi i sjelljes është i miratuar nga të gjithë të punësuarit dhe është pjesë përbërse normat për punë dhe kodeksin etik të shkollës, të gjithë kanë participuar në hartimin dhe e njëjta respektohet nga të gjithë strukturat shkollore.

5.1.3 Atmosfera e shkollës

Në bazë të kushteve, të cilën realizohet procesi edukativo-arsimor konstatim i përgjithshëm se në shkollën tonë ka klimë pozitive respekt, ndjesi të kënaqësisë nga shumica për realizim të aktiviteteve të punës në shkollë si dhe arritjet e përbashkëta, trajtim të barabartë, bashkëpunim profesional.

5.1.4 Sjellja dhe disiplina në shkollë

Diciplina në përgjithsi kënaqën me cka vërehet dhe egziston atmosferë pune gjithë kohës së mësimi, dhe aktiviteteve jashtëmësimore, nuk janë



Rregullorja për shqiptimin e masave pedagogjike

Procesverbalet e mbledhjeve me këshillin e arsimtarëve

5.1.5 Participimi i nxënësve në zgjedhjen e problemeve dhe konflikteve

Intervista me nxënës

Procesverbalet e mbledhjes së parlamentit të nxënësve

5.2.1 Promovimi i arritjeve personale

Intervistë me pedagogun

Lëvdatat dhe shpërblimet

Anketat me mësimdhënës, prind dhe nxënës

hasur konflikte të rënda shkolla respektkon dhe shqipton masat pedagogjike bazuar me ligjin për arsim fillor për nxënësit që pengojn gjatë realizimit të procesit mësimor dhe atyre që kanë qëndrim jo të drejtë ndaj vlerave shkollore..Në këtë drejtim ndihmon edhe bashkësia nxënësve në nivel shkollor në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në shkollë,ka raste moskënaqësie por të njëjtat kanë përmirsime .

Participimi i nxënësit në zgjedhjen e problemeve dhe marjen e vendimeve respektohet rrallë, vetëm në raste të realizimit të disa aktiviteteve, japim mendim, ide, meren parasysh si vërejtje apo lëvdata për punën dhe jetën në shkollë në bised dhe takime në klasë u jepet mundësia të njehta ti shprehin me shkrim përmes kutisë postale shkollore e cila kontrollohet nga drejtori dhe të njeta shqyrtohet, ku ka bazë të cilat kontribuojnë në ngritjen e cilësisë.

Në funksion aktiv është bashkësia e nxënësve apo parlamenti i nxënësve si organ i barabartë në shkollë – përmes mbledhjeve informohet për programin në punën e shkollës, aktivitetin, sukseset dhe të gjitha aktivitetet shkollore dhe të gjitha propozimet si anë të dobëta të shkollës apo kënaqësit si anë të forta meren parasysh dhe të njëjtat shërbejnë për analiza të mëtutjeshme të përmirsimit të punës dhe suksesit shkollor.

5.2 Promovimi i arritjeve

Arritjeve të nxënësve shkolla i kushton rëndësi dhe vëmendje të vecantë, shkolla disponon me dëshmi të mjaftueshme për promovimin personal të nxënësve për arritjet e tyre, mirëpo kuadri arsimor duhet më tepër të lëvdojnë nxënësit gjatë rezultateve. Nxitet kreativiteti i motivimi për pjesëmarrje në gara, shkollore, komunale dhe regjionale me aspirata më suksese më të larta individuale dhe shkollore. Aspekti i mënyrës së organizimit planifikimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve. në gara është viteve të fundit më i madhë interesimi..



5.2.2 Promovimi aritjeve në emër të shkollës

Intervistë me pedagogun

Lëvdatat dhe shpërblimet

Anketat me mesimdhënës, prind dhe nxënës

Dhe në mënyrën e pjesëmarrjes së nxënësve në gara me anë të dhënies së mundësis testimit intern si bazë e rezultateve dhe selektimit në gara e mëturjeshme mirëpo ekzistojnë lëshime apo mospjesëmarrje nga disa lëndë të cilat shkolla duhet të ndërmer aktivitete për përfshirjen e nxënësve mënyrë të barabartë, dhe realizimin e detyrave të cdonjërit në bazë të rregullores së punës

Në funksion legjislativ viteve të fundit obligimet dhe ndarja e detyrave të cdo arsimtari në lidhje me organizimin dhe realizimin e garave si formë e promovimit të vlerave dhe arritjeve në nivel të shkollës dukshëm janë përmirësuar si rezultatet i ekipeve shkollore, informimit në kohë nga organet përgjegjësive si dhe shoqatat e akredituara për organizime të tilla Arritjet e nxënësve dhe kuadrit arsimor në emër të shkollës – janë:

Bashkpunimi permanent me të gjitha subjektet

Planifikimi dhe realizimi i projekteve të shkollës

Implementimi i arritjeve në cilësi të infrastrukturës

Rregullimin e mirmbajtjeve objektive të mbrendëshme shkollore

Pjesëmarrja e nxënësve në gara shkollore, komunale dhe regjionale.

5.3 Barazia dhe të drejtat

5.3.1 Njohja e të drejtave të fëmijëve

Evidenca pedagogjike

Programet për punë

Planet dhe programet

Të drejtat e fëmijëve realizohen përmes disa orëve të bashkësis së klasës pjesë e shkathësive jetësore, orëve të arsimit qytetar, si dhe shkolla realizon planifikimin e programit “ Të drejtat e fëmijëve“

Ku realizohen tema të përshtatshme për moshën e nxënësve e cila bazohet ne doracakun, mirëpo krahasuar për nevojat e njohjes, informative duhet të bëhet përpjekje për më shumë aktiviteteve në lidhje me të drejtat e fëmijëve sindikatat, ligjin, konventat ndërkombtare, diskriminim etj



5.3.2 Trajtim i drejtë dhe barabartë për të gjithë nxënësit

Bisedë me nxënës, prind

Programi i shkollës

Shkolla mirë e vleron në bazë procedurave dhe aktiviteteve evauluese kumundë të zbatojë kulturën mësimore njëjtë për të gjithë nxënësit në aspektin gjinor, nuk ka raste deskriminimi por e tëra respektohen në të gjitha fushat arsimore dhe educative .

5.4.1 Bashkëpunimi I shkollës me prindërit

Raportet e punës

Evidenca e takimeve individuale

Procesverbalet e mbledhjeve prindore

5.4 Marrëdhënie partnere me prindërit dhe me bashkësinë lokale dhe komunitetin

Shkolla mundohet që ti përfshijë më tepër prindërit në punën e shkollës si subjekt I barabartë, aktivitetet të ndryshme, në kuadër të rregullave ligjore për pjesëmarrje në aktivitetet e punës dhe vendimarrje në këshillin prindor dhe këshillin e shkollës. Bashkëpunimi i shkollës me prindërit dëshmohej përmes takimeve individual dhe mbledhjeve prindërore me kujdestarët e klasës informime të rregullta për arritjet dhe suksesin tyre. Ka raste të bashkëpunimit në realizimi të akcioneve të ndryshme, aktivitete pune, manifestime etj mirëpo duhet të ndërmeren aktivitete konkrete për participimin e prindërve në shkollë jo vetëm në pjesëmarrjen formale(këshilli të shkollës dhe këshillin prindor).

5.4.2 Bashkëpunim me bashkësinë lokale

Programi për punën e shkollës

Portali i shkollës

Shkolla ka ekskluzivisht bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale(Komuna e Vrapçishtit) si themelues, posaçërisht me sektorin e arsimit. mbahen mbledhje ku ndihmohet gjatë përgaditjes dhe realizimit të programit për punë, gjithashtu mbahen mbledhje të ndryshme për raste të caktuara etj. Prej këshillit të komunës së Vrapçishtit kemi dy anëtarë në Këshillin e shkollës. Do insistoahet të nënshkruhet Memorandum për bashkëpunim në nivel lokal për realizimin e programeve të përbashkëta ekologjike.



5.4.3 Bashkëpunim me bashkësin afariste dhe sektorin joqeveritar

Procesverbalet e mbledhjes
së këshillit, anketat me prind

Me sektorin e biznesit nuk do të mungon bashkëpunimi për çdo aksion nga të gjitha sferat e mundëshme të organizuara nga ana e bashkësive vendore, shkollat jonë me nxënës dhe arsimtar gjithmon janë mbrojtëse (patron) kryesor, sidomos në pjesën e fatëkeqësive natyrore (vërshimeve) dhe në pjesën e ekologjisë.

Me komunitetin afarist shkolla ka bashkëpunim në realizimin aktivitetëve në shkollë, infrastrukturë, projekte, investime të një numri afaristësh dhe zejtarëve të cilët mundohen të japin kontributin e tyre në përmirsimin e kushteve në shkollë, në aktivitetet e punës në forumin në bashkësi, në ekoprograme, etj. Me sektorin qeveritar ka takime kur në bazë të projekteve duhet të ndihmohet në raste të ndryshme sidomos me Kryqin e kuq – ka donacione të ralla që u dedikohet nxënësve sidomos atyre në ra përfshirje të dobët, mirëpo duhet të përkrahët vizita më të shpeshta në kompanitë private të rrethinës për njohuri më të zgjeruara



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 5 : Klima Shkollore

Mledhja e të dhënave cilat metoda tjera janë përdorur për mbledhjen e të dhënave? (psh. Pyetësor, anketime, vëzhgime etj.)		
Paraqiti metodat tjera që janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja: Kush ishte i kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat të dhëna janë mbledhur?
Pyetësor për arsimtarët Bisedime resiproke	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special	85% e mësimeve kam deklaruar se kanë besim të udhëheqësia shkollore 90% deklaruan se i kushtohet kujdes shëndetit të të punësuarve 90% deklaruan se mendojnë se shkolla në përgjithësi përmbush kërkesat, standardet e nevojshme, ka atmosferë të mirë për punë, të cilat motivojnë në ngritjen e të arriturave dhe suksesit të përgjithshëm 95% deklaruan se në shkollë kemi mjete didaktike-metodike të mjaftueshme për secilën lëndë mësimore 95% deklaruan se drejtori shfrytëzon burime nga komuna, organizatat e ndryshme
Pyetësor për prindërit Bisedime	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special	80% e prindërve deklaruan Jam i/e kënaqur me organizimin dhe klimën e shkollës 85%e prindërve deklaruan se mësuesit respektojnë dhe inkurajojnë nxënësit. 83% e prindërve deklaruan se marrëdhëniet mes nxënësve janë të mira. 90% e prindërve deklaruan se shkolla merr parasysh mendimin e prindërve për çështje të rëndësishme. Ne njoftohemi rregullisht për notat e nxënësve dhe masat për përmirësimin e tyre



Pyetsor për nxënësit; Bisedë; Vëzhgim	Pedagogu i shkollës; Psikologu Edukator Special	80% e nxënësve deklaruan se informohen nga arsimtarët kujdestarë dhe arsimtarët lëndorë për planet dhe programet mësimore që realizohen gjatë vitit shkollor 80%e nxënësve deklaruan se mendojn që planet dhe programet mësimore që realizohen te shkolla jonë janë të kuptueshme për ta 83% e nxënësve deklaruan se realizohen me sukses temat mësimore gjatë vitit shkollor 95% e nxënësvev deklaruan se ekziston bashkëpunimi me organet e shkollës dhe mësuesin si realizues i plan programeve mësimore
---	---	--



Vetevaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha 5 : Klima Shkollore

Rezultatet: Këtu duhet shkurt të arsyetoni anët kyçe te forta të juajat dhe anët kyçe te dobëta tuajat

Anët e forta të shkollës

- Në shkollë në përgjithësi ka klimë të mirë pozitive për realizimn e procesit edukativo-arsimor
- Pjesëmarrja ne nxënësve është në rritje përmes participimit në bashkësinë e nxënësve, parlamentin e nxënësve, gjatë jetës dhe punës shkollore
- Shkolla ka mirë të përpiluara dhe respektohen procedurat e kodit të sjelljes nga të gjithë subjektet
- Rregullisht realizohet programi dhe temat e caktuara për të drejtqat e fëmijëve
- Shkola realizon vazhdimisht bashkëpunimin me shkollën partner dhe faktorët tjerë për avancimin e multikulturalizmit
- Shkolla bashkëpunon dhe gjithmonë është e hapur në bashkëpunim me prindët, lokalitetin, komunën, komunitetin afarist, shoqatat joqeveritare etj

Anët e dobëta të shkollës

- Përpjeke më e madhe për mirëmbajtjen dhe respektimin e kodit të sjelljes së nxënësve gjatë orëve mësimore dhe hapësirat shkollore
- Në shkollë duhet të përforcohen kapacitetet më të larta për realizimin e shpërblimeve gjatë procedurave të marrjes së rezultateve të fituara personale dhe shkollore
- Përpjekja më e madhe për angazhimin dhe përfshirjen e prindërve në punën shkollore

Aktivitetet në të ardhmen:

- Angazhim më të madh të nxënësve në pjesëmarrjen e organeve dhe trupave profesionale shkollore si dhe në raste të sjeëëjeve të vendimeve për punën shkollore
- Adaptimin e hapsirës për zyrë e cila do të shfrytëzohet për punë dhe takime individuale me prind
- Rregullimin e panosë së shkollës dhe këndeve për fëmijë për eksponimin e të arriturave dhe punimeve të nxënësve



Vetvaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha: 6 Burimet

Në evaluimin e kësaj fushe duhet të përgjigjeni në numër sa më të madh të këtyre pyetjeve.

Mund të shtojmë përgjigje edhe të pyetjeve tjera për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për shkollën tuaj dhe nuk janë të përfshira në kornizat e vetevaluimit.

Ju mund të shtoni dhe të bëni përpjekej sa është e mundur për të shtuar të gjithë faktorët që është e mundur në shkollën tuaj dhe komunitetin lokal ku është e nevojshme të kujdesemi për lidhjet familjare të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e mësimi dhe procesit mësimorë në shkollën tuaj.

Mos mbështeteni vetëm në dokumentet e shkruara. Siguroni që të dhënat e mbledhura në këtë fushë po ashtu të përfshijnë sa më shumë komente të shkruara, vëzhgime dhe dëshmi vizuale.

Treguesit e cilësisë

Burim informacionesh

Temat

Vendosja dhe

Kushtet hapësinore

6.1

kapacitete

Shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve hapësinore

hapësinore

Pajisja me literaturë profesionale, me mjete
mësimore dhe me mjete mësimore ndihmëse

6.2

Mjetet dhe

Biblioteka shkollore

materialet

Materiale harxhuese

mësimore

Kompania shkollore reale ose virtuale

Punësoria shkollore për stërvitje praktike, pajisur
me makina, instalime, aparate dhe vegla

Numri i të punësuarve dhe përshtatshmëria e
kuadrit mësimdhënës

6.3

Sigurimi i kuadrit të

Efektiviteti dhe shpërndarja e kuadrit

nevojshëm arsimor

Bashkëpunëtorët profesionalë si ndihmë ndaj



kuadrit mësimdhënës

Ndjekja e nevojave
zhvillimore

6.4

të kuadrit

mësimdhënës

Zhvillimi profesional dhe i karrierës i arsimtarëve

6.5

Puna financiare e

shkollës

Transparencë në planifikimin dhe harxhimin e

buxhetit shkollor

Vetëvaluimi i shkollës: Sh.f.k. " Naim Frashëri"

fusha: Burimet

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë përdorur).

Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha
dokumentat të cilat janë
shqyrtuar

Cilat informacione janë mbledhur?

6.1.1 Kushtet
Hapësinore

Programi punës

Procesi i aaktiveve
profesionale

Programi për punën e

6.1.Akomodimi dhe kapacitetet hapësinore

Në shkollë QENDRORE ka gjithsej 15 mësonjëtoe, 8 kabinete, zyrë për mësimdhënësit, 3 zyra për administratën. Lidhja e internetit është funksionale dhe i përfshin të gjitha hapsirat e shkollës me të cilën pa pengesë edhe realizohen orët në ditarin elektronik. Korridorin e shkollës ndonjëherë shfrytëzohet për prezente të ndryshme, ligjërata, ekspozita, manifestime kulturo-artistike ka sallë sportive dhe të tjera. Shkolla posedon edhe zyrë të veçante për drejtor, për sekretarin, shërbimin profesional (pedagogun, ndihmës drejtorin dhe psikologun) shkolla posedon edhe zyrën e arsimtarëve që këtë vit plotësisht është riparuar dhe është përshtatur për



Shkollës

mësimdhënësit. Të gjitha këta hapsira janë të furnizuara me kompjuterë dhe të kyçura në rrjetin e internetit

Të dhëna më të detajuara :

Emri i shkollës qendrore	SHFK "Naim Frashëri"
Adresa , komuna , vendi	101 p.n. 1235 Negotinë, Komuna e Vrapçishtit
Telefon	042311093
Faks	042311093
Email	ou.naim.Frashëri@gmail.com
E themeluar prej	Vitit
Numri i verifikimit – aktit dhe viti i verifikimit	1465/10-1996
Gjuha në të cilën mbahet mësimi	Gjuhë shqipe
Viti i ndërtimit	Viti 1996
Lloji i ndërtimit	Material i forte
Sipërfaqja e objektit	2176m ²
Sipërfaqja e oborit të shkollës	2145m ²
Sipërfaqja e tereneve sportive	1000m ²
Shkolla punon në ndrime	II ndrime
Mënyra e ngrohjes së shkollë	Nxemje qendrore me naftë
Numri i klasave	24
Statusi I eko shkollës (flamuri I gjelbërt , argjend dhe nivel I bronzës)	E planifikuar këtë vit të formohet



Emri i shkollës periferike	<i>Fshati. Senakos</i>	<i>Fshati. Kalisht</i>	<i>Fshati. Gjurgjev isht</i>	<i>Fshati. Llo mnic</i>
Adresa , komuna , vendi	/	/	/	/
Telefon				
Faks	042311093			
Email	ou.naim.Frashëri@gmail.com			
E themeluar prej	Vitet			
Numri i verifikimit – aktit dhe viti i verifikimit	1465/10-1996			
Gjuha në të cilën mbahet mësimi	<i>Gjuhë shqipe</i>			
Viti i ndërtimit	Viti 1996			
Lloji i ndërtimit	Material i forte	Matreial i forte	Matreial i fortë	Matreial i forte
Sipërfaqja e objektit	748 m2	7380m2	225m2	236m2
Sipërfaqja e oborit të shkollës	2147m2	347m2	100m2	98m2
Sipërfaqja e tereneve sportive	800m2	198m2	120m2	120m2
Shkolla punon në ndrime	Dy ndrime	Një ndrim	Dy ndrime	Dy ndrime
Mënyra e ngrohjes së shkollës	Nxemje qendrore me naftë	Me drru	Me drru	Me drru
Numri i klasave	8			
Statusi i eko shkollës (flamuri i gjelbërt , argjend dhe nivel i bronzës)	E planifikuar këtë vit të formohet	E planifikuar këtë vit të formohet	E planifikuar këtë vit të formohet	E planifikuar këtë vit të formohet



	Llojet e klasave	Negotinë		Senakos		K
		Numri	m ²	Numri	m ²	
6.1.2 Shkalla e shfrytëzimit kapaciteteve hapësinore Programi për punën e shkollës Raporti	1 Numri i përgjithshëm i objekteve shkollore	1	2176	1	748	
	2 Sipërfaqja bruto					
	3 Sipërfaqja neto			/	/	/
	4 Numri i tereneve sportive	/	/	1	800	1
	5 Numri etazheve	4	544	2	365	2
	6 Numri i klasave	24	1152	8	512	9
	7 Numri i sipërfaqeve ndihmëse	4	160	2	30	2
	8 Bibloteka shkollore	1	30	/	/	
	9 Palestra sportive	1	980	/	/	
	10 Zyrë për Drejtorin	1	36	/	/	
	11 Zyra për administratën	1	20	/	/	
	12 Zyra për shërbimin pedagogjik	2	28	/	/	
	13 Zyra për përgjegjësin	/	/	1	12	
	14 Numri i kyçeve sanitare	4	143	3	54	2
	15					
Shkolla ka plan të qartë për shfrytëzimin e kapaciteteve të mundësive të mundshme hapësinore të procesit mësimor. Me të cilat plotësohen nevojat e nxënësve. Salla sportive shfrytëzohet për realizimin e sukseshëm të lëndës Arsim Fizik Shëndetësor dhe zhvillimin e drejtë dhe të shëndoshë të nxënësve. Gjithashtu kabinetit për lëndët Shkencave Natyrore, Biologji, Kimi, Fizikë, Informatik shfrytëzohen nga mësimdhënësit përkatës për zhvillim më të mirë të orëve në praktik , ku kabinetet janë të pajisura mirë me mjete kabinetike .						



6.2.1 Pajisja me literatura profesionale dhe mjete ndihmëse mësimore Procesverbalet nga aktivet profesionale Dokumentacioni shkollor Evidenca për punën 6.2.2 Biblioteka shkollore Plani për furnizim publik Evidenca e Bibliotekës 6.2.3 Material shpenzues Procesverbalet e këshillit të aktiveve profesionale Raportet e punës	<u>6.2. Mjetet dhe materiale mësimore</u> Nga materiali i harxhuar çdo herë ka mjete të mjaftueshme, letra të bardha, hamera, stilografë, markera për shënim në dërrasa të bardha dhe material tjetër harxhues. Nevojat dhe mjetet materiale mësimore vërtetohen nëpërmjet mbledhjeve të përbashkëta, aktiveve profesionale dhe listave anketuese. Nevoja ndiqet nga ana e drejtorit dhe pedagogut shërbimit pedagogjik. Ata gjithashtu ndihmojnë në realizimin e sukseshëm të programës dhe në mënyrë efikase shfrytëzimin e mjeteteve mësimore Shkolla posedon edhe një bibliotekë të vogël, e cila disponon me një fond letrar me mbi 4000 tituj të letërsisë për nxënësit dhe arsimtarët (lektyra, literaturë profesionale, gazeta etj. Një pjesë e tyre është e vjetëruar, a një pjesë e tyre është në gjendje të mirë. Nevoja e lektyrave shkollore pjesërisht është e kënaqëshme Mësimdhënësit për çdo vit paraqesin kërkesa për nevojat e mundshme – mjete mësimore, materijale didaktike në aktivet profesionale – në këshillin e arsimtarëve por për kërkesat e tyre shqyrtohen dhe vendos, miraton këshilli i shkollës në planifikimet e vitit vijues efekti ose efikasiteti, përdorimit të mjeteve mësimore përcillet përmes orëve mësimore nga drejtori, pedagogu, orëve të hapura gjatë realizimit të evaulimit të shkollës është potencuar që pjesa më e madhe e mjeteve mësimore përgaditen nga arsimtarët, me çka duhet që shkolla të përgadit plan të veçantë për numrin e saktë të mjeteve, mjeteve ndihmëse, materiale tjera për mësim – Shkolla planifikon material harxhues në planin financiar mirëpo realizohet në mjaftueshëm për nevojat e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore në kuartale me çka kënaqin nevojat e nxënësve dhe arsimtarëve në shkollë.



6.3.1 Numri i të
punësuarve dhe
përshtatshmëria e
kuadrit mësimdhënës

Statistika

Evidenca të
punësuarve

6.3 Staf i mësimor dhe jomësimor

Mësimin e zhvillojnë 94 mësimdhënës të shpërndarë në shkollën fillore dhe 4 shkollat periferike për mbarvajtjen e procesit mësimor kujdeset edhe shërbimi pedagogjik , me qëllim që të zotëronte detyrat e punës së kësaj shkolle.

Puna administrative në shkollë bëhet nga sekretari-administratori dhe bibliotekisti. Staf i teknik numëron 11 persona që punojnë me kohë të plotë .

STAFI MËSIMOR DHE JOMËSIMOR		Gjithsejt
Nr i të punësuarve		112
Drejtor, Nd.Drejtor		2
Nr.i mësimdhënësve		94
Nr.i shërbimit pedagogjik		4
Administrator		1
Shërbimi teknik		11

- Mësuesit që plotësuan mësimin nga shkollat e tjera

1	Sara Mexhidi	Biologji
2	Zekirja Rushani	Etikë religjioni

Shkalla e përgaditjes profesionale të stafit mësimdhënës dhe profesional

Profili	Dr.	Mr.	VII-1	VI
Drejtor		1		
Nd.drejtor			1	
Pedagog			1	
Psikolog			1	
Edukator special.rehabilitator			1	
Mësimdhënës		5	73	16
Sekretar			1	

6.3.2 Efektiviteti dhe
vendosja e kuadrit
arsimor



6.3.3 Shërbimi

profesional si
mbështetje e
kuadrit arsimor

Programi për punën e
bashkëpunëtorëve
profesional

Evidenca për punë

Procesi arsimorë zhvillohet në rregull, respektohet orari i punës, gati i kompletuar të gjitha ë lëndët në aspekt profesionalë – mbahet evidencë për raste që mungojnë arsimtarët dhe të njëjtit zëvendesohen, e në të ardhmen disa vende pune (me bashkëpunëtorë profesional) duhet plotësohen profesionalisht – me profesionistë. Cilësia e punës nga ana e mësimit dhe ndihmësve mundësohet vetëm përmes punës ekipore më së tepërmi në suaza të timeve profesionale.

Nga shërbimi profesional ka pedagog ,psikolog ,edukator special,dhe bibliotekist. Shërbimi pedagogjik përkrahje dhe ndihmon në organizimin e mësimit, ndihmon nxënësit dhe kuadrin arsimorë gjatë procesit mësimor dhe problemeve tjera të aktiviteteve këshilluese – në pajtueshmëri me detyrat dhe obligimet ligjore. Ka program për punë në cilësi të bashkëpunëtorit profesional e cila implementohet gjatë vitit shkollor si dhe aktivitete të ndryshme me nxënës dhe arsimtarë.

6.4.1 Zhvillimi

profesional i
mësimit dhe ndihmësve

6.4. Ndjekia e nevojave zhvillimore të kuadrit arsimor

Për përcjelljen e punës së arsimtarëve kujdeset drejtori i shkollës dhe shërbimi pedagogjik që mban shënime për punën e tyre dhe të njëjtën e vlerëson. Për punën e arsimtarëve dhe zhvillimin e tyre profesional kujdeset timi i shkollës, në këshillat e klasave dhe këshillin arsimorë në shkollë.

Shkolla bën kujdesje dhe u jep përkrahje atyre arsimtarëve të cilët duan ti përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale. Arsimtarët mundet të shfrytëzojnë kompjuterin, internetin, literaturë profesionale, ju jepet ditë të lira kur kanë nevojë për ato. Për arsimtarët praktikant në këshillin arsimorë jepet vendim ku caktohet mentor për praktikantin. Mentori ndjek punën e tij dhe në mbarim të stazhit të praktikantit



6.5.1 Procedurat me të cilat sigurohen respektimi i rregullores Ligjore për punën financiare

Plani financiar

Raportet

Procesverbalet e mbledhjeve të këshillit

6.5.2 Transparenca në planifikimin dhe supozimin e buxhetit shkollor

Raporti i furnizimeve

Raporti i këshillit shkollor

mentori jep mendim për punën e arsimtarit praktikant. Mendim jep edhe këshilli arsimorë.

6.5. Puna financiare e shkollës

Shkolla me kalimin e procedurave të themeluesit gjegjësisht komunës së Vrapçishtit në fazën e II – dytë të decentralizimit, mjetet financiare i siguron nga qeveria lokale – komuna nëpërmjet llogarive të dedikuara, shkolla ka llogarin e vet (të dytë) – ku realizohen të hyra e vetëfinanciare, mirëpo rastet janë shumë të rralla). Puna financiare planifikohet me kuartale dhe miratimet nga llogarit përfundimtare me këshillin e shkollës.

Procedurat për punën financiare janë në përputhshmëri me aktete dhe normal ligjore, është e rëndësishme se përpos këshillit të shkollës informohen gjithmonë edhe mësimmëdhënësit përmes këshillit ku mendimet, idet, propozimet meren parasysh në planin financiar për zhvillimin e shkollës në përgjithësi.

Shkolla ka komision për të hyrat publike, me planifikimin dhe pregaditjet të shpalljeve financiare dhe të hyrave publike. Të hyrat publike shfrytëzohen përmes shpalljeve elektronike (ESJN) dhe shpalljet në realizimin .

Drejtori i shkollës gjithmonë në mënyrë transparente konsulton të punësuarit, informon dhe raporton për planin financiar, këshillin e shkollës, prindor, këshillin e arsimtarëve – në veçanti kur është e nevojshme – që të sigurohet në aspektin ekonomik në ndarjen e mjeteve, por të gjitha qëllimet dhe prioritetet e nevojshme shkollore jo gjithmonë i përmbushen qëllimet arsimore. Buxheti shfrytëzohet për qëllime prioritetet dhe qëllime arsimore të shkollës.



Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha 6 : Burimet

Mledhja e të dhënave cilat tjera metoda janë përdorur për mbledhjen e të dhënave? (psh. Pyetësor, anketime, vëzhgime etj.)		
Paraqiti metodat tjera që janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja: Kush ishte i kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat të dhëna janë mbledhur?
Pyetsor për arsimtarët Bisedime resiproke	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special	80 % e arsimtarëve të anketuar deklarojnë se pregaditja e shkollës, madhësia e hapsirës i përgjigjet standardeve të procesit mësimor dhe mjetet bashkëkohore mundësojnë realizimin kualitativ të procesit mësimorë. Sipas 83 % prej tyre shkolla disponon hapësirë të mjaftueshme për shoqërim në kohën e lirë. Biblioteka është mirë e kompletuar si dhe fondi i bibliotekës është i mjaftueshëm për nevojat e nxënësve për 93 % të arsimtarëve. Për të punësuarit e shkollës dhe anëtarët e këshillit të shkollës janë në dijeni për punën me mjetet financiare që është në pajtim me qëllimet e procesit edukativo arsimorë dhe prioritetet e shkollës për 88 %
Pyetsor për prindërit Bisedime	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special	Për 87 % të të anketuarëve prindër fëmijët e tyre në shkollë ndjehen të lumtur dhe të kënaqur. 87.3 % prej prindërve kanë deklaruar se shkolla të gjithë nxënësve u ofron mundësi të njehta për relaizimin e detyrave të tyre në lidhjet me kushtet hapsinore dhe kuadrit profesional. Në shkollë punohet në mënyrë kualitative dhe maksimale shfrytëzohen kushtet hapsinore



		literatura profesionale me të cilën disponon biblioteka 70 % të prindërve
Pyetsor për nxënësit; Bisedë; Vëzhgim	Pedagogu i shkollës; Psikologu Edukator Special Kujdestari i klasës Arsimtarët i grupit klasorë	Nxënësit i shfrytëzojnë kapacitetet që i ka biblioteka e shkollës por për 18 % nga ato nuk i plotëson dhe kënaq nevojat e tyre, mungesa e bibliotekistit vin në shprehje. Shkolla ka kushte adekuate për punë, por për 13 % nuk janë të mjaftueshëm kompjuterat në kabinetin e informatikës. 85 % të nxënësve mendojnë se është e nevojshme për furnizim të lektyrave dhe literaturë tjetër profesionale në bibliotekën e shkollës Terenet sportive në rrethin e shkollës u mundëson nxënësve sport dhe rekreativet në kohën e lirë.



Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha 6 : Burimet

Rezultatet: Këtu duhet shkurt të arsyetoni anët kyçe të forta të juajat dhe anët kyçe të dobëta tuajat

Anët e forta të shkollës

- Kushtet hapsinore për realizim të mësimi në tërësi i plotësojnë kërkesat bazuar në numrin e të punësuarve dhe numrin e nxënësve në shkollës
- Të gjithë të punësuarit, në veçanti kuadri mësimor janë adekuat në realizimin e detyrave dhe obligimeve
- Të gjithë kuadri arsimor përcjellin seminare, ligjerata, punëtori si dhe raste të vazhdimi të mësimi sipëror me qëllim të ngritjes të zhvillimit profesional
- Shërbimi profesional mbështet dhe u jep përkrahje mësimdhënësve
- Shkolla respekton procedurat për punën financiare dhe me transparencë realizohet plani dhe shpenzimet e buxhetit

- Anët e dobëta të shkollës
- Duhet të bëhen përpjekje për rritjen e buxhetit vjetor me qëllim të sigurimit më të madh të mjeteve higjienike dhe materialeve tjera
- Shkolla duhet të bëjë procedurë dhe plan për sigurim dhe angazhim të kuadrit arsimor nga rradhët e bashkëpunëtorëve profesional psikolog dhe edukator rehabilitues për punë me nxënës me nevoja të veçanta
- Pajisjen dhe furnizimine bibliotekës me literaturë profesionale dhe lektyra shkollore

Aktivitete në të ardhmen: Prioritete e nënfushave në suazat e kësaj fushe të cilat mundë të jenë të kyçura në planet për zhvillim të shkollës

- Rregullimin e klasave me këndet e nevojshme sipas fushave programore
- Kërkesë për furnizimin me material mësimor mjete, ilustrime, amteriale didaktike për nevojat e kuadrit arsimor
- Aktivitete pune për zhvillimin në aspektin e shëndetit mental, emocional për zhvillimin individual të fëmijëve
- Sigurimi i kushteve për organizimin e mësimi kabinetik
- Sigurimi i mjeteve ndihmëse mësimore bashkëkohore



Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha 6 : Burimet

Analiza e rezultateve:

Këtu jepni evaluim të detajuar të kësaj fushe

Shkolla disponon me mësojtore të cilat janë të furniuara me Smart tabela dhe projektora si Shfq ashtu edhe në ato periferike por edhe mundësojnë mësim kabinetik në të gjitha lëndët mësimore.

Shkolla disponon sallë sportive, të cila kënaq nevojat për mësim në lëndën e Arsimit fizikë dhe shëndetësorë.

Hapsirat e përbashkëta shfrytëzohen në mënyra optimale dhe shfrytëzohen nga të gjithë anëtarët e shkollës.

Arsimtarët deklarojnë se pregaditja e shkollës, se hapsira madhore përgjigjet për procesin edukativo arsimorë për standardet dhe mjetet ndihmëse bashkëkohore mundësojnë për realizim kualitativ të mësimi. Sipas tyre shkolla disponon me hapsirë të mjaftueshme për shoqërim në kohën e lirë.

Shkolla ka strategji dhe angazhim të personelit me kaulifikim të lartë profesional. Arsimtarët ndjekin seminare, trajnime ligjerata profesionale dhe aktivitete tjera, dhe për atë marrin ndihmë dhe përkrahje nga kolegët. Për arsimtarët praktikant në këshillin arsimorë sillet vendim për të cilin caktohet mentor për praktikantin. Mentori e ndjek punën e tij dhe pas mbarimit të praktikës jep mendim për punën e arsimtarit praktikant.

Shkolla të gjithë nxënësve ju ofron mundësi të njëjtë për realizimin e detyrave të tyre sipas kushteve hapsinore dhe kuadrit profesional. Në bibliotekë ka fond literature por e nevojshme është që e njejta të plotësohet me literaturë të re.

Nxënësit mendojnë se ka nevojë për furnizimin me lektyra dhe literaturë tjetër profesionale.

Kabineti i informatikës i plotëson nevojat e nxënësve sepse numri i kompjuterave është i lartë në raport Mjetet ndihmëse dhe mësimore janë të mjaftueshme.

Puna financiare në shkollë mirë kryhet dhe kontrollohet. Për buxhetin dhe harxhimet e shkollës, informatë ka drejtori i shkollës dhe personi i cili udhëheq me punën fianciare. Çdo i punësuar mundë të marrë informata nëse ka dëshirë, a në fundë të vitit përgaditet llogari përfundimtare, ku lajmërohen edhe anëtarët e këshillit të shkollës.

Nëpërmjet anëtarëve të këshillit të shkollës nga ana e bashkësisë lokale e njejta merr informatë për mënyrë e punës financiare në shkollë.



Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha 7 : Udhëheqja, krijimi i politikës

Në evaluimin e kësaj fushe duhet të përgjigjeni në numër sa më të madh të këtyre pyetjeve.

Mund të shtojmë përgjigje edhe të pyetjeve tjera për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për shkollën tuaj dhe nuk janë të përfshira në kornizat e vetevaluimit.

Ju mund të shtoni dhe të bëni përpjekej sa është e mundur për të shtuar të gjithë faktorët që është e mundur në shkollën tuaj dhe komunitetin lokal ku është e nevojshme të kujdesemi për lidhjet familjare të cilat mund të ndikojnë në kualitetin e mësimi dhe procesit mësimorë në shkollën tuaj.

Mos mbështeteni vetëm në dokumentet e shkruara. Siguroni që të dhënat e mbledhura në këtë fushë po ashtu të përfshijnë sa më shumë komente të shkruara, vëzhgime dhe dëshmi vizuale.

Treguesit e informacionit

Burim informacionesh

Temat

7.1 Menaxhimi dhe
udhëheqja me
shkollën

Menaxhimi me shkollën
Udhëheqja me shkollën

7.2 Hartimi i politikës
së shkollës

Qartësia dhe përshtatshmëria e misionit dhe vizionit
Procedura për hartimin e politikës shkollore
Rezultate nga planifikimi zhvillimor



Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha: Udhëheqja, krijimi i politikës

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë përdorur).

Përpunimi i dokumenteve

Paraqitni të gjitha dokumentat të cilat janë shqyrtuar

Cilat informacione janë mbledhur?

7.1.1 Udhëheqja e shkollës

Statusi i shkollës

Procesverbalet e mbledhjes

7.1. Menaxhimi dhe udhëheqja me i shkollës

Organ drejtues për shkollën është këshilli i shkollës i cili përbëhet prej 7 antarësh dhe atë: tre anëtarë nga arsimtarët, tre anëtarë nga prindërit, një përfaqësues nga themeluesi-Komuna.

Nga rradhët e anëtarëve të emëruar zgjidhet kryetari i cili planifikon, thirrë dhe udhëheq me mbledhjet.

Organ udhëheqës në shkollë është drejtori i cili përgjigjet për ligjshmërinë e punës dhe për financimin material të punës në shkollë.

Me ligjin për arsim fillor, Statuti i shkollës dhe rregullorja për punë qartë definojnë kompetencat për udhëheqje, udhëheqjen dhe kompetencat e personave adiminstrativ (arkëtarë, sekretarë).

7.1.2 Menaxhimi me shkollën

Statusi i shkollës

Procesverbalet

Embledhjes

Bashkëpunimi i ekipit udhëheqës me gjithë subjektet në shkollë për shkëmbim idejash lidhur me procesin mësimorë ose zgjedhjen e problemeve konkrete është i hapur. Mbledhjet për planifikimin e programit të ekipit udhëheqës me kuadrin arsimorë mbahen një herë në muaj dhe me të udhëheqë drejtori i shkollës. Të të njejtën shqyrtohet dhe miratohet programa vjetore. Raporti gjysëmvetorë dhe vjetorë për punën e shkollës vërtetohet kënaqësinë e arsimtarëve, sillet programa për organizimin e ekskurzioneve me nxënësit dhe programa për caktimin e ditës së patrionatit të shkollës, programa për përkryerjen profesionale të kuadrit mësimorë dhe pyetje të ndryshme lidhur me procesin mësimorë.

Të pranishmit e miratojnë rendin e ditës të mbledhjeve

Në pajtim me programën vjetore për punën e shkollës për cecilën shkollë periferike është caktuar përgjegjës i shkollës i cili bashkëpunon me ekipin udhëheqës në pyetjet lidhur me organizimin e procesit arsimor. Kujdesje



	për mirëmbajtjen e objekteve, sigurimi i mjeteve për nxemje të objekteve etj. Përkrahë organit udhëheqës dhe drejtues në shkollë ka edhe organe profesionale edhe atë: Këshilli arsimorë i shkollës, Këshillin e klasave, kujdestarët e klasave, këshilli i prindërve dhe organizimet e nxënësve. Puna e këtyre organeve, organizimit të nxënësve është e programuar dhe nëpërmjet realizimit të tyre njihen edhe vendimet e grupit udhëheqës. Ekipi udhëheqës është tolerant me të gjithë subjektet në shkollë. Konsultimet bëhen me bisedime, me respektimin e përgjegjësit të shkollës. Informacione mirren edhe gjatë mbledhjeve, informacione gojore, të shkruara të tabelën e shpalljes në shkollë.
7.2.1 Qëllimet e qarta dhe adekuat Raportet e punës Intervistë me anëtarët e këshillit Procesverbalet e punës dhe raportet	<u>7.2. Qëllimet dhe krijimi i politikës në shkollë</u> Shkolla ndërton politikë për klimë të shëndoshë në shkollë. Kjo arrihet nëpërmjet sjelljes së rregullave për sjelljen e nxënësve. Shkolla ka kodeks të sjelljes të përgaditur me të cilën janë të rregulluar fushat në vijim: ➤ Organizimi dhe realizimi i procesit edukativo arsimorë ➤ Klima e shkollës ➤ Zhvillimi profesional dhe i përkryer ➤ Kultura e shkollës ➤ Bashkëpunimi me mjedisin lokal ➤ Komunikimi dhe mardhëniet me publikun Në shkollë egëzistojnë dhe pranohen edhe këto rregullore: -Rregullore për respektimin e Rendit shtëpiak -Evidentim elektronik i masave pedagogjike -Evidencë për pjesëmarrjen e nxënësve në gara -Rregullore për zgjedhjen e nxënësit të gjeneratës. Krijimi i politikës së shkollës bazohet në hulumtimet konstante, analizën përcaktimin dhe hartimin e nevojave të shkollës në atë mënyrë që këto nevoja të përmbushen.
7.2.2 Procedurat për krijimin e politikës shkollore	



Procesverbalet e mbledhjeve me Këshillin e Shkollës, Intervistë me anëtarët e këshillit, Rrregullorja për shqiptimin e masave Kodeksi për sjellje,	Në krijimin e politikës së shkollës kyçen të gjithë arsimtarët, nxënësit dhe prindërit, Por qëndron hapësirë për bashkëpunim edhe me partnerë të ndryshëm. Me politikën janë të informuar të gjithë subjektet e interesuar të këshillit arsimorë, këshilli i klasave dhe aktivet profesionale, si dhe zhvillimit të punës ekipore dhe në lidhje me bisedimet për gjendjen e shkollës. Me pjesëmarrjen e tyre sigurohen ide të pasura, transparencë e lartë dhe ndjekje objektive e kualitetit të punës së shkollës. Mbrojtja shëndetësore e nxënësve realizohet gjatë organizimit dhe shiqimit sistematik nga ana e mjekut të shkollës dhe stomatologut që përgatisin raport për gjendjen shëndetësore të nxënësve. Gjatë gjithë vitit shkollorë arsimtarët realizojnë përmbajtje të cilat ndihmojnë në përparimin e shëndetit të nxënësve dhe ndikojnë në parandalimin e hershëm të smundjeve të ndryshme. Ndihet nevoja për edukimin e arsimtarëve për vetëdijesi për ndjekjen dhe dhënen e ndihmës tek nxënësi që janë të regjistruar nga ana e mjekut të shkollës (nxënës me deformime të ndryshme, smundje kardiovaskulare, smundje të frymarrjes...) Për arritjen dhe zhvillimin e aftësive individuale të nxënësve planifikohen orë plotësues, shtuese, aktivitete të lira dhe organizohen puntori dhe pranohen strategji të ndryshme mësimore për ti përmbushur nevojat e ndryshme mësimore. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe për të gjithë nxënësit.
7.3.1 Qëllimet e planifikimit Zhvillimor Plani zhvilimor Vetevaluimi Planet aksionale për të	<u>7.3. Planifikimi zhvillimor</u> Përgjegjës për planifikimin vjetorë është drejtori i shkollës, dhe i ndihmon edhe puntori profesional. Me planin për zhvillimin e shkollës është një vlerësim i nevojave të shkollës dhe është i përcaktuar drejtimi i prioritetit për zhvillimin e shkollës. Mënyra për arritjen e tyre dhe bartësve të aktiviteteve. Plani Zhvillimor reflekton nevojat reale të shkollës, ka nevojë për zhvillimin peramenent profesional të mësimdhënësve, edukimi i përhershëm i prindërve, zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të monitorimit,



arriturat e qëllimeve të
parashtruara

vlerësimin me objektivitet e arritjeve të nxënësve dhe është e bazuar në burimet ekzistuese dhe është mbështetur nga të punësuarit në shkollë. Plani zhvillimorë përmban elementet në vijim:
Analizën e gjendjes
Misionin dhe vizionin e shkollës
Fushat e ndryshimit
Qëllime zhvillimore, detyra dhe aktivitete
Plani për vetevaluim. Me programën vjetore të shkollës është e parashikuar edhe organizimi i procesit edukativo arsimorë edhe në katër shkollat tjera periferike.

7.3.2 Zhvillimi profesional /trajnim profesional i kuadrit

Procesverbalet e
trajnimeve, certifikatat

Programi i punës për
zhvillim profesional

Të gjithë arsimtarët janë të informuar për procedurat e zhvillimit profesional në shkollë ka evidencë për pjesëmarrjen e arsimtareve në trajnime interne dhe seminare që organizohen nga BZHA, USAID dhe projekteve tjera joqeveritare. Shkolla ka plan për trajnime interne në bazë të prioriteteve të planitzhvillimor. Përcjell pjesëmarrjen e mësimeve në seminare ,mirepo duhet të bëhen përpjekje për aktivizim dhe angazhim të një numër i vogël i arsimtarve të cilët nuk marrin pjesë. Shkolla identifikon nevojat në bazë të shënimeve, mirepo për avancimin profesional duhet që Arsimtari nivel të aktiviteteve të paraqesin nevojën për fusha të ndryshme të procesit mësimor me qëllim të trajnimit plotsues nga shoqata të akredituara të cilat mundësojnë paisjen e mësimeve me certifikata apo vërtetim.,si dhe ka të formuar komisionin për vlerësim të aktiviteteve të mësimeve për avancim profesional.

7.3.3 Mjetet materiale dhe Teknike

Proçeset e inventarizimit

Evidenca e mjeteve
Mësimore

Shkolla i identifikon me kohë nevojat për mjete materiale dhe teknike dhe vazhdimisht planifikon dhe i siguron ato. Mjetet ekzistuese të konkretizimit siç janë tabelat e mençura projektorat printerat si në shkollën qendrore poashtu edhe në ato periferike janë në funksion dhe shfrytëzohen nga një numër i madh i arsimtarëve. Shkolla planifikon dhe siguron mjete për mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.



7.3.4 Infrastruktura

Programi për punën e shkollës

Plani zhvillimor

Qëllimet strategjike

Shkolla identifikon nevojën për mjete material dhe teknike dhe sipas mundësive siguron mjete të nevojshme me prioritet . Janë në funksion kompjutera në kabinetin e informatikës për nxënës, arsimtar, - printerat të cilat shërbejnë për nevojat e nxënësve dhe arsimtarve pjesa më e madhe bazuar në mësim aktiv pregaditen nga arsimtaret dhe nxënësit, shkolla ka plan dhe anagazhohet për plotësimin e nevojave të nxënësve, arsimtareve në të gjitha lëndët mësimore për efektin më të mirë të procesit mësimore

Shkolla vazhdimisht dhe mirë revidon planin për përmirsimin e infrastrukturës më çka siguron mjete nga qeverisja lokale, M.A.SH. dhe nga donator- privat, afarist, qytetar të cilët ndihmojnë në raste të ndryshme si arsimdashës dhe konsiderohen si aktivist, mirëpo shkolla në të shumtën e rasteve ka bashkëpunim dhe gjithmonë i referohet vetëqeverisjes lokale për nevojat e përmirimit të infrastrukturës.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për realizimin e punës edukative- arsimore, pamjes estetike dhe klimës së përgjithshme të shkollës, gjatë vitit shkollor 2022-2023 zhvillohen këto aktivitete: Në shkollën qendrore është bërë investim në përmirësimin e kushteve në kabinetet : SHKENCA NATYRORE, BIOLOGJI, ANGLISHT, KIMI DHE FIZIKË

Janë instaluar edhe 5 projektor të rinj ku me këtë u rumbullaksua pjesa e projektorëve dmth të gjithë klasat dhe kabinetet janë të pajisur me smart teknologji.

Vendosja e teatrit veror në oborrin e shkollës

Dislokimi i bibliotekës të shkollës në ambient më të përshtatshëm dhe më të madh për punën e bibliotekës

Furnizimi me dy lap top të administratës së shkollës

Në SHFKP- Senakos: vendosja në mënyrë statike të 8 projektorëve nëpër klasat ku tash e gjithë shkolla është mbuluar me dy smart tabela dhe me 8 projektor që të gjithë funksional.

Vendosja e këndit të lojrave me mjete vetanake nga buxheti i shkollës për fëmijët deri në klasën e pestë.



Në SHFKP -Kalisht vendosja e katër projektorëve statik dhe dy të lëvizshëm dhe instalimi paraprakisht i një smart table.

NË SHFKP- Gjurgjevisht është bërë komplet renovimi i shkollës me mjete të fituara nga ana e shkollës në bashkëpunim me komunën nga USAID ku është investuar në ndrimin e kulmit, lysterjen të tërësishme të klasëve, vendosjen e nxemjes qendrore, vendosjen e bekatonkave në oborrin e shkollës, rregullimin e tërësishëm të banjove dhe ndrimin e tërësishëm të instalimit elektrik bashkë me ndërprerësit dhe shtekerat si dhe ndërtimin e një depoje ku është vendosur kaldajae nxemjes dhe mbahen drunjët në të.

Sanimi i murit mbrojtës në Shfp-Senakos punë e cila u realizua në bashkëpunim me komunën e Vrapçishtit

Investim në Shfp-Senakos montimi i perdeve veneciane në pesë klasa .

Muralet në Shfq-Negotin ,Shfp-Senakos dhe Shfp-Kalisht të realizuara nga mësimpldhënësit Verim Zendeli dhe Mirsad Osmani.

Investim në Shfp-Kalisht ndërtimi i rethores së shkollës me beton ,projekt i mbështetur edhe nga komuna e Vrapçishtit

o Me qëllim të përmirësimit të kushteve për realizimin e punës edukative-arsimore, pamjes estetike dhe klimës së përgjithshme të shkollës, gjatë vitit shkollor 2023-2024 zhvillohen këto aktivitete:

o Shp-Senakos është furniza me një fotokopje të madhe dhe kompjuter për nevojat e nxënësve dhe mësimpldhënësve

o Furnizimi i vazhdueshëm i shkollës me mjete pune dhe 3 projektor të ri.

o Në shkollën periferike të fshatit Senakos u bë mbulimi i shkallëve me granit nga ana e mësimpldhënësve Mirsad

Osmani dhe Rizvan Asani ,kurse për gjërat materijale u kujdesv depoja Evro Kom

o Në shkollën periferike Senakos u bë vendosja e anësoreve nga alumini (pamakeve të shkollës)

o Në shkollën qendrore në Negotinë përkatësisht në zyrat u bë vendosja e perdene veneciane nga ana e ndërmarrjes



	Torino Rolet(parmak) o Në shkollën qendrore në Negotinë u vendosën rrethore të reja me ndimën e personelit teknik. o Në shkollën periferike në Kalisht u vendosën rrethoret,me ndimën e personelit teknik.
--	---

Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha: Udhëheqja, krijimi i politikës

Mledhja e të dhënave cilat tjera metoda janë përdorur për mbledhjen e të dhënave? (psh. Pyetësor, anketime, vëzhgime etj.)		
Paraqiti metodat tjera që janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave	Pjesëmarrja: Kush ishte i kyçur në mbledhjen e informatave	Cilat të dhëna janë mbledhur?
Pyetsor për arsimtarët Bisedime resiproke	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special	90 % e të punësuarve në shkollë janë të kënaqur me punën e drejtorit dhe shërbimit profesional në shkollë, me sukses e realizojnë programën dhe mirë bashkëpunojnë me gjithë aktivitetet shkollore. Shkolla u mundëson bashkëpunim me institucionet e jashtme në punën e shkollës te 84%. 77 % të punësuarve dhe anëtarët e këshillit të shkollës janë të njohur me mënyrën e të punuarit. Puna me mjetet financiare është në pajtim me qëllimet e procesit arsimorë dhe prioritetet për shkollën janë deklaruar 90 % 93 % e arsimtarëve deklaruan se u është mundësuar zhvillimi vazhdueshëm profesional ndërsa 80 % e arsimtarëve të rinjë gradulaisht e kryejnë punën me përkrahje të vazhdueshme
Pyetsor për prindërit Bisedime	Pedagogu i shkollës Psikologu Edukator Special	92 % të prindërve janë të kënaqur me organizimin dhe përparimin e shkollës dhe me sjelljen e drejtorit me ato dhe me fëmijët e tyre.



		Për 96 % shkolla të gjithëve nxënësve u ofron mundësi të njejta dhe i mbrojnë nga dhuna dhe përdorimi i drogave. Puntori profesional është në marrëdhënie të mira me prindërit dhe nxënësve u ofron përkrahje dhe ndihmë e duhur për 90 %
Pyetsor për nxënësit; Bisedë; Vëzhgim	Pedagogu i shkollës; Psikologu Edukator Special	Në shkollë zbatohen rregulla të qarta për sjelljen e nxënësve janë deklaruar 89 % të nxënësve të anketuar. Sipas 30 % të tyre nxënësit marrin pjesë në sjelljen e vendimeve të rëndësishme në shkollë. 95 % nga nxënësit e anketuar janë të kënaqur me sjelljen e drejtorit dhe puntorit profesional që e respektojnë çdoherë personalitetin e tyre 87 % të nxënësve kanë mendim pozitiv për arsimtarët e tyre sepse përjetojnë përkrahjen e tyre.



Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha 7 : Udhëheqja, krijimi i politikës

Rezultatet: Këtu duhet shkurt të arsyetoni anët kyçe të forta të juajat dhe anët kyçe të dobëta tuajat

Anët e forta të shkollës:

- Përgaditja e planit për zhvillimin e shkollës
- Posedimi i rregulloreve për respektimin e rendit shtëpiak, kodeksi për sjellje, rregulloren për zgjedhjen e nxënësit të gjeneratës, rregullore për lëvdata dhe marrjen e masave pedagogjike të nxënësve;
- Raport mbi zbatimin e punës si ekip në punën e mësuesve
- Shqetsim për përpirësimin e shëndetit të nxënësve

Anët e dobëta të shkollës:

- Mungesa e burimeve materiale për planifikim të vërtetë dhe zbatimin e veçanta të përmbajtjes dhe aktiviteteve
- Mosdefinimi i disa formave dhe metodave për zbatimin e punës në ekip
- Mostrajnimi i mentorëve për praktikantët dhe
- Edukim i pamjaftueshëm i arsimtarëve për ndjekjen e zbulimit të problemeve shëndetësore të nxënësit.

Aktivitete në të ardhmen: Prioritete e nënfushave në suazat e kësaj fushe të cilat mundë të jenë të kyçura në planet për zhvillim të shkollës

- Aplikimi qasjes ekipore në drejtimin e shkollës;
- Përmirësimin e infrastrukturës së shkollës si vizion për udhëheqje
- Edukimi i mësuesve në fushën e arsimimit shëndetësor
- Edukimi i arsimtarëve për udhëheqjen të procesit për mentor



Vetevaluimi i shkollës: Shf."Naim Frashëri "

fusha 7: Udhëheqja, krijimi i politikës

Analiza e rezultateve:

Këtu jepni evaluim të detajuar të kësaj fushe

Bashkëpunimi i ekipit udhëheqës me të gjitha subjektet në shkollë për shkëmbim të ideve lidhur me procesin mësimorë dhe për zgjedhjen e problemeve është i hapur .Të punësuarit në shkollë janë të kënaqur nga puna e drejtorit dhe shërbimit profesional në shkollë. Me sukses e realizojnë programin dhe mirë bashkëpunojnë me të gjithë aktivitetet shkollore. Puna me mjetet financiare është në përputhje me qëllimet e procesit arsimor dhe prioritetet në shkollë.

Prindërit janë të kënaqur me organizimin dhe përparimin e shkollës si dhe me mardhënien me drejtorin dhe me fëmijët e tyre.

Shkolla të gjithëve nxënësve u ofron mundësi të njejta dhe i mbron prej dhunës dhe përdorimit të drogës.

Nxënësit marrin pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë.

Të kënaqur janë nga drejtori dhe punëtori profesional dhe tek ato gjithmonë e respektojnë personalitetin e tyre.

Për arsimtarët e tyre kanë mendim pozitiv dhe gjithmonë e kanë përkrahjen e tyre.

Shkolla ndërton klimë të shëndoshë. Kjo arrihet me shënimet dhe rregullat e marrura për sjelljen e nxënësve.

Krijimi i politikës së shkollës bazohet në hulumtimet e vazhdueshme, analizimin dhe zbulimin e nevojave të veçanta të shkollës dhe hartimin e një mënyre që këto nevoja janë plotësuar të të gjithë mësuesit , nxënësit dhe prindërit, dhe është hapur për bashkëpunim me partnerë të ndryshëm.

Me politikën informohen të gjithë subjektet e interesuara të këshillit arsimor. Këshillat e klasave dhe aktivitetet profesionale si dhe gjatë zhvillimit të punës ekipore dhe gjatë bisedës për gjendjen e shkollës. Me prezencën e tyre sigurohet pasurim i idejave, transparencë më e madhe dhe objektivitet në ndjekjen e kualitetit të punës në shkollë.

Ekipi që punonte për planin zhvillimor pregatit kodeks për sjellje, vërteton nevojat prioritare dhe e definon misionin dhe vizionin e shkollës.

Edhe pse në një masë më të vogël, shkolla është përpjekur për aplikimin e punës si ekipë.

Shkolla në kuadër të aftësive të tyre siguron transparencën, përpiket për të kryer sistem për udhëheqje të drejtë në shkollë. Me qëllim të kënaqjes së kryerjes së punës së nxënësve dhe procesit edukativo arsimor në çdo ditë pune.

Nevojitet nevoja e aktiviteteteve gjegjësisht kyçjen e prindërve në punën e shkollës dhe nevoja për edukimin të anëtarëve të këshillit të shkollës në pajtim me rolin e tyre të ri.



4. Raport për vetevaluimin e përfunduar me propozim masa për përmirësimin e cilësisë së punës arsimore

Bazuar në nenin 129, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Arsimin Bazë (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 161, datë

5.8.2019) dhe dispozitave të Statutit të Shkollës, në periudhën maj/qershor, 2024, SHFK: "Naim Frashëri" Negotinë, komuna e Vrapçishtit, ka bërë vetevaluim për punën e vet dhe të arriturat e shkollës.

Vetevaluimin e ka realizuar Komisioni i Shkollës i cili është formuar nga këshilli Shkollor, me Vendimin nr: 02-96 të:20.02.2024

4.1 .Vetevaluimin e shkollës e udhëhoqi komisioni i shkollës i përbërë nga:

- Bejtulla Kamberi– Drejtor
- Lindihana Ebibi-Edukatore Speciale
- Fetanete Adili-Grup klasor
- Behije Jonuzi –Grup lëndor
- Riad Bajrami – Kryetar K.K.SH

Dukë u bazuar në sferën nr.1 Programet dhe planet mësimore, ekipin e përbëjnë këto antarë:

- Ilvana Halili– Mësimdhënëse
- Zana Dalipi– Mësimdhënëse
- Shasine Ragibi– Mësimdhënëse
- Bleona Pajaziti –Nxënës
- Besim Haliti -Prind

Dukë u bazuar në sferën nr.2 Të arriturat e nxënësve, ekipin e përbejnë këto antarë:

- Ferdane Velija – Pedagog
- Florije Bilalli– Mësimdhënëse
- Mirzana Jaja – Mësimdhënëse
- Erina Halili–Nxënës
- Ramis Imeri-Prind



Dukë u bazuar në sferën nr.3 Mësim dhe proces mësimor, ekipin e përbejnë këto antarë:

- Rabi Ismaili-Nd.drejtor
- Drita Saliji– Mësimdhënëse
- Selime Tahiri– Mësimdhënëse
- Emine Musliu –Nxënës
- Berat Haliti -Prind

Dukë u bazuar në sferën nr.4 Mbështetje/ndihmë për nxënësit, ekipin e përbejnë këto antarë:

- Mjaftime Dalipi -Mësimdhënëse
- Alemine Bilalli – Mësimdhënëse
- Sahide Ebibi– Mësimdhënëse
- Hana Xheladini–Nxënës
- Arife Kamberi-Prind

Dukë u bazuar në sferën nr.5 Klima shkollore, ekipin e përbejnë këto antarë:

- Mirzana Selmani-Mësimdhënëse
- Hanife Bajrami– Mësimdhënëse
- Ismije Maliki– Mësimdhënëse
- Vigan Selmani–Nxënës
- Gazmend Tahiri-Prind

Dukë u bazuar në sferën nr.6 Resurset (burimet) ekipin e përbejnë këto antarë:

- Verim Zendeli –Mësimdhënëse
- Blerta Amiti– Mësimdhënëse
- Ganimete Ilazi– Mësimdhënëse
- Zerina Jonuzi–Nxënës
- Gadaf Bexheti -Prind

Dukë u bazuar në sferën nr.7 Udhëheqje/menaxhim me shkollën dhe krijimi i politikave të shkollës, ekipin e përbejnë këto antarë:

- Rizvan Asani–Mësimdhënëse
- Arjeta Kamberi – Mësimdhënëse
- Mjaftime Zulbehari– Mësimdhënëse
- Jasin Amiti–Nxënës
- Denis Alija -Prind



Ekipet zhvilluan diskutime dhe konsultime me punonjësit e shkollës. Gjatë përgaditjes së vetevaluimit, komisioni i shkollës kërkuan dhe kontrolluan të gjitha dokumentet dhe shënimet e nevojshme në shkollë. Është bërë një rishikim i dokumentacionit të nevojshëm dhe janë përdorur më shumë të dhëna prej tij. Anketat janë kryer me mësues, nxënës dhe prindër. Të dhënat e marra janë përpunuar, analizuar dhe përdorur në përgaditjen e vetevaluimit. Në bazë të gjithë kësaj Komisioni i Shkollës ka prodhuar dokumentin “Vetevaluimi, 2024”, në të cilin janë marrë rezultatet e analizës së anketimit të kryer, me mësimdhënës, nxënës dhe prindër janë përfshirë të dhënat e të cilave janë përdorur për përgaditjen e Vetëvaluimit, udhëzimet nga Ligji për arsimin bazë dhe treguesit për cilësinë e punës së shkollës, të përgaditur nga Ministria e Arsimit, u përdor edhe doracaku: “Indikatorët për kualitetin e punës së shkollave” i përgaditur nga ISHA(Inspektorati Shtetëror për Arsim) u përdor një pasqyrë e cilësisë së punës, progresit dhe arritjeve të shkollës, pikat e forta dhe të dobëta, e cila do të pasohet me propozimin e masave për tejkalimin e tyre.

Dobësitë e perceptuara do t'i motivojnë të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor që të investojnë kapacitetet e tyre dhe të përdorin burimet ekzistuese për të përmirësuar kushtet dhe standardet në shkollë. Qëllimi i përbashkët i të gjitha subjekteve në shkollë është zvogëlimi i dobësive, ruajtja dhe rritja e pikave të forta. Sipas vetevaluimit të kryer plotësisht, Komisioni vlerësoi punën e shkollës me notë Shumë mirë. Kjo notë paraqet një totali i situatës dhe punës së përgjithshme në shkollë, i cili është marrë nga të shtatë fushat që mbulojnë vetevaluimin e shkollës. Masat e propozuara për përmirësimin e cilësisë së punës së shkollës do të përfshihen në Programin Vjetor për punën e shkollës në vijim dhe në Programin vijues për zhvillimin e shkollës.

Komisioni përpiloi një raport për procesin e vetëvlerësimit dhe ia dorëzoi Këshillit të shkollës, drejtorit të shkollës dhe komunës së Vrapçishtit.



5. Rekomandim dhe propozim masa për përmirësimin e cilësisë së punës edukativo-arsimore (duke marrë parasyshë vetevaluimin e shkollës për dy vitet e fundit sipas Nenit 129 të Ligjit për arsim fillor të RMV-asë) edhe ate:

- Trajnim të mësimeve për planifikim dhe realizim të procesit mësimor për nxënësit me nevojë të veçanta arsimore.
- Trajnim të mësimeve për planifikim dhe realizim të mësimin me nxënës të talentuar dhe prirje
- Edukimi i mësuesve për përgatitjen e planeve dhe programeve të shkurtuara në situatën e një viti shkollor të shkurtuar
- Plan programe të reja në vite të caktuara të arsimit.
- Përfshirja e pamjaftueshme e prindërve dhe nxënësve në procesin e planifikimit të përmbajtjeve dhe aktiviteteve në klasat e rregullta.
- Nevoja për edukim plotësues të kuadrit mësimor për përgatitjen e planeve dhe përcaktimin e qëllimeve.
- Numri i nxënësve të pavlerësuar është në mënyrë të pajustificueshme i lartë dhe për këtë arsye duhet theksuar rregullsia e orëve, zvogëlimi i mungesave, kontrollimi i shpeshtë i arsyeve të mungesave dhe me prindërit.
- Paisja e pamjaftueshme e shkollës me mjete pamore dhe pajisje të përshtatshme për përgatitjet multimediale
- Mësuesit nuk janë mjaft të përgaditur profesionalisht për të punuar me fëmijët që kanë pengesa në zhvillimin mendor ose fizik
- Shërbimi pedagogjik -psikologjik është i pajisur në mënyrë të pamjaftueshme me teste për nxënësit, si teste të personalitetit, teste për matjen e inteligjencës, qëndrimeve, opinioneve e të tjera.
- Mosinteresimi i disa prindërve për suksesin dhe përparimin e fëmijëve të tyre.
- Biblioteka e shkollës ka një numër shumë të vogël botimesh leximi, të cilat nuk disponohen kur kanë nevojë dhe nuk plotësojnë nevojat e nxënësve në tërësi.
- Shkolla nuk ndan mjete për zhvillimin individual të mësuesve, për shkak të mungesës së mjeteve.

Nga komisioni për vetevaluim

Përpiloi :Edukatore Speciale:Lindihana Ebibi

SH. F. K. " Naim frashëri" Negotina e Pollogut

Drejtori- Bejtulla Kamberi_____

v.v

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

